

Raportet e monitorimit

Përmbledhje

1 dhjetor 2007 – 31 dhjetor 2008

Vlerësimi i punës së Kuvendit të Kosovës



Vlerësimi i punës së Kuvendit të Kosovës

Përmbledhje e raporteve të monitorimit
1 dhjetor 2007 – 31 dhjetor 2008

© Misioni i OSBE-së në Kosovë, Prishtinë 2009

PËRMBAJTJA

Përmbledhje Ekzekutive.....	7
Raporti 01/2008 i Shtyllës së III-të (1 dhjetor 2007 – 15 shkurt 2008).....	11
Raporti 02/2008 i Shtyllës së III-të (16 shkurt 2008 – 31 mars 2008).....	23
Raporti 03/2008 i Shtyllës së III-të (1 prill 2008– 14 qershor 2008).....	35
Raporti 04/2008 i Shtyllës së III-të (15 qershor 2008 – 31 shtator 2008).....	49
Raporti 05/2008 i Shtyllës së III-të (1 tetor 2008 – 30 nëntor 2008).....	63
Raporti 06/2008 i Shtyllës së III-të (1 dhjetor 2008 – 31 dhjetor 2008).....	75

Permbledhje ekzekutive

Misioni i OSBE-së në Kosovë (Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë) ka filluar monitorimin e Kuvendit të Kosovës në dhjetor të vitit 2002 me kërkesë të Përfaqësuesit të Posaçëm të Sekretarit të Përgjithshëm të Misionit të Kombeve të Bashkuara në Kosovë (UNMIK). Qëllimi i monitorimit të Kuvendit është të vëzhgoj dhe raportoj lidhur me punimet dhe shqyrtimet e Kuvendit të monitoroj dhe ndihmoj për të siguruar pajtueshmëri me rregulloren e punës së Kuvendit si dhe parimet dhe standardet demokratike parlamentare lidhur me, ndër të tjera, qasjen dhe pjesëmarrjen e barabartë në punimet e Kuvendit të të gjithë deputetëve të Kuvendit, procesin legjislativ, procesin e votimit, mbikqyrjen parlamentare të ekzekutivit dhe qasjen e publikut në informatat lidhur me punimet e Kuvendit.

Në periudhën 1 dhjetor 2007 deri më 31 dhjetor 2008, Misioni i OSBE-së në Kosovë ka prodhur gjashtë raporte analitike të përqëndruara në temat e përmendura më lartë, të cilat janë përfshirë në këtë përmbledhje. Gjatë periudhës raportuese monitoruesit e Kuvendit nga OSBE-ja kanë monitoruar 43 seanca plenare, 35 mbledhje të Kryesisë së Kuvendit, njëqind e shtatëdhjetë e tetë mbledhje të komisioneve dhe katër dëgjime publike.

Gjatë periudhës raportuese, monitoruesit e Kuvendit nga OSBE-ja kanë vërejtur një trend përgjithësisht pozitiv në punimet e Kuvendi, por poashtu kanë vërejtur edhe një numër sfidash dhe pengesash në procesin legjislativ, mbikqyrjen parlamentare të ekzekutivit dhe përgjegjshmërinë ndaj publikut, si më poshtë.

Pas zgjedhjeve parlamentare në nëntor 2007 dhe në fillim të mandatit të tretë, komisioni parlamentar për mandate, imunitete dhe rregullore të punës ka filluar ripunimin e rregullores së punës, ashtu siç kërkohet në rregulloren aktuale të punës. Komisioni ka mbajtur një seminar në Ohër, ish Republika Jugosllave e Maqedonisë në korrik, me ndihmën e OSBE-së, ku i është dhënë mundësia që të përgatis projektregulloren fillestare. Bazuar në gjetjet dhe vëzhgimin gjatë monitorimit të Kuvendit në mandatin e dytë, OSBE-ja ka paraqitur një numër të propozimeve procedurale dhe të dhëna tjera për ripunimin e Rregullores së Punës. Në nëntor, komisioni ka finalizuar projektregulloren e punës, që është miratuar në parim në seancën plenare të Kuvendit majtur më 12 dhjetor 2008. Pas miratimit në parim të projektregullores, çdo grup parlamentar dhe deputet individual kanë pasur të drejtën të bëjnë propozime, ndërsa projektregullorja e punës pritet të miratohet së shpejti nga Kuvendi.

Në seancën plenare të mbajtur më 15 shkurt 2008, Kuvendi ka miratuar një mocion procedural për shmangie nga rregullorja e punës në mënyrë që t'i shqyrtoj dhe miratoj ligjet e parapara në "Propozimin gjithëpërfshirës për rregullimin e statusit të Kosovës" të të dërguarit të posaçëm të Kombeve të Bashkuara (këtu e tutje propozimi gjithëpërfshirës). Gjatë periudhës raportuese Kuvendi ka miratuar dyzet ligje të dala nga propozimi gjithëpërfshirës. Sipas mocionit procedural, ligjet duhet të shqyrtohen dhe miratohen brenda dy ditësh pas shpërndarjes së tyre në Kuvend brenda 60 ditësh e jo më vonë se 180 ditë pas miratimit të ligjeve. Sidoqoftë, gjatë periudhës raportuese, duket se Qeveria nuk i ka dorëzuar deklaratat financiare për një numër të konsiderueshëm të ligjeve të dala nga propozimi gjithëpërfshirës, ashtu si kërkohet në mocionin procedural, ligje të cilat megjithatë janë miratuar nga Kuvendi gjatë periudhës 180 ditore ashtu siç lejohet në mocionin procedural.

Procesi legjislativ është përmirësuar dukshëm, por komisionet kanë hasur në vështirësi në shqyrtimin me kohë të projektligjeve. Sipas rregullores së punës, kur një komision ngarkohet ta shqyrtoj një projektligj të caktuar, duhet të raportoj rekomandimet e tij në Kuvend jo më vonë se dy muaj pas shqyrtimit të parë të projektligjit, përveç, nëse është lejuar kohë shtesë nga Kuvendi. Në raportet e monitorimit të OSBE-së është vërejtur se komisionet e Kuvendit zakonisht i kanë dorëzuar rekomandimet e tyre pas afatit të përmendur më lartë, pa kërkuar nga Kuvendi shtyerje të afatit. Andaj, gjatë shqyrtimit të rregullores së punës, OSBE-ja i ka rekomanduar komisionit për mandate, imunitete dhe rregullore të punës që ta zgjas afatin për shqyrtimin e projektligjeve për t'u lejuar më shumë kohë komisioneve për t'i shqyrtuar projektligjet në mënyrë më cilësore.

Lidhur me mbikqyrjen e ekzekutivit, katër mocione për interpelanca i janë parashtruar Qeverisë dhe për to është debatuar në seanca plenare brenda periudhës raportuese. Për më tepër, deputetët i kanë parashtruar Qeverisë 326 pyetje për përgjigje me gojë, prej të cilave 204 sosh kanë marrë përgjigje. Përkundër disa zhvillimeve pozitive, Kuvendi ka hasur në vështirësi në menagjimin e periudhës për pyetje parlamentare në mënyrë të efektshme dhe për të siguruar

përgjigje të plotë nga Qeveria në të gjitha pyetjet e parashtruara. Deputetët kanë parashtruar numër të madh të pyetjeve gjë që ka rezultuar që shumë pyetje të shtyhen nga një seancë në tjetrën, sepse koha për pyetje parlamentare përfundonte. Për më tepër, mungesa e Ministrave poashtu ka rezultuar me shtyerjen e shumë pyetjeve. Andaj, OSBE-ja në raportet e saj të monitorimit, ka rekomanduar që Kuvendi ose ta zgjas periudhën për pyetje parlamentare ose ta kufizoj numrin e pyetjeve për deputet, në mënyrë që t'u ipet rasti të gjithë deputetëve të cilët kanë parashtruar pyetje që t'i paraqesin dhe të marrin përgjigje. OSBE-ja poashtu ka këshilluar Kuvendin që të bëj më shumë përpjekje dhe ta përdor autoritetin e tij për të siguruar përgjegjshmërinë e Qeverisë, që paraqet një aspekt të rëndësishëm të mbikqyrjes parlamentare.

Në seancën plenare të mbajtur më 15 shkurt 2008, Kryetari i Kuvendit ka lajmëruar se Kuvendi do t'i publikojë në web faqen e tij rezultatet e votimit elektronik të vendimeve të marra duke filluar nga seanca plenare e 17 shkurtit. Pas lajmërimit të tillë nga ana e Kryetarit të Kuvendit, Kuvendi ka publikuar në web faqen e tij rezultatet e votimit elektronik të disa seancave plenare deri në seancën plenare të mbajtur më 2 qershor 2008, por ka dështuar ta bëj këtë më pas. OSBE-ja i ka rekomanduar fuqimisht Kuvendit që t'i publikoj rezultatet e votimit elektronik vazhdimisht në mënyrë që ta rris transparencën e Kuvendit, e posaçërisht përgjegjshmërinë e deputetëve ndaj votuesve të tyre.

Në seancën plenare të mbajtur më 4 dhjetor, Kuvendi ka vendosur që t'ia përfundoj mandatin e deputetit të Kuvendi z. Sabit Rrahmani (PDAK), përfaqësues i komunitetit ashkali. Më 13 shtator, z. Sabit Rrahmani (PDAK) ka përmbushur afatin gjashtë mujor të mosparaqitjes në punimet e Kuvendit. Sipas rregullore së punës nëse një deputet nuk merr pjesë në asnjë seancë plenare të Kuvendit apo mbledhje të komisionit ku ai/ajo është anëtar, dhe nuk i ofron arsyetim të kënaqshëm Kryetarit të Kuvendit, Kryetari i propozon Kuvendit që deputeti në fjalë të mos jetë më deputet. Me Rregullore të punës, për këtë çështje, poashtu kërkohet mendimi i komisionit për mandate, imunitete dhe rregullore të punës. Andaj, bazuar në rregulloren e punës Kryetari i Kuvendit ka rekomanduar që t'i përfundohet mandati i deputetit z. Rrahmani, gjë që është mbështetur nga komisioni për mandate, imunitete dhe rregullore të punës. Ky ishte rasti i parë ku Kuvendi i Kosovës ka vendosur që t'ia përfundojë mandatin njërit prej deputetëve të tij.

OSBE-ja, përmes kësaj përmbledhjeje të raporteve analitike të monitorimit, përpiket t'u ofroj deputetëve rekomandime të cilat mund të ndohmojnë në funksionimin më të efektshëm të Kuvendit dhe rritjen e praktikave parlamentare demokratike.



Organization for Security and
Co-operation in Europe
Mission in Kosovo

Shtylla III (OSBE)

Raporti 01/2008

Mbi monitorimin e Kuvendit të Kosovës

1 dhjetor 2007 – 15 shkurt 2008

Titujt kryesor

- Kuvendi i tretë i Kosovës mban seancën inauguruese
- Zgjedhen Kryetari i Kosovës, Kryeministri dhe Qeveria
- Zgjedhet Kryetari i Kuvendit dhe anëtarët e Kryesisë
- Kuvendi miraton nismën për ndryshimin e Kornizës Kushtetuese
- Kuvendi vendos t'i shmanget Rregullores së Punës për t'i miratuar ligjet lidhur me "Propozimin Gjithëpërfshirës për Zgjidhjen e Statusit të Kosovës"
- Kuvendi miraton buxhetin e konsoliduar të Kosovës për vitin 2008
- Kuvendi themelon trembëdhjetë komisione

1. Sfond

Raporti i pesëdhjetepeshtë i monitorimit është hartuar në përputhje me pikëpamjet referuese të Shtyllës së tretë të UNMIK-ut për themelimin e institucioneve (OSBE) dhe monitorimin e Kuvendit të Kosovës prej datës 26 nëntor 2002 dhe bazohet në Rregulloren e re të punës, të miratuar në fund të seancës plenare më 20 maj 2005 dhe të reviduar në seancën plenare të mbajtur më 1-2 qershor 2006 dhe 18 shtator 2007.

Shtylla e III-të (OSBE) ka monitoruar seancën plenare inauguruese të mbajtur më 4/9 janar 2008 dhe dy seanca plenare të rregullta më 31 janar dhe 15 shkurt si dhe katër mbledhje të Kryesisë, më 15 janar, 21 janar, 28 janar dhe 13 shkurt.

2. Vështrim

Seancën plenare të Kuvendit të Kosovës të mbajtur më 4/9 janar fillimisht e kryesoi z. Mark Krasniqi (LDD-PShDK) deputeti më i vjetër i Kuvendit, të cilit i ka ndihmuar znjsh. Njomza Emiri (AKR), deputetja më e re e Kuvendit të Kosovës.

- Njëqin e njëzet deputetë dhe njëqin e nëntëmbëdhjetë deputetë ishin të pranishëm respektivisht në seancën plenare inauguruese më 4 dhe 9 janar.¹
- Pikat kryesore të rendit të ditës të seancës plenare të 4/9 janar:
 - Themelimi i Komisionit për mandate dhe imunitete (Shiko më poshtë pjesën e titulluar “Komisioni për mandate dhe imunitete”).
 - Betimi i deputetëve të Kuvendit
 - Miratimi i Kryesisë së Kuvendit dhe Kryetarit të Kuvendit (Propozimi për Kryetarin e Kuvendit dhe pesë anëtarët e Kryesisë së Kuvendit është miratuar me 88 vota për, një votë kundër dhe pa abstenime. Shiko pikën e parë pas titullit “Procesi i votimit”).
 - Votimi i Kryetarit të Kosovës (Z. Fatmir Sejdiu është ri-zgjedhur Kryetar i Kosovës në raundin e tretë me 68 vota për. Shiko pikën e dytë pas titullit “Procesi i votimit”).
 - Votimi i Kryeministrit, Ministrave dhe Zëvendësministrave (Z. Hashim Thaçi është zgjedhur Kryeministër së bashku me kabinetin e tij me 85 vota për, 22 vota kundër dhe katër abstenime.)

Seancën plenare të Kuvendit të Kosovës të mbajtur më 31 janar e kryesoi Kryetari i Kuvendit Jakup Krasniqi (PDK) dhe anëtari i Kryesisë z. Ibrahim Gashi (AKR).

- Njëqind e tetë deputetë ishin të pranishëm në seancën plenare të 31 janarit.

1 Shifrat e përmendura më sipër janë ato të cilat i ka dhënë Kryetari i Kuvendit apo kryesuesi i seancës në fillim të secilës ditë të seancës.

- Pikat kryesore të rendit të ditës të seancës plenare të 31 janarit:
 - Shqyrtimi i propozimit për numrin e komisioneve dhe anëtarëve të tij (Propozimi është miratuar me 86 vota për dhe pa vota kundër)
 - Miratimi i kryesuesve, zëvendës kryesuesve dhe anëtarëve të komisioneve parlamentare (Propozimi është miratuar me 83 vota për dhe dy vota kundër.)
 - Miratimi i dy anëtarëve të Kryesisë nga komunitet jo shumicë (Propozimi është miratuar me 89 vota për dhe katër vota kundër. Shiko më poshtë pjesën e titulluar “Qasja dhe pjesëmarrja e barabartë e komuniteteve”.)
 - Shqyrtimi i propozimit të AAK-së për ndryshimin e Kornizës Kushtetuese (Kërkesa është miratuar me 89 vota për dhe një votë kundër.)

Seancën plenare të Kuvendit të Kosovës të mbajtur më 15 shkurt e kryesoi Kryetari i Kuvendit Jakup Krasniqi (PDK) dhe anëtari i Kryesisë z. Xhavit Haliti (PDK).

- Njëqind e tetë deputetë ishin të pranishëm në seancën plenare të 15 shkurtit.
- Pikat kryesore të rendit të ditës të seancës plenare të 30 tetor/2 nëntor:
 - Njoftimi lidhur me publikimin e votimit elektronik
 - Shqyrtimi i mocionit të parashtruar nga pesë grupe parlamentare për t’u shmangur nga Rregullorja e Punës lidhur me miratimin e ligjeve të parapara në “Propozimin Gjithëpërfshirës për Zgjidhjen e Statusit të Kosovës” të të dërguarit të posaçëm të OKB-së (Mocioni është miratuar me 80 vota për, gjashtë vota kundër dhe katër abstenime. Shiko më poshtë paragrafin e parë të pjesa “Mocionet procedurale”.)
 - Shqyrtimi i mocionit për shmangie nga Rregullorja e punës lidhur me shqyrtimin dhe miratimin e projektligjit për buxhetin e konsoliduar të Kosovës për vitin 2008 (Mocioni është miratuar me 86 vota për, dhjetë vota kundër dhe dy abstenime. Shiko më poshtë paragrafin e dytë të pjesa “mocionet procedurale”.)
 - Shqyrtimi i parë dhe i dytë i projektligjit për buxhetin e konsoliduar të Kosovës për vitin 2008 (Projektligji është miratuar në parim me 75 vota për dhe 12 vota kundër, dhe është miratuar me 73 vota për dhe 13 vota kundër.)
 - Emërimi i Naim Malokut (AAK) anëtar i Kryesisë (Emërimi është miratuar me shumicë votash për dhe pa vota kundër.)
 - Emërimi i zëvendës ministrave (Kuvendi ka miratuar emërimin e zëvendës ministrave me 81 vota për, 16 vota kundër dhe tri abstenime.)

3. Punimet dhe praktikat parlamentare në seancat e Kuvendit

Komisioni për mandate dhe imunitete

- Në fillim të seancës plenare inauguruese të 4 janarit, kryesuesi z. Mark Krasniqi (PSHDK) pohoi se si pjesë e procedurës së rregulltë Kuvendi duhet ta krijonte Komisionin për mandate dhe imunitete për ta verifikuar dokumentacionin lidhur me zgjedhjet e 17 nëntorit, përfshirë rekomandimin e Komisionit Qëndror Zgjedhor dhe dokumentacionin mbi çertifikimin e rezultati të zgjedhjeve nga PSSP-ja. Më pas, ai i ftoi subjektet politike të përfaqësuara në Kuvend që të propozojnë nga një anëtar për të shërbyer në komisionin *ad hoc* për mandate dhe imunitete. Pasi që subjektet politike propozuan nga një anëtar nga radhët e tyre, kryesuesi ftoi Kuvendin që të votojë për përbërjen e tërë komisionit, e cila u miratua me shumicë votash për dhe pa vota kundër. Më vonë, z. Arsim Bajrami (PDK) Kryesues i Komisionit për mandate dhe imunitete paraqiti raportin e komisionit në të cilin u konfirmua rezultati i çertifikuar nga PSSP-ja. Më pas, kryesuesi e hedhi në votim raportin e komisionit, i cili është miratuar me shumicë votash për dhe pa vota kundër.

Sipas rregullës 3.3, Kryesuesi, në seancën inauguruese, kërkon nga subjektet politike të përfaqësuara në Kuvend ta caktojnë nga një deputet në Komisionin për Mandate dhe Imunitete, i cili verifikon mandatin e deputetëve. Andaj, themelimi i komisionit për mandate dhe imunitete është në pajtim me Rregulloren e Punës.

Procesi i votimit

- Në fillim të seancës plenare më 9 janar, Kryesuesi i ftoi subjektet politike ose komunitetet me të drejtë vendi në Kryesi sipas Kornizës Kushtetuese, që t'i propozojnë kandidatët e tyre për anëtarë të Kryesisë. Z. Ramë Buja (PDK) propozoi z. Jakup Krasniqin dhe z. Xhavit Halitin duke shtuar se z. Krasniqi është kandidati për Kryetar të Kuvendit. Znj. Nekibe Kelmendi (LDK) propozoi z. Eqrem Kryeziu dhe z. Sabri Hamiti derisa z. Ibrahim Makolli (AKR) propozoi z. Ibrahim Gashi, dhe z. Lulzim Zeneli (LDD) propozoi z. Nexhat Daci. Z. Slavisa Petkovic (SDSKiM) deklaroi se dhjetë deputetë serb të Kuvendit akoma nuk kishin arritur marrëveshje andaj përfaqësuesi i tyre për Kryesi do të propozohet në një datë të mëvonshme. Sidoqoftë, z. Bojan Stojanović (SLS) deklaroi se grupi i tij parlamentar² e propozon z. Slobodan Petrović (SLS) për anëtar të Kryesisë. Z. Mahir Yağcılar (grupi parlamentar "7+/KDTP")³ deklaroi se grupi i tij parlamentar propozon z. Dzezair Murati (Vakat) që të shërbej i pari në Kryesi si përfaqësues i komuniteteve jo-shqiptare dhe jo-serbe në pajtim me marrëveshjen për rotacion. Z. Yağcılar nuk dha më tepër detaje lidhur me planin rotacional. Z. Sabit Rrahmani (PDAK/Ashkali) e kundërshtoi propozimin e z. Yağcılar me argumentin se edhe partia e tij duhet të përfaqësohet në Kryesi sepse ka tri vende në Kuvend sikurse Vakat dhe KDTP. Ai kërkoi që

2 Z. Bojan Stojanović njoftoi se pesë nga dhjetë deputetët serb dhe një deputat goran i Kuvendit të Kosovës kanë formuar grupin parlamentar të quajtur SLS dhe se ai do të jetë shef i grupit.

3 Grupi parlamentar "7+" përbëhet nga shtatë deputetë – tre boshnjak (Vakat), tre turq (KDTP) dhe një rom (PReBK).

komuniteti ashkali të jetë pjesë e planit të rotacionit. Z. Numan Balić (SDA/ Bosniak) poashtu e kundërshtoi propozimin e z. Yağcılar me argumentin se edhe partia e tij me dy ulëse në Kuvend duhet të jetë pjesë e planit rotacional. Kryesuesi deklaroi se dy anëtarët e Kryesisë nga radhët e komuniteteve jo-shumicë do të zgjedhen në njërën nga seancat e aradhës pas arritjes së marrëveshjes në mes tyre. Ai më pas vazhdoi duke ftuar Kuvendi që t'i votojë gjashtë të propozuarit *en bloc* të cilët u miratuan me 88 vota për dhe një kundër.

Sipas kreut 9.1.7 të Kornizës Kushtetuese dhe rregullave 4.1-2 të Rregullores së Kuvendit Kyesia përbëhet prej tetë anëtarëve prej të cilëve (a) Dy anëtarë nga partia ose koalicioni që ka fituar numrin më të madh të votave në zgjedhjet për Kuvend; (b) Dy anëtarë nga partia ose koalicioni i dytë me numrin më të madh të votave; (c) Një anëtar nga partia ose koalicioni i tretë me numrin më të madh të votave; dhe (ç) Një anëtar nga partia ose koalicioni i katërt me numrin më të madh të votave. Për më tepër, kreu 9.1.8 i Kornizës Kushtetuese dhe rregulla 4.3 parashohin që Kuvendi të miratojë emërimin e anëtarëve të Kryesisë me votim formal. Andaj, procedura e votimit të gjashtë të propozuarve për Kryesi të përmendur më lartë, ishte në pajtim me kreun 9.1.7 dhe 9.1.8 të Kornizës Kushtetuese dhe rregullave 4.1 – 4.3. Për më shumë detaje lidhur me emërimin e dy anëtarëve të Kryesisë nga radhët e komuniteteve jo-shumicë, shiko më poshtë pjesën e titulluar “Qasja dhe pjesëmarrja e barabartë e komuniteteve”.

- Pas emërimit Kryetar i Kuvendit z. Jakup Krasniqi (PDK) e kryesoi pjesën e mbetur të seancës. Kryetari i Kuvendit njoftoi se Kryetari i Kosovës Fatmir Sejdiu kishte dhënë dorëheqje dhe se dorëheqja e tij ishte pranuar nga PSSP-ja, dhe ftoi PDK-në dhe LDK-në si partnerë të koalicionit qeverisës që të propozojnë kandidatin për Kryetar të Kosovës. Në emër të PDK-së dhe LDK-së, z. Eqrem Kryeziu e propozoi sërisht z. Fatmir Sejdiu për Kryetar të Kosovës. Në emër të partive opozitare, z. Ahmet Isufi (AAK) propozoi z. Naim Malokun (AAK) për Kryetar duke shtuar se ai kishte mbështetjen e mbi 25 deputetëve. Kryetari i Kuvendit njoftoi se procedura e votimit do të jetë në pajtueshmëri të plotë me Kornizën Kushtetuese: votimi do të jetë me votë të fshehtë dhe se kërkohen votat e dy të tretave të deputetëve në dy raundet e para të votimit. Kryetari i Kuvendit e filloi procedurën e votimit duke ftuar nga një përfaqësues nga secili grup parlamentar në cilësinë e vëzhguesit për të dëshmuar vendosjen e fletëvotimit në kutinë e votimit dhe numërimin e votave. Në raundin e parë z. Sejdiu mori 62 vota dhe z. Maloku mori 37 vota derisa 16 fletëvotime u shpallën të pavlefshme nga numri i përgjithshëm prej 115 fletëvotimeve të vendosura në kuti. Meqë asnjëri prej kandidatëve nuk 80 votat e nevojshme, procedura e përsërit. Në raundin e dytë z. Sejdiu mori 61 vota dhe z. Maloku 37, derisa 17 fletëvotime u shpallën të pavlefshme nga numri i përgjithshëm prej 115 fletëvotimeve të vendosura në kuti. Në raundin e tretë të votimit z. Sejdiu u rizgjodh Kryetar i Kosovës me 68 vota për, ndërsa z. Maloku mori 39 vota për dhe 11 fletëvotime u shpallën të pavlefshme nga numri i përgjithshëm prej 118 fletëvotimeve të vendosura në kuti.

Procedura e përdorur për zgjedhjen e Kryetarit të Kosovës ishte në pajtim me kreun 9.2.8 të Kornizës Kushtetuese dhe rregullës 16, të cilat kërkojnë që Kryetari i Kosovës të zgjedhet me votim të fshehtë dhe se kandidati që merr dy të tretat ose më shumë vota të deputetëve të Kuvendit në ndonjërin prej dy raundeve të para, ose shumicën e votave të të gjithë deputetëve të Kuvendit në raundin vijues. Propozimi i kandidatit nga opozita poashtu ka qenë në pajtim me kreun 9.2.8 i cili parasheh që “(a) nominimi i Kryetarit të Kosovës kërkon mbështetjen e partisë që ka siguruar numrin më të madh të vendeve në Kuvend ose që ka mbështetjen e së paku 25 deputetëve të Kuvendit.”

Caktimi i vëzhguesve nga secili grup parlamentar nuk kërkohet në Kornizën Kushtetuese apo Rregulloren e Punës por është një akt i mirseardhur që ka shërbyer për bërjen e procesit të votimit më transparent.

- Pas rizgjedhjes si Kryetar i Kosovës dhe pas dhënies së fjalimit me rastin e pranimit të detyrës, z. Fatmir Sejdiu formalisht propozoi z. Hashim Thaçi (PDK) për Kryeministër të Kosovës. Z. Thaçi i paraqiti Kuvendit listën e kandidatëve të propozuar për zëvendëskryeministra, ministra dhe zëvendësministra, duke theksuar se disa zëvendësministra nga radhët e komuniteteve joshumicë do të propozohen pas disa konsultimeve të mëtjeshme. Kuvendi e zgjodhi z. Thaçi së bashku me zëvendëskryeministrat, ministrat dhe zëvendësministrat e propozuar me 85 vota për, 22 vota kundër dhe katër abstenime.

Në seancën plenare të 15 shkurtit Kuvendi miratoi emërimin e tre zëvendësministrave shtesë nga radhët e komuniteteve joshumicë. Zëvendësministri për arsim, shkencë dhe teknologji dhe zëvendësministri për qeverisje lokale dhe administratë janë propozuar nga Vakati (komuniteti boshnjak) derisa zëvendësministri për punë të brendshme është propozuar nga SLS-ja (komuniteti serb i Kosovës). Të tre propozimet janë miratuar *en bloc* me 81 vota për, 16 vota kundër dhe tre abstenime.

Në pajtim me kreun 9.3.8 të Kornizës Kushtetuese, pas zgjedhjeve Kryetari i Kosovës në konsultim me partitë politike të përfaqësuara në Kuvend, ia propozon Kuvendit një kandidat për Kryeministër. Kryeministri bashkë me ministrat zgjidhen nga shumica e deputetëve të Kuvendit, që d.m.th. mbështetjen e së paku 61 deputetëve të Kuvendit. Për më tepër, sipas kreut 2.1 të rregullores 2004/05 mbi themelimin e ministrive të reja dhe paraqitjen e posteve të zëvendës kryeministrit dhe zëvendës ministrave në degën e ekzekutivit, zëvendës kryeministrat dhe zëvendës ministrat emërohen pas miratimit të kandidatëve në fjalë nga Kuvendi. Procedura e votimit për zgjedhjen e Qeverisë dhe zgjedhjen e zëvendës ministrave më vonë është në pajtim me Kornizën Kushtetuese dhe rregulloren 2004/50.

Ndryshimi i Kornizës Kushtetuese

- Më 8 janar, Ahmet Isufi zëvendës kryetar i AAK-së dhe deputet i Kuvendit i ka paraqitur një letër Kryesisë ku ka kërkuar nisjen e procedurës për ndryshimin e kreut 9.1.7 të Kornizës Kushtetuese për t'i mundësuar AAK-së përfaqësimin në Kryesi. Në letërën e njëjtë AAK-ja ka propozuar z. Naim Malokun për të shërbyer në Kryesi. Kryesia, në mbledhjen e mbajtur më 28 janar është pajtuar

me këtë kërkesë dhe ka vendosur që ta përfshijë në rendin e ditës të seancës plenare të 31 janarit për shqyrtim. Në seancën plenare të 31 janarit me rastin e diskutimit të kërkesës së AAK-së, shefat e secilit prej grupeve parlamentare e mbështetën atë. Z. Sabri Hamiti (LDK) megjithatë theksoi se ndryshimi i Kornizës Kushtetuese apo zgjerimi edhe për një anëtar i Kryesisë nuk janë çështje urgjente. Pas përfundimit të debatit Kryetari i Kuvendit e hedhi në votim kërkesën për ndryshimin e kreut 9.1.7 të Kornizës Kushtetuese e cila u miratua me 89 vota për, një votë kundër dhe katër abstenime. Kërkesa i është përcjellur PSSP-së i cili ka autoritetin për ndryshimin e Kornizës Kushtetuese. Pas kërkesës së bërë nga Kuvendi, më 8 shkurt PSSP-ja ndryshoi kreun 9.1.7 të Kornizës Kushtetuese duke i shtuar një nënparagraf (e) pas nënparagrafit ekzistues (d), i cili parasheh që “një anëtar i Kryesisë emërohet nga partia apo koalicioni i cili ka marrë numrin e pestë më të madh të votave në zgjedhjet për Kuvendin e Kosovës.” Në seancën plenare të 15 shkurtit Kuvendi formalisht ka miratuar emërimin e z. Naim Maloku (AAK) për anëtar të Kryesisë me shumicë votash për dhe pa vota kundër, nga 108 deputetë të pranishëm në sallë. *Sipas kreut 14.3 të Kornizës Kushtetuese, PSSP-ja me iniciativën e tij ose me kërkesë të mbështetur nga dy të tretat e anëtarëve të Kuvendit që do të thotë së paku 80 vota, mund të ndryshojë Kornizën Kushtetuese. Andaj, procedura për ndryshimin e kreut 9.1.7 të Kornizës Kushtetuese dhe emërimi i mëposhtëm i z. Maloku për anëtar të Kryesisë janë bërë në pajtim me Konrizen Kushtetuese përkatësisht me versionin e ndryshuar të saj.*

Mocionet procedurale

- Në fillim të seancës plenare të 15 shkurtit Kryetari i Kuvendit deklaroi se gjashtë grupe parlamentare kanë propozuar një mocion procedural për t'u shmangur nga Rregullorja e Punës në mënyrë që t'i shqyrtojë dhe miratojë me procedurë të shkurtuar ligjet a parapara në “Propozimin Gjithëpërfshirës për Zgjidhjen e Statusit të Kosovës” të të Dërguarit të Posaçëm të OKB-së (në vazhdim propozimi i Ahtiaarit). Sipas mocionit procedural:

“(1) Shqyrtimi i parë i ligjeve do të bëhet brenda 24 orëve nga paraqitja e tyre në Kuvend. Brenda 24 orëve këto ligje do të shqyrtohen nga komisioni *ad hoc*. Pa paragjykuar kontributin e kërkuar nga komisionet kryesore, komisioni *ad hoc* do t'i përmbush përgjegjësitë që zakonisht u caktohen komisioneve funksionale. Shqyrtimi i dytë i ligjeve do të bëhet jo më vonë se 48 orë pas paraqitjes së tyre në Kuvend.

(2) Komisioni *ad hoc* do të përbëhet nga 9 anëtarë, duke pasur parasysh përfaqësimin e barabartë të të gjitha komuniteteve. Përbërja do ta reflektojë përfaqësimin në Kryesinë e Kuvendit.

(3) Propozimet për ndryshime të natyrës përmbajtësore mund të bëhen vetëm nëse konsiderohen të nevojshme dhe atë nga dy të tretat e anëtarëve të komisionit *ad hoc*. Ligjet miratohen nga Kuvendi me mbështetjen e shumicës së deputetëve të Kuvendit. Ligjet hyjnë në fuqi pas hyrjes në fuqi të Kushtetutës dhe pas nënshkrimit nga Kryetari i Kosovës.

(4) Çdo grupi parlamentar do t'i lejohet 5 minuta për komente gjatë shqyrtimit të dytë.

(5) Deklaratat financiare të ligjeve do të dorëzohen në Kuvend brenda 60 ditësh dhe jo më vonë se 180 ditë pas miratimit të ligjeve.”

Z. Bojan Stojanović, shef i grupit parlamentar SLS, deklaroi se grupi i tij nuk e kundërshton mocionin por do të abstenojë meqë nuk ishte pjesë e Kuvendit të mëparshëm, kur ishte miratuar propozimi i Ahtisaarit. Gjashtë grupe parlamentare i propozuan kandidatët e tyre për komisionin *ad hoc* derisa shefi i grupit parlamentar SLS deklaroi se grupi i tij nuk ka vendosur ende dhe se do të vendos më vonë.⁴ Disa deputetë e kundërshtuan procedurën e propozuar duke e konsideruar atë të ngutshme dhe jo në pajtueshmëri me praktikat parlamentare. Megjithatë, Kuvendi e miratoi mocionin procedural për shmangie nga rregullorja, me 80 vota për, gjashtë vota kundër dhe katër abstenime. *Sipas rregullës 61, “Për shmangiet nga Rregullorja e punës mund të vendos Kuvendi me dy të tretat e shumicës së deputetëve të pranishëm.” Andaj, Kuvendi ka të drejtë që të shmanget përkohësisht nga rregullorja e tij e punës. Mocioni i lartëpërmendur procedural, përpos pikës (5) që ka të bëjë me dorëzimin e deklaratave financiare, ishte në pajtim me rregullën 61. neni 9.1.11 i Kornizës Kushtetuese parasheh që “Komisioni për Buxhet është përgjegjës për të garantuar se të gjitha projektligjet që kanë implikime buxhetore do të shoqërohen nga një deklaratë financiare.” Kjo dispozitë nuk len hapësirë për të vendosur që deklarata financiare e projektligjit të dorëzohet brenda 60 deri në 180 ditë pas miratimit të ligjit nga ana e Kuvendit. Edhe pse Kuvendi ka të drejtë të shmanget nga Rregullorja e vetë, ai nuk ka drejtë të shmanget nga dispozitat e Kornizës Kushtetuese. Andaj, secili projektligj që i dorëzohet Kuvendit duhet ta ketë deklaratën financiare..*

- Më vonë gjatë seancës plenare më 15 shkurt, Kryetari i Kuvendit e paraqiti edhe një tjetër mocion procedural për shmangie nga rregullorja në mënyrë që të mundësohet shqyrtimi i parë dhe i dytë i projektligjin për buxhetin e konsoliduar të Kosovës për vitin 2008 gjatë seancës në fjalë. Grupet parlamentare të PDK-së, LDK-së, LDD-së, AKR-së, 7+, dhe SLS-it e mbështetën mocionin derisa AAK-ja e kundërshtoi atë dhe kërkoi më shumë kohë për ta shqyrtuar projektligjin për BKK-në. Megjithëkëtë, Kryetari i Kuvendit e hedhi në votim mocionin procedural i cili u miratua me 86 vota për, 10 vota kundër dhe 2 abstenime. Pas miratimit të mocionit Kuvendi bëri shqyrtimin e parë të projektligjit për BKK-në dhe e miratoi atë me 75 vota për dhe 12 vota kundër. Pas një pauze të shkurtër Kuvendi bëri shqyrtimin e dytë të projektligjit për BKK-në. Z. Gani Koci (PDK) kryesues i komisionit për buxhet dhe financa i paraqiti rekomandimet e komisionit në projektligjin në fjalë. Shumica e grupeve parlamentare i mbështetën rekomandimet e komisionit për buxhet, por grupet parlamentare të AAK-së dhe LDD-së i kundërshtuan rekomandimet dhe deklaruan se do të votojnë kundër projektligjit për BKK-në. Më pas, Kryetari i Kuvendit e hedhi në votim projektligjin për BKK-në për vitin 2008 i cili u miratua me 73 vota për dhe 13 vota kundër.

Mocioni procedural lidhur me miratimin e Buxhetit të Konsoliduar të Kosovës prë 2008 ishte në pajtim me Rregullën 61.

4 Komisioni *ad hoc* përbëhet prej nëntë anëtarëve ku grupet parlamentare PDK dhe LDK kanë nga dy anëtarë, derisa AKR-ja, AAK, LDD, 7+ dhe SLS kanë nga një anëtar.

Komisionet

- Kryesia, në mbledhjen e mbajtur më 15 janar, ka diskutuar propozimin për rritjen e numrit të komisioneve parlamentare nga dhjetë në 13 sosh prej të cilave 11 komisione të përhershme do të kishin njëmbëdhjetë anëtarë secili, përveç komisionit për buxhet dhe financa dhe komisionit për të drejtat dhe interesat e komuniteteve, përbërja e të cilave definohet me Kornizë Kushtetuese.⁵ Sipas propozimit në fjalë grupet parlamentare të PDK-së dhe LDK-së do t'i kryesonin nga tri komisione secili, grupi parlamentar i AKR-së dhe AAK-së do t'i kryesonin nga dy komisione secili, derisa grupet parlamentare të LDD-së, 7+, dhe SLS-it do të kryesojnë nga një komision secili.⁶ Z. Nexhat Daci (LDD) e kundërshtoi propozimin për shpërndarjen e dy posteve të kryesuesve të komisioneve AAK-së dhe një LDD-së duke debatuar se LDD-ja ka fituar një vend më shumë se AAK-ja në zgjedhjet parlamentare.⁷ Z. Xhavit Haliti (PDK) deklaroi se postet e kryesuesve të komisioneve u ndahen proporcionalisht grupeve parlamentare, jo subjekteve politike. Ai theksoi se grupet parlamentare mund të jenë kolaicione të formuara në Kuvend pas zgjedhjeve duke shtuar se meqë grupi parlamentar AAK ka dy deputetë më shumë se LDD-ja, e ka të drejtën për të kryesuar një komision më shumë se LDD-ja. Kryetari i Kuvendit debatoi se koalicionet me partive mund të formohen para zgjedhjeve sipas Kornizës Kushtetuese e jo pas zgjedhjeve. Z. Daut Beqiri kryesues i departamentit për mbështetje ligjore dhe procedurale shpjegoi se postet e kryesuesve të komisioneve u ndahen grupeve parlamentare në proporcion me vendet që i kanë në Kuvend e jo në bazë të numrit të vendeve të fituara nga partitë në zgjedhje. Z. Eqrem Kryeziu (LDK) propozoi që Kryesia të konsultohet me komunitetin ndërkombëtar në këtë çështje. Kështu, Kryetari dhe anëtarët e tjerë të Kryesisë u pajtuan që të kërkojnë shpjegim ligjor në këtë çështje nga Zyra Ligjore e UNMIK-ut. Këshilltari ligjor në letrën e tij ka konfirmuar se postet e kryesuesve të komisioneve u ndahen grupeve parlamentare në përpjestim me numrin e vendeve që ato kanë në Kuvend sipas Kornizës Kushtetuese. Kryesia në mbledhjen e mbajtur më 21 janar, bazuar në shpjegimin ligjor të Zyrës Ligjore të UNMIK-ut, ka miratuar propozimin e përmendur më lartë mbi shpërndarjen e posteve të kryesuesve të komisioneve dhe e ka përfshirë atë në rendin e ditës së seancës plenare të 31 janarit për miratim.

5 Sipas kreut 9.1.11 dhe 9.1.12 të Kornizës Kushtetuese, Komisioni për buxhet dhe financa përbëhet prej dymbëdhjetë deputetëve, derisa Komisioni për të drejtat dhe interesat e komuniteteve përbëhet prej dy deputetëve nga secili komuniteteve i Kosovës i përfaqësuar në Kuvend.

6 Grupi parlamentar i PDK-së do t'i kryesojë komisionin për buxhet dhe financa; komisionin për çështje gjyqësore dhe legjislative; dhe komisionin për punë të brendshme dhe siguri; Grupi parlamentar i LDK-së do ta kryesojë komisionin për arsim, shkencë, teknologji, kulturë, rini dhe sport; komisionin për të drejtat e njeriut, barazi gjinore, persona të zhdukur dhe peticione publike; dhe komisionin për punë të jashtme. Grupi parlamentar i AKR-së do ta kryesojë komisionin për ekonomi, tregti, industri, energji, transport, dhe telekomunikacion; dhe komisionin për shërbime publike, administratë lokale dhe media; Grupi parlamentar i AAK-së do ta kryesojë komisionin për integritet evropian; dhe komisionin për mandate dhe rregulloren e punës; Grupi parlamentar i LDD-së do ta kryesojë komisionin për bujqësi, pylltari, zhvillim rural, ambient dhe planifikim hapësinor; Grupi parlamentar 7+ do ta kryesojë komisionin për shëndetësi, punë dhe mirëqenie sociale; dhe Grupi parlamentar SLS do ta kryesojë komisionin për të drejtat dhe interesat e komuniteteve dhe kthim.

7 Më 9 janar, AAK-ja (10 vende), SDA (2 vende) dhe IRDK (1 vend) kanë formuar një grup parlamentar të përbashkët me emrin AAK, i cili numëron 13 deputetë. Grupi parlamentar LDD ka 11 deputetë.

Në seancën plenare të 31 janarit Kuvendi ka miratuar propozimin për numrin e komisioneve dhe anëtarëve të tyre me 86 vota për dhe pa vota kundër. Për sa i përket propozimit për emërimin e kryesuesve të komisioneve, zëvendës kryesuesve dhe anëtarëve, z. Slaviša Petković u ankua se partia e tij nuk ishte konsultuar lidhur me shpërndarjen e anëtarësisë së komisioneve për subjektet e serbëve të Kosovës. Andaj, Kryetari i Kuvendit e shtyu votimin për përbërjen e komisionit për të drejtat dhe interesat e komuniteteve në mënyrë që t'u lejohet më shumë kohë për konsultime në mes të subjekteve serbe në Kuvend. Kryetari i Kuvendit e hedhi në votim *en bloc* përbërjen e propozuar të dymbëdhjetë komisioneve tjera e cila u miratua me 83 vota për dhe dy vota kundër. Përbërja e komisionit për të drejtat dhe interesat e komuniteteve është miratuar në seancën plenare të radhës të mbajtur më 15 shkurt me shumicë votash për dhe pa vota kundër.

Rregullat 11.1-11.3 parashohin që “Grupi parlamentar është grupim politik i përbërë nga jo më pak 6 deputetë të Kuvendit në funksion të një qëllimi politik të përbashkët. Emri i Kryetarit dhe i anëtarëve të grupit parlamentar i komunikohen me shkrim Kryetarit dhe Kryesisë së Kuvendit.” Grupi parlamentar mund të jetë koalicioni i formuar në Kuvend në mes dy a më tepër subjekteve politike. Andaj, formimi i grupit parlamentar të përbashkët në mes të AAK-së, SDA-së dhe IRDK-së është në pajtim me Rregulloren e Punës siç është poashtu edhe formimi i grupit parlamentar 7+ dhe SLS. AAK-ja, SDA-ja dhe IRDK-ja poashtu ia kanë komunikuar me shkrim vendimin e tyre Kryetarit dhe Kryesisë ashtu siç kërkohet me rregullën më lartë. Sa i përket shpërndarjes së posteve të kryesuesve të komisioneve, rregulla 42.4 parasheh që “Në marrëveshjen për shpërndarjen e posteve për kryetarë të komisioneve midis grupeve parlamentare, Kryesia merr parasysh proporcionin e forcës së grupeve parlamentare.” Është e qartë se postet e kryesuesve të komisioneve u shpërndahen grupeve parlamentare në përpjestim me numrin e vendeve që ato kanë në Kuvend. Andaj, ndarja e dy posteve të kryesuesit të komisioneve për grupin parlamentar të AAK-së kundrejt një posti të tillë ndarë grupit parlamentar të LDD-së ishte në pajtim me Rregulloren e Punës.

4. Qasja dhe pjesëmarrja e barabartë e komuniteteve

- Më 15 janar tetë nga dhjetë deputetët serbë të Kosovës⁸ në Kuvend i kanë dorëzuar Kryesisë një letër në të cilën tregojnë që të gjithë ishin pajtuar që ta emërojnë z. Slobodan Petrović (SLS) për anëtar të Kryesisë për t'i përfaqësuar subjektet politike serbe të Kosovës në Kuvend. Kryesia, në mbledhjen e mbajtur më 28 janar, ka vendosur që ta përfshijë emërimin e z. Petrović në rendin e ditës së seancës plenare të 31 janarit për miratim formal nga ana e Kuvendit. Në mbledhjen e mbajtur më 29 janar, deputetët e grupit parlamentar “7+” dhe z. Xhevdet Neziri (IRDK/Egjiptas) me ndërmjetësimin e anëtarit të Kryesisë Xhavit Haliti (PDK) dhe sekretarit të Kuvendit Ismet Krasniqi kanë

⁸ Vetëm z. Slaviša Petković (SDSKiM) dhe Vladimir Todorović (SDSKiM) nuk e kanë mbështetur emërimin e z. Slobodan Petrović për anëtar të Kryesisë.

arritur një marrëveshje sipas së cilës subjektet joshqiptare dhe joserbe do të përfaqësohen në Kryesi, bazuar në planin rotacional si vijon:

- gjatë vitit të parë të mandatit (12 muaj) – koalicioni Vakati (boshnjakët);
- gjatë vitit të dytë të mandatit (12 muaj) – KDTP (turqit);
- gjatë vitit të tretë dhe të katërt të mandatit – nga gjashtë muaj secili: PDAK (ashkalinjtë), SDA (boshnjakët), IRDK (egjiptasit) dhe PReBK (romë).

Sipas planit rotacional z. Džezair Murati (Vakati) do të jetë anëtar i Kryesisë gjatë vitit të parë.

Në fillim të seancës plenare të 31 janarit, Kryetari i Kuvendit lajmëroi se subjektet joshqiptare dhe joserbe në Kuvend kanë arritur një marrëveshje lidhur me përfaqësimin e tyre në Kryesi dhe se emërimi i anëtarit të tyre do t'i shtohet rendit të ditës së asaj seance plenare. Z. Numan Balić (SDA) kundërshtoi këtë marrëveshje me argumentin se askush nuk i kishte konsultuar përfaqësuesit e SDA-së, PDAK-së dhe GIG-ut, të cilët gjithë së bashku kanë gjashtë vende në Kuvend, dhe ai kërkoi që kjo çështje të shtyhet. Z. Slaviša Petković poashtu e kundërshtoi emërimin e z. Petrović për anëtar të Kryesisë. Kryetari i Kuvendit megjithatë vazhdoi duke e hedhur në votim propozimin për përfshirjen e kësaj çështjeje në rendin e ditës, i cili është miratuar me 82 vota për, tetë vota kundër dhe nëntë abstenime. Më vonë gjatë asaj seance Kryetari i Kuvendit e hedhi në votim formal *en bloc* miratimin e emërimit të z. Petrović dhe z. Murati për anëtarë të Kryesisë. Emërimet janë miratuar me 89 vota për, katër vota kundër dhe pa abstenime.

Kreu 9.1.7 (e)⁹ i Kornizës Kushtetuese parasheh që një anëtar i Kryesisë “do të emërohet nga radhët e atyre deputetëve të Kuvendit që u përkasin partive, të cilët janë deklaruar se e përfaqësojnë komunitetin serb”. Me propozimin për emërimin e z. Petrović për anëtar të Kryesisë janë pajtuar dhe e kanë nënshkruar tetë nga dhjetë deputetë që u përkasin komunitetit serb të Kosovës. Emërimi i z. Petrović konsiderohet i vlefshëm meqë ka marrë mbështetjen e shumicës së gjërë të deputetëve serbë.

Kreu 9.1.7 (f) i Kornizës Kushtetuese parasheh që një anëtar i Kryesisë “do të emërohet nga radhët e atyre deputetëve të Kuvendit që u përkasin partive, të cilët janë deklaruar se e përfaqësojnë komunitetin joshqiptar dhe joserb. Mënyra për emërimin e këtij anëtarit të mëvonshëm do të caktohet nga deputetët e Kuvendit që u përkasin këtyre komuniteteve.” Për planin rotacional janë pajtuar dhe e kanë nënshkruar tetë¹⁰ nga katërmëdhjetë deputetë të Kuvendit që u përkasin komuniteteve joshqiptare dhe joserbe. Megjithatë, katër deputetë të tjerë (tre PDAK dhe një GIG) nuk e kanë kundërshtuar marrëveshjen e paraqitur në seancën plenare të 31 janarit. Në këtë mënyrë, shumica e deputetëve janë marrë vesh lidhur me mënyrën e emërimit të përfaqësuesit të tyre në Kryesi, dhe vendimet mund të mirren nga shumica e deputetëve të përfshirë, përveç nëse është e saktësuar ndryshe.

9 Të kihet parasysh se pas ndryshimit të kreut 9.1.7 të Kornizës Kushtetuese nga PSSP-ja me kërkesë të Kuvendit, nënparagrafet (e) dhe (f) të cilave iu është referuar në komentnin më lartë janë riradhitur si (f), përkatësisht (g).

10 KDTP (tre deputetë), Vakati (tre deputetë), PReBK (një deputet) dhe IRDK (një deputet).

5. Qasja

Gjatë periudhës raportuese, Shtylla e III-të (OSBE) ka pasur qasje në seancat plenare dhe në mbledhjet e Kryesisë. Shtylla e III-të gjithashtu ka pranuar kopjet e dokumentave të shqyrtuara nga Kuvendi si dhe transkriptin e seancave të kaluara.

6. Transparenca

Në fillim të seancës plenare të 15 shkurtit Kryetari i Kuvendit lajmëroi se rezultati i votimit elektronik do të shtypet dhe do t'u shpërndahet të gjithë deputetëve të Kuvendit dhe do të publikohet në uebfaqen e Kuvendit duke filluar që nga seanca në fjalë.

Shtylla III (OSBE) dhe Instituti Kombëtar Demokratik (NDI) i kanë rekomanduar Kuvendit të mëparshëm në vitin e kaluar që t'i publikojë rezultatet e votimit elektronik, por një rekomandim i tillë ka hasur në hezitim tek disa grupe parlamentare. Sidoqoftë, gatishmëria e tanishme për publikimin e rezultatit të votimit është zhvillim tejet pozitiv në rritjen e transparencës së Kuvendit, e posaçërisht përgjegjësisë së deputetëve ndaj zgjedhësve të tyre.

Radio Televizioni i Kosovës ka siguruar transmetimin e drejtpërdrejtë të seancave plenare në fjalë. Publikut dhe monitoruesve institucional iu është mundësuar hyrja në seancat plenare. Kuvendi ka web-faqen (www.assembly-kosova.org) që përmban detaje biografike të deputetëve të Kuvendit, informacione për strukturën dhe funksionimin e Kuvendit, kopje të ligjeve dhe rezolutave të miratuara nga Kuvendi, si dhe informacione të tjera në gjuhën shqipe, serbe dhe angleze.

FUND.



Organization for Security and
Co-operation in Europe
Mission in Kosovo

Shtylla III (OSBE)

Raporti 02/2008

Mbi monitorimin e Kuvendit të Kosovës

16 shkurt 2008 – 31 mars 2008

Titujt kryesor

- Kuvendi mban seancë të jashtëzakonshme për shpalljen e Pavarësisë së Kosovës
- Kuvendi miraton 19 ligje të lidhura me propozimin gjithëpërfshirës për zgjedhjen e statusit të Kosovës
- Kuvendi miraton në parim 27 projektligje
- Kuvendi has në vështirësi lidhur me raportimin gojor të agjensioneve të pavarura
- Qeveria dështon për t'u përgjigjur në katër pyetje të parashtruara nga deputetët
- Rezultati i votimit elektronik nuk është publikuar ende në faqen e internetit të Kuvendit

1. Sfond

Raporti i pesëdhjetegjashtë i monitorimit është hartuar në përputhje me pikëpamjet referuese të Shtyllës së tretë të UNMIK-ut për themelimin e institucioneve (OSBE) dhe monitorimin e Kuvendit të Kosovës prej datës 26 nëntor 2002 dhe bazohet në Rregulloren e re të punës, të miratuar në fund të seancës plenare më 20 maj 2005 dhe të reviduar në seancën plenare të mbajtur më 1-2 qershor 2006 dhe 18 shtator 2007.

Shtylla e III-të (OSBE) ka monitoruar seancën e jashtëzakonshme plenare të mbajtur më 17 shkurt dhe pesë seanca plenare të rregullta më 19 dhe 20 shkurt, më 26, 27, 28, 29 shkurt dhe 3 mars, më 12 dhe 13 mars, më 14 mars, dhe më 28 mars si dhe pesë mbledhje të Kryesisë, më 17 shkurt, 18 shkurt, 21 shkurt, 10 mars dhe 25 mars. Shtylla III (OSBE) ka monitoruar 24 nga 41 mbledhje të komisioneve dhe një dëgjim publik.

2. Vështrim

Seancën e jashtëzakonshme plenare të Kuvendit të Kosovës të mbajtur më 17 shkurt e kryesoi Kryetari i Kuvendit z. Jakup Krasniqi (Partia Demokratike e Kosovës/PDK), i ndihmuar nga anëtarë të Kryesisë Eqrem Kryeziu (Lidhja Demokratike e Kosovës/LDK).

- Njëqind e nëntë deputetë ishin të pranishëm në seancën e jashtëzakonshme plenare të 17 shkurtit.
- Pikat kryesore të rendit të ditës të seancës së jashtëzakonshme plenare të 17 shkurtit:
 - Shpallja e Pavarësisë së Kosovës (Shpallja është miratuar unanimisht nga të pranishmit.)
 - Miratimi i Flamurit dhe Amblemit (Flamuri dhe Amblemi janë miratuar unanimisht nga të pranishmit.)

Seancën plenare të mbajtur më 19 dhe 20 shkurt e kryesoi Kryetari i Kuvendit z. Jakup Krasniqi (PDK).

- Njëqind e nëntë dhe njëqind deputetë ishin të pranishëm, respektivisht në seancën plenare të 19 dhe 20 shkurtit.
- Pikat kryesore të rendit të ditës të seancës plenare të mbajtur më 19 dhe 20 shkurt:
 - Shqyrtimi i parë dhe i dytë i projektligjit për Ministrinë e Punëve të Jashtme (Projektligji është miratuar në parim në shqyrtimin e tij të parë por i është kthyer Qeverisë gjatë shqyrtimit të dytë.)

- Shqyrtimi i parë dhe i dytë i Projektligjit për privilegjet dhe imunitetet diplomatike
- Shqyrtimi i parë dhe i dytë i Projektligjit për Shtetësinë
- Shqyrtimi i parë dhe i dytë i Projektligjit për Policinë e Kosovës
- Shqyrtimi i parë dhe i dytë i Projektligjit për Inspektoratin Policor të Kosovës
- Shqyrtimi i parë dhe i dytë i Projektligjit për Dokumentet e Udhëtimit
- Shqyrtimi i parë dhe i dytë i Projektligjit për Përdorimin e Simboleve Shtetërore
- Shqyrtimi i parë dhe i dytë i Projektligjit për Zonat e Posaçme të Mbrojtura
- Shqyrtimi i parë dhe i dytë i Projektligjit për Vetëqeverisjen Lokale
- Shqyrtimi i parë dhe i dytë i Projektligjit për Kufijtë Administrativ Komunal (Të nëntë projektligjet janë miratuar *en bloc* me 74 vota për dhe katër vota kundër.¹¹)

Seancën plenare të mbajtur më 26, 27, 28, 29 shkurt dhe 3 mars e kryesoi Kryetari i Kuvendit z. Jakup Krasniqi (PDK) dhe anëtarët e Kryesisë Dzezair Murati (7+/Vakat), Xhavit Haliti (PDK) dhe Eqrem Kryeziu (LDK).

- Nëntëdhjetë e katër, shtatëdhjetë e nëntë, shtatëdhjetë e katër, shtatëdhjetë e një dhe gjashtëdhjetë e shtatë deputetë ishin të pranishëm, respektivisht, në seancën plenare të 26, 27, 28, 29 shkurtit dhe 3 marsit.
- Pikat kryesore të rendit të ditës të seancës plenare të mbajtur më 26, 27, 28, 29 shkurtit dhe 3 marsit:
 - Pyetjet për Qeverinë
 - Zëvendësimi i deputetit të AKR-së në komisionin për buxhet
 - Shqyrtimi i parë i projektligjit për ndryshimin e ligjit për Kodin e Përkohshëm Penal (Projektligji është miratuar në parim me 73 vota për dhe dy vota kundër.)
 - Shqyrtimi i parë i projektligjit për ndryshimin e ligjit për Procedurën e Kodit të Përkohshëm Penal (Projektligji është miratuar në parim me 74 vota për dhe dy vota kundër.)
 - Shqyrtimi i parë i projektligjit për Përfitimet e ish-Zyrtarëve të Lartë (Projektligji është miratuar në parim me 73 vota për dhe dy vota kundër.)
 - Shqyrtimi i parë i projektligjit për ndryshimin e ligjit për Kooperativat Bujqësore (Projektligji është miratuar në parim me 78 vota për dhe pa vota kundër.)
 - Shqyrtimi i parë i projektligjit për Përdorimin Civil të Eksploziveve (Projektligji është miratuar në parim me 77 vota për dhe pa vota kundër.)
 - Shqyrtimi i parë i projektligjit për Procedurën Kontestimore (Projektligji është miratuar në parim me 79 vota për dhe pa vota kundër.)

¹¹ Projektligjet e lartpërmendura janë miratuar brenda dy ditësh në pajtim me mocionin procedural të miratuar në Kuvend në seancën plenare të 15 shkurtit. Siç është përmendur në raportin paraprak, Korniza Kushtetuese parasheh që të gjitha projektligjet që kanë implikime buxhetore duhet të përcillen me deklaratë financiare. Andaj, mocioni procedural për shmangien e këtij kushti për bashkangjitjen e deklaratës financiare nuk është i vlefshëm dhe deklaratat financiare në fjalë janë të nevojshme. Për më shumë detaje shiko raportin 01/2008.

- Shqyrtimi i parë i projektligjit për Procedurën Përmbarese
(Projektligji është miratuar në parim me 69 vota për dhe pa vota kundër.)
- Shqyrtimi i parë i projektligjit për Deklarimin e Prejardhjen e Pasurisë së Zyrtarëve të Lartë Publik
(Projektligji është miratuar në parim me 80 vota për dhe pa vota kundër.)
- Shqyrtimi i parë i projektligjit për ndryshimin e ligjit për Ekzekutimin e Sanksioneve Penale
(Projektligji është miratuar në parim me 79 vota për dhe pa vota kundër.)
- Shqyrtimi i parë i projektligjit për Procedurën Jo Kontestimore
(Projektligji është miratuar në parim me 76 vota për dhe një votë kundër.)
- Shqyrtimi i parë i projektligjit për Parandalimin e Pastrimit të Parasë
(Projektligji është miratuar në parim me 80 vota për dhe pa vota kundër.)
- Shqyrtimi i parë i projektligjit për Noterinë
(Projektligji është miratuar në parim me 81 vota për dhe pa vota kundër.)
- Shqyrtimi i parë i projektligjit për Vlerësimin Strategjik Mjedisor
(Projektligji është miratuar në parim me 78 vota për dhe një votë kundër.)
- Shqyrtimi i parë i projektligjit për ndryshimin e Ligjit për Skemën e Ndihmës Sociale
(Projektligji është miratuar në parim me 46 vota për dhe 19 vota kundër.)
- Shqyrtimi i parë i projektligjit për ndryshimin e Ligjit për Inspektoratin e Punës
(Projektligji është miratuar në parim me 61 vota për dhe nëntë vota kundër.)
- Shqyrtimi i parë i projektligjit për Mbështetjen Materiale të Familjeve të Fëmijëve me Paaftësi të Përhershme
(Projektligji është miratuar në parim me 77 vota për dhe pa vota kundër.)
- Shqyrtimi i parë i projektligjit për Shtijen e Banesave në të Cilat Ekziston E Drejta Banesore
(Projektligji është miratuar në parim me 59 vota për dhe dhjetë vota kundër.)
- Shqyrtimi i parë i projektligjit për Ndihmën Shtetërore
(Projektligji është tërhequr nga sponsoruesi. Shiko më poshtë pjesën e titulluar “Procesi legjislativ”.)
- Shqyrtimi i parë i projektligjit për Ushqimin
(Projektligji është miratuar në parim me 72 vota për dhe pa vota kundër.)
- Shqyrtimi i parë i projektligjit për Provimin Final dhe të Maturës.
(Projektligji është miratuar në parim me 72 vota për dhe pa vota kundër.)
- Shqyrtimi i parë i projektligjit për Rehabilitimin Profesional dhe Punësimin e Personave me Aftësi të Kufizuara
(Projektligji është miratuar në parim me 73 vota për dhe pa vota kundër.)
- Shqyrtimi i parë i projektligjit për Efiçencën e Energjisë
(Projektligji është tërhequr nga sponsoruesi. Shiko më poshtë pjesën e titulluar “Procesi legjislativ”.)
- Shqyrtimi i parë i projektligjit për ndryshimin e Ligjit për Mbështetjen e Ndërmarrjeve të Vogla dhe të Mesme
(Projektligji është miratuar në parim me 71 vota për dhe pa vota kundër.)

- Shqyrtimi i parë i projektligjit për Tatimin në Vlerën e Shtuar (Projektligji është tërhequr nga sponzoruesi. Shiko më poshtë pjesën e titulluar “Procesi legjislativ”).
- Shqyrtimi i parë i projektligjit për Organizmat e Modifikuar Gjenetikiisht (Projektligji është miratuar në parim me 70 vota për dhe një votë kundër.)
- Shqyrtimi i parë i projektligjit për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis (Projektligji është miratuar në parim me 71 vota për dhe pa vota kundër.)
- Shqyrtimi i parë i projektligjit për Taksën e Vendosijes (Projektligji është miratuar në parim me 68 vota për dhe pa vota kundër.)
- Shqyrtimi i parë i projektligjit për Tokën Ndërtimore, Privatizimin dhe Dhënien me Qira të Tokës Ndërtimore (Projektligji është miratuar në parim me 75 vota për dhe një votë kundër.)
- Shqyrtimi i parë i projektligjit për Inspektoratin Bujqësor (Projektligji është miratuar në parim me 77 vota për dhe pa vota kundër.)
- Shqyrtimi i parë i projektligjit për Mbrojtjen e Mjedisit (Projektligji është miratuar në parim me 68 vota për dhe pa vota kundër)

Seancën plenare të mbajtur më 12 dhe 13 mars e kryesoi Kryetari i Kuvendit z. Jakup Krasniqi (PDK).

- Tetëdhjetë e shtatë dhe njëqind e tre deputetë ishin të pranishëm, respektivisht, në seancat plenare të 12 dhe 13 marsit.
- Pikat kryesore të rendit të ditës të seancës plenare të mbajtur më 12 dhe 13 mars:
 - Shqyrtimi i parë dhe i dytë i Projektligjit për Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe Shërbimit Diplomatik të Kosovës
 - Shqyrtimi i parë dhe i dytë i Projektligjit për Ministrinë e Forcës së Sigurisë së Kosovës
 - Shqyrtimi i parë dhe i dytë i Projektligjit për Forcën e Sigurisë së Kosovës
 - Shqyrtimi i parë dhe i dytë i Projektligjit për Themelimin e Këshillit të Sigurisë së Kosovës
 - Shqyrtimi i parë dhe i dytë i Projektligjit për Të Drejtat e Komuniteteve dhe Pjestarëve të tyre
 - Shqyrtimi i parë dhe i dytë i Projektligjit për Menagjimin e Financave Publike dhe përgjegjësitë
 - Shqyrtimi i parë dhe i dytë i Projektligjit për Financat e Vetëqeverisjes Lokale
 - Shqyrtimi i parë dhe i dytë i Projektligjit për Aviacionin Civil
 - Shqyrtimi i parë dhe i dytë i Projektligjit për Prokurorinë e Posaçme në Kosovë
 - Shqyrtimi i parë dhe i dytë i Projektligjit për Kompetencat, Përzgjedhjen e Lëndëve dhe Caktimin e lëndëve të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve të EULEX-it në Kosovë
(Të dhjetë projektligjet janë miratuar *en bloc* me 83 vota për dhe shtatë vota kundër. Shiko fusnotën 1.)

Seancën plenare të mbajtur më 14 mars e kryesoi Kryetari i Kuvendit z. Jakup Krasniqi (PDK), dhe anëtar i Kryesisë Xhavit Haliti (PDK).

- Nëntëdhjetë e katër deputetë ishin të pranishëm në seancën plenare të 14 marsit.
- Pikat kryesore të rendit të ditës të seancës plenare të 14 marsit:
 - Pyetjet për Qeverinë për përgjigje gojore
 - Shqyrtimi i raportit të Komisionit Rregullativ të Prokurimit Publik për vitin 2007
(Kjo pikë është shtyrë. Shiko më poshtë pjesën e titulluar “Mocioni procedural”.)
 - Shqyrtimi i propozimit të Qeverisë lidhur me emërimin e anëtarëve të Komisionit Qëndror për Regjistrimin e Popullatës dhe Ekonomive Familjare (Emërimi i anëtarëve të Komisionit Qëndror për Regjistrimin e Popullatës dhe Ekonomive Familjare është miratuar me 54 vota për, 29 vota kundër, dhe gjashtë abstenime.)
 - Shqyrtimi i propozimit të Qeverisë lidhur me emërimin e Drejtorit Menagjues të Autoritetit Qëndror Bankar të Kosovës (Emërimi i Drejtorit Menagjues është miratuar me 49 vota për, 14 vota kundër dhe 13 abstenime.)
 - Shqyrtimi i rekomandimit të Komisionit për Shërbime Publike, Administratë Lokale dhe Media lidhur me emërimin e dy anëtarëve në Këshillin e Komisionit të Pavarur të Mediave (Emërimi i anëtarëve është miratuar me 78 vota për dhe një votë kundër.)

Seancën plenare të mbajtur më 28 mars e kryesoi Kryetari i Kuvendit z. Jakup Krasniqi (PDK).

- Nëntëdhjetë e tetë deputetë ishin të pranishëm në seancën plenare të 28 marsit.
- Pikat kryesore të rendit të ditës të seancës plenare të 28 marsit:
 - Pyetjet për Qeverinë për përgjigje gojore
 - Shqyrtimi i parë i projektligjit për Mbrojtjen e Produkteve të Bimëve (Projektligji është miratuar në parim me 75 vota për dhe pa vota kundër.)
 - Shqyrtimi i parë i projektligjit për Parandalimin dhe Kontrollin e Integruar të Ndotjes (Projektligji është miratuar në parim me 85 vota për dhe pa vota kundër.)

3. Punimet dhe praktikat parlamentare në seancat e Kuvendit

Shpërndarja e projektligjeve

- Projektligji për përfitimet e ish zyrtarëve të lartë dhe projektligji për përdorimin civil të eksploziveve u janë shpërndarë deputetëve më 28 janar 2008, derisa

projektligji për parandalimin e pastrimit të parave dhe projektligji për noterinë janë shpërndarë më më 8 shkurt. Andaj, projektligjet janë shpërndarë, respektivisht, 20 dhe 11 ditë pune para shqyrtimit të parë në seancën plenare më 26 shkurt.

Projektligji për ndryshimin e kodit të përkohshëm penal është shpërndarë më 25 janar, projektligji për ndryshimin e procedurës së kodit të përkohshëm penal është shpërndarë më 28 janar, dhe projektligji për procedurën kontestimore është shpërndarë më 1 shkurt. Projektligji për procedurën përmbarese, projektligji për deklarimin e prejardhjes së pasurisë së zyrtarëve të lartë publik, dhe projektligji për ndryshimin e ligjit për ekzekutimin e sanksioneve penale janë shpërndarë më 6 shkurt, derisa projektligji për procedurën jokontestimore është shpërndarë më 8 shkurt, dhe projektligji për vlerësimin strategjik mjedisor është shpërndarë më më 11 shkurt. Andaj, projektligjet janë shpërndarë, respektivisht, 22, 21, 17, 14, 12 dhe 11 ditë pune para shqyrtimit të tyre të parë në seancën plenare më 27 shkurt.

Projektligji për ndryshimin e ligjit për skemën e ndihmës sociale dhe projektligji për ndryshimin e ligjit për inspektoratin e punës janë shpërndarë më 11 shkurt, derisa projektligji për mbështetje materiale të familjeve me fëmijë me aftësi të kufizuara të përhershme dhe projektligji për shitjen e banesave në të cilat ekziston e drejta banesore janë shpërndarë më 12 shkurt, dhe projektligji për vlerësimin e ndikimit në mjedis është shpërndarë më 21 shkurt. Andaj, projektligjet janë shpërndarë, respektivisht, 12, 11 dhe katër ditë para shqyrtimit të tyre të parë në seancën plenare më 28 shkurt.

Projektligji për ushqimin, projektligji për provimin përfundimtar dhe të maturës, dhe projektligji për rehabilitimin profesional dhe punësimin e personave me aftësi të kufizuara janë shpërndarë më 13 shkurt. Projektligji për ndryshimin e ligjit për mbështetjen e ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme është shpërndarë më 14 shkurt, projektligji për mbrojtjen e mjedisit është shpërndarë më 22 shkurt, dhe projektligji për organizmat e modifikuar gjenetikisht është shpërndarë më 25 shkurt. Andaj, projektligjet janë shpërndarë, respektivisht, 11, dhjetë, katër dhe tri ditë pune para shqyrtimit të tyre të parë në seancën plenare më 29 shkurt.

Projektligji për taksën e vendosjes është shpërndarë më 14 shkurt, projektligji për inspektoratin bujqësor është shpërndarë më 15 shkurt, dhe projektligji për token ndërtimore, privatizimin dhe dhënien me qira të tokës ndërtimore është shpërndarë më 21 shkurt. Andaj, projektligjet janë shpërndarë, respektivisht, 11, dhjetë dhe gjashtë ditë pune para shqyrtimit të tyre të parë në seancën plenare më 3 mars.

Projektligji për mbrojtjen e produkteve të bimëve dhe projektligji për parandalimin dhe kontrollin e integruar të ndotjes janë shpërndarë më 11 mars. Andaj, projektligjet janë shpërndarë 11 ditë pune para shqyrtimit të tyre të parë në seancën plenare më 28 mars.

Rregulla 35.1 parasheh që shqyrtimi i parë i projektligjit duhet të bëhet jo më parë se dhjetë ditë pune dhe as më shumë se tri javë pune nga dita pas shpërndarjes së tij. Shumica e projektligjeve në fjalë janë shqyrtuar për herë të parë në pajtim me rregullën 35.1, gjë që paraqet përmirësim në krahasim me

periudhat raportuese të mëhershme. Megjithatë, tetë projektligje janë shqyrtuar për herë të parë pas më shumë se tre javë ose më herët se dhjetë ditë pune nga data e shpërndarjes së tyre, gjë që nuk është në pajtim me rregullën e lartpërmendur. Shpërndarja e këtre ligjeve vtëm gjashtë, katër dhe tri ditë para shqyrtimit të tyre të parë nuk u ka lejuar kohë të mjaftueshme deputetëve për t'i studiuar ato.

Procesi legjislativ

- Në fillim të seancës plenare më 26 mars, Ministri për energji dhe miniera znj. Justina Pula-Shiroka kërkoi tërheqjen e projektligjit për eficiencën e energjisë me arsyetimin se duhet të ripunohet. Kryetari i Kuvendit e hedhi në votim kërkesën e Ministrisë, e cila është miratuar me shumicë votash për dhe një votë kundër. Z. Gani Koci (PDK) propozoi që projektligji për ndihmën shtetërore dhe projektligji për tatimin në vlerën e shtuar t'i kthehen Qeverisë për ripunim të mëtutjeshëm. Ministri Ahmet Shala ministria e të cilit ka sponsoruar të dy projektligjet u pajtua me z. Koci dhe kërkoi që të tërhiqen këto projektligje. Andaj, Kryetari i Kuvendit e hedhi në votë kërkesën për tërheqjen e këtyre dy projektligjeve e cila është miratuar me shumicë votash për dhe dy vota kundër. Z. Ardian Gjini shef i grupit parlamentar të Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës (AAK) kundërshtoi duke thënë se Kuvendi është dashur të debatohet lidhur me tërheqjen e këtyre projektligjeve para votimit.
Tërheqja e projektligjit për eficiencën e energjisë, projektligji për ndihmën shtetërore dhe projektligji për tatimin në vlerën e shtuar është në pajtim me rregullën 35.3 e cila parashihet se "propozuesi mund ta tërheqë projektligjin gjatë shqyrtimit të parë deri para fillimit të procedurës së votimit për miratim në parim." Andaj, Kryetari i Kuvendit nuk është i obliguar ta hedhë në votimin tërheqjen e projektligjeve në fjalë nga sponsoruesit e tyre. Për më tepër, kur sponsoruesi kërkon tërheqjen e projektligjit, nuk mbahet debat.

Raportimi i agjensioneve të pavarura

- Në seancën plenare të 14 marsit, gjatë diskutimit të raportit vjetor 2007 të Komisionit Rregullator të Prokurimit Publik¹² (KRrPP), z. Gani Koci (PDK) kryesues i komisionit për buxhet dhe financa, propozoi që kryesuesi i KRrPP-së ta paraqes gojarisht raportin para Kuvendit sipas nenit 82.2 të Ligjit për prokurim publik, që mund të pasohet pastaj nga debati i deputetëve. Z. Hajredin Kuçi (PDK) poashtu u pajtua me z. Koci dhe arsyetoi se kryesuesi i KRrPP-së është emëruar nga Kuvendi andaj duhet ta paraqes gojarisht raportin para Kuvendit. Kryesuesi i seancës u përgjigj se ai nuk ka vërejtje ndaj raportimit gojor të Kryesuesit të KRrPP-së në Kuvend, por Kryesia e Kuvendit ka vendosur që kryesuesi i komisionit për buxhet dhe financa ta paraqes raportin e KRrPP-së. Andaj, ai i pyeti shefat e grupeve parlamentare nëse ata

12 Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik është agjensia e pavarur rregullator i themeluar me Ligjin për prokurim publik në Kosovë, i shpallur me rregulloren e UNMIK-ut 2004/3 dhe i ndryshuar me rregulloren e UNMIK-ut 2007/20. Kjo çështje është ngritur për herë të parë tani me qëndrueshmëri i bërë më 2007 e ka shëndërruar KRrPP-në në institucion të pavarur i cili i raporton Kuvendit, gjë që në të kaluarën nuk ishte kështu. Sipas këtij ligji, Kryesuesi dhe anëtarët e KRrPP-së propozohen nga Qeveria dhe emërohen nga Kuvendi.

ishin për atë që Kryesuesi i KRRPP-së ta paraqes raportin gojarisht apo jo. Z. Ramë Buja shef i grupit parlamentar të PDK-së propozoi që kjo pikë e rendit të ditës të shtyhet me arsyetimin se Kryesuesi i KRRPP-së nuk mund ta paraqes raportin gjatë asaj seance meqë ai nuk është ftuar zyrtarisht për ta bërë këtë. Z. Sabri Hamiti (LDK) debatoi se Kryesuesi i KRRPP-së nuk ka nevojë të raportojë gojarisht dhe se vetëm deputetët mund t'i drejtohen Kuvendit. Z. Kuçi e përsëriti argumentin e tij se kryesuesi i KRRPP-së është emëruar nga Kuvendi andaj ka të drejtën që t'i drejtohet Kuvendit. Kryesuesi i seancës bëri një pauzë në mënyrë që Kryesia së bashku me shefat e grupeve parlamentare të mirren vesh se si të vazhdojnë me debatin për raportin vjetor të KRRPP-së. Pas pauzës, Kryesuesi i seancës deklaroi se Kryesia dhe shefat e grupeve parlamentare janë pajtuar që Kryesuesi i KRRPP-së të mos i drejtohej Kuvendit për ta paraqitur raportin vjetor dhe se në vend të kësaj këtë raport si dhe rekomandimet do t'i paraqes kryesuesi i komisinit për buxhet dhe financa. Megjithatë, z. Hajredin Kuçi në emër të grupit parlamentar të PDK-së propozoi që debati për raportin vjetor të KRRPP-së të shtyhet për një seancë tjetër. Përfaqësuesit e grupeve parlamentare të Aleancës Kosova e Re (AKR), LDD-së dhe AAK-së e kundërshtuan shtyerjen e debatit të raportit vjetor të KRRPP-së. Sidoqoftë, Kryesuesi i seancës tha se sipas rregullës 30.2, është i obliguar që mocionin e z. Kuçi ta hedhë në votim. Andaj, ai vazhdoi duke hedhur në votim mocionin e z. Kuçi për shtyerjen e debatit për raportin vjetor të KRRPP-së, i cili është miratuar me 52 vota për, 28 vota kundër dhe shtatë abstenime.

As Korniza Kushtetuese as Rregullorja e Punës së Kuvendit nuk e rregullojnë çështjen e raportimit të agjensioneve të pavarura. Sipas Kreut 82.2 (i) të ligjit për prokurim publik, të cilit u referua z. Koci, KRRPP-ja përgatit dhe i dorëzon Qeverisë dhe Kuvendit raportin vjetor ku analizohen aktivitetet e prokurimit në Kosovë gjatë vitit përkatës kalendarik dhe ipen rekomandimet për përmirësimin e sistemit të prokurimit publik dhe/ose të vetë ligjit. Kreu 82.2 (i) nuk i ndalon KRRPP-së që ta paraqes raportin e saj vjetor gojarisht para Kuvendit. Gjatë legjislaturës së kaluar, në seancën plenare më 17 nëntor 2006, Kryesuesi i Agjencionit Rregullator të Telekomunikacionit (ART), i cili poashtu është agjension i pavarur rregullator, është lejuar nga Kuvendi që gojarisht ta paraqes raportin vjetor të ART-së para Kuvendit. Për më tepër, në seancën plenare më 22 mars 2007, Kryesuesi i ART-së ka raportuar lidhur me liçencimin e operatorit të dytë të telefonisë mobile me kërkesë të Kuvendit. Në këtë rast Kryesuesi i po të njëjtit agjension të pavarur rregullator është lejuar të raportojë para Kuvendit dy herë.

Është e rekomandueshme për legjislaturën aktuale, posaçërisht për komisionin për mandate, imunitete dhe rregullore të punës, që gjatë ripunimit të Rregullores së Punës së Kuvendit, ta rregullojnë në mënyrë të qartë çështjen e raportimit të agjensioneve të pavarura.

Pyetjet për Qeverinë

Në seancën plenare të 26 shkurtit, dy nga katër pyetje morën përgjigje, andaj, dy pyetjet e mbetura u shtyen për seancën plenare të radhës. Në seancën plenare të 14 marsit, shtatë nga tetë pyetje morën përgjigje. Dy pyetjet të cilat

nuk kishin marrë përgjigje gjatë seancës paraprake, u rishtruan në seancën e 14 marsit, ku vetëm njëra mori përgjigje. Kryetari i Kuvendit deklaroi se pyetja e cila nuk ka marrë përgjigje në dy seanca plenare do të publikohet në buletin e Kuvendit. Në seancën plenare të 28 marsit, dy nga pesë pyetje morën përgjigje. Kryetari i Kuvendit deklaroi se pyetjet të cilat nuk kanë marrë përgjigje do të përsëriten në seancën plenare të radhës. Znj. Gjylnaze Syla (AAK) bëri vërejtjen se pyetja e saj nuk ishte përfshirë në rendin e ditës së seancës plenare të 28 marsit duke shtuar se pyetjen e kishta parashtruar 48 orë para mbajtjes së seancës, në pajtim me rregullën 26.2. Kryetari i Kuvendit kundërshtoi se pyetja e znj. Syla nuk e kishte përmbushur kushtin e 48 orëve meqë ishte dorëzuar në ora 13:00 më 26 mars. Ai shtoi se pyetja e znj. Syla do të përfshihet në rendin e ditës së seancës plenare të radhës.

Periudhat për pyetjet parlamentare të dy seancave në fjalë janë bërë në pajtim me rregullën 26 mbi “pyetjet për Qeverinë për përgjigje gojore”, e cila parasheh që rendi i ditës i secilës seancë plenare të përfshijë një periudhë deri në 50 minuta për pyetjet e deputetëve për Qeverinë, ku një minutë zgjat pyetja, tre minuta përgjigja e ministrit, një minutë pyetja shtesë, dhe dy minuta për përgjigjen në pyetjen shtesë.

Në pajtim me rregullën 26.2, pyetja për Qeverinë për përgjigje gojore duhet të parashtrohet me shkrim në zyren e parashtrësve jo më pak se 48 orë para seancës. Pyetja e znj. Syla është parashtruar 45 orë para seancës plenare të 28 marsit. Vendimi për mos ta përfshirë pyetjen e znj. Syla në rendin e ditës së seancës plenare të 28 marsit nuk është në kundërshtim me rregullën 26.2 Sipas rregullës 26.11, “Nëse pyetja nuk ka marrë përgjigje brenda dy seancave, ajo publikohet në buletin e Kuvendit.” Buletini i parë i kësaj legjislature është publikuar më 18 mars por nuk përmban pyetjen e cila nuk ka marrë përgjigje nga Qeveria për të dytën herë radhazi në seancën plenare të 14 marsit. Është e detyrueshme që Kuvendi t’i publikojë në buletin e tij pyetjet e deputetëve të cilat nuk kanë marrë përgjigje brenda afatit të paraparë në rregullën 26.11, gjë që do të kontribuoj në ngritjen e llogaridhënies së Qeverisë ndaj Kuvendit.

4. Qasja dhe pjesëmarrja e barabartë e komuniteteve

- Në seancën plenare të 27 shkurtit, gjatë shqyrtimit të parë të projektligjit për deklarimin dhe prejardhjen e pasurisë së zyrtarëve të lartë publik, z. Dzezair Murati (Vakat/7+) bëri vërejtjen se nuk kishte përkthim në gjuhën serbisht/kroatisht/boshnjakisht duke shtuar se “disa deputetë nuk janë në gjendje ta përcjellin debatin” mbi projektligjin në fjalë. Kryetari i Kuvendit nuk komentoi lidhur me vërejtjen e z. Murati.

Sipas rregullës 54 mbi përdorimin e gjuhëve në Kuvend, mbledhjet e Kuvendit dhe të komisioneve të tij duhet të bëhen në gjuhën shqipe dhe serbe dhe duhet të ketë përkthim sipas nevojës. Kryetari i Kuvendit ose cilido nga anëtarët e Kryesisë që kryeson seancën, duhet të sigurojë përkthimin në dy gjuhët zyrtare në vazhdimësi gjatë seancave plenare të Kuvendit.

5. Qasja

Gjatë periudhës raportuese, Shtylla e III-të (OSBE) ka pasur qasje në seancat plenare dhe në mbledhjet e Kryesisë. Shtylla e III-të gjithashtu ka pranuar kopjet e dokumentave të shqyrtuara nga Kuvendi si dhe transkriptin e seancave të kaluara.

6. Transparenca

Ashtu siç është shpallur nga Kryetari i Kuvendit në seancën plenare të 15 shkurtit, kopjet e votimit elektronik të rexhistruar kanë filluar t'u shpërndahen të gjithë deputetëve të Kuvendit nga seanca e jashtëzakonshme plenare e 17 shkurtit. Megjithatë, Kryetari i Kuvendit kishte lajmëruar se rezultati i votimit elektronik poashtu do të publikohet në ueb faqen e Kuvendit, gjë që ende nuk ka ndodhur. Në mënyrë që të rritet transparenca e Kuvendit, posaçërisht llogaridhënia e deputetëve ndaj votuesve të tyre, Kuvendi duhet t'i vë rezultatet e votimit elektronik në dispozicion të publikut përmes ueb faqes së saj, ashtu siç është lajmëruar nga Kryetari i Kuvendit.

Radio Televizioni i Kosovës ka siguruar transmetimin e drejtpërdrejtë të seancave plenare në fjalë. Publikut dhe monitoruesve institucional iu është mundësuar hyrja në seancat plenare. Kuvendi ka ueb-faqen (www.assembly-kosova.org) që përmban detaje biografike të deputetëve të Kuvendit, informacione për strukturën dhe funksionimin e Kuvendit, kopje të ligjeve dhe rezolutave të miratuara nga Kuvendi, si dhe informacione të tjera në gjuhën shqipe, serbe dhe angleze.

FUND.



Organization for Security and
Co-operation in Europe
Mission in Kosovo

Shtylla III (OSBE)

Raporti 03/2008

Mbi monitorimin e Kuvendit të Kosovës

1 prill 2008 – 14 qershor 2008

Titujt kryesor

- Kuvendi miraton Kushtetutën dhe himnin e Kosovës
- Kryetari i Kosovës i drejtohet Kuvendit
- Kuvendi debaton për programin qeveritar 2008-2011
- Kuvendi fillon me publikimin e rezultatit të votimit elektronik në faqen e tij të internetit
- Qeveria dështon të jetë e pranishme në seanca plenare dhe të përgjigjet në pyetje parlamentare
- Përafërsisht 20 % mbledhjeve të komisioneve dështojnë për shkak të mungesës së kuorumit

1. Sfond

Raporti i pesëdhjeteshtatë i monitorimit është hartuar në përputhje me pikëpamjet referuese të Shtyllës së tretë të UNMIK-ut për themelimin e institucioneve (OSBE) dhe monitorimin e Kuvendit të Kosovës prej datës 26 nëntor 2002 dhe bazohet në Rregulloren e re të punës, të miratuar në fund të seancës plenare më 20 maj 2005 dhe të reviduar në seancën plenare të mbajtur më 1-2 qershor 2006 dhe 18 shtator 2007.

Shtylla e III-të (OSBE) ka monitoruar dy seanca të jashtëzakonshme plenare të mbajtur më 9 prill dhe 11 qershor dhe nëntë seanca plenare të rregullta më 4 prill, 17 prill, 18 dhe 21 prill, 29 prill, 16 maj, 20, 21 dhe 23 maj, 2 qershor, 4 dhe 5 qershor, dhe 12 dhe 13 qershor, si dhe tetë mbledhje të Kryesisë, më 1 prill, 8 prill, 15 prill, 22 prill, 29 prill, 12 maj, 19 maj dhe 10 qershor. Shtylla III (OSBE) ka monitoruar 51 nga 70 mbledhje të komisioneve dhe një dëgjim publik.

2. Vështrim

Seancën plenare të Kuvendit të Kosovës të mbajtur më 4 prill e kryesoi Kryetari i Kuvendit z. Jakup Krasniqi (PDK), dhe anëtari i Kryesisë Naim Maloku (AAK).

- Nëntëdhjetë e pesë deputetë ishin të pranishëm në seancën e plenare të 4 prillit.
- Pikat kryesore të rendit të ditës të seancës së plenare të 4 prillit:
 - Pyetjet për qeverinë për përgjigje gojore
 - Shqyrtimi i parë i projektligjit për vulat e institucioneve të Kosovës (Projektligji është miratuar në parim me 70 vota për dhe një votë kundër.)
 - Shqyrtimi i parë i projektligjit për sigurinë private (Projektligji është miratuar në parim me 82 vota për dhe pa vota kundër.)
 - Shqyrtimi i dytë i projektligjit për ndryshimin e kodit të përkohshëm penal (Projektligji është miratuar me 69 vota për dhe dy vota kundër.)
 - Shqyrtimi i dytë i projektligjit për ndryshimin e ligjit për kooperativat bujqësore (Projektligji është miratuar me 78 vota për dhe pa vota kundër.)

Seancën e jashtëzakonshme plenare të mbajtur më 9 prill e kryesoi Kryetari i Kuvendit z. Jakup Krasniqi (PDK).

- Njëqind e shtatë deputetë ishin të pranishëm në seancën e jashtëzakonshme plenare të 9 prillit.
- Pikat kryesore të rendit të ditës të seancës plenare të jashtëzakonshme të mbajtur më 9 prill:
 - Miratimi i Kushtetutës së Kosovës

(Kushtetuta është miratuar me aklamacion. Për më shumë detaje shiko më poshtë pjesën e titulluar “Procesi i votimit”.)

Seancën plenare të mbajtur më 17 prill e kryesoi Kryetari i Kuvendit z. Jakup Krasniqi (PDK) dhe anëtari i Kryesisë z. Eqrem Kryeziu (LDK).

- Nëntëdhjetë e shtatë deputetë ishin të pranishëm në seancën plenare të 17 prillit.
- Pikat kryesore të rendit të ditës të seancës plenare të mbajtur më 17 prill:
 - Pyetjet për Qeverinë për përgjigje me gojë
 - Shqyrtimi i parë i projektligjit për sponsorizimet në kulturë, rini dhe sport (Projektligji është miratuar në parim me 61 vota për dhe tri vota kundër.)
 - Shqyrtimi i parë i projektligjit për Ansamblin Kombëtar “Shota” dhe ansamblet tjera (Projektligji është miratuar në parim me 51 vota për, një votë kundër, dhe dhjetë abstenime.)
 - Shqyrtimi i parë i projektligjit për ndërmjetësimin (Projektligji është miratuar në parim me 56 vota për dhe tri vota kundër.)
 - Zëvendësimi i deputetit të SLS-së në komisionin për punë të jashtme

Seancën plenare të mbajtur më 18 dhe 21 prill e kryesoi Kryetari i Kuvendit z. Jakup Krasniqi (PDK) dhe anëtari i Kryesisë z. Ibrahim Gashi (AKR).

- Njëqind e tetë dhe gjashtëdhjetë e katër deputetë ishin të pranishëm, respektivisht, në seancat plenare të 18 dhe 21 prillit.
- Pikat kryesore të rendit të ditës të seancës plenare të mbajtur më 18 dhe 21 prill:
 - Fjala e Kryetarit të Kosovës lidhur me gjendjen e përgjithshme në Kosovë
 - Deklarata e Qeverisë në njëqind ditët e punës (Kryeministri bëri deklaratën.)
 - Debat për programin e Qeverisë 2008-2011 (Kryeministri e prezantoi programin, që u pasua nga deklaratat e shefave të grupeve parlamentare, debati plenar dhe deklarata përmbyllëse e Kryeministrit.)

Seancën plenare të mbajtur më 29 prill e kryesoi Kryetari i Kuvendit z. Jakup Krasniqi (PDK).

- Tetëdhjetë e tetë deputetë ishin të pranishëm në seancën plenare të 29 prillit.
- Pikat kryesore të rendit të ditës të seancës plenare më 29 prill:
 - Pyetjet për Qeverinë për përgjigje me gojë
 - Shqyrtimi i dytë i projektligjit për ndryshimin e ligjit 2002/9 për inspektoratin e punës

- (Projektligji është miratuar me 60 vota për dhe tetë vota kundër.)
- Shqyrtimi i dytë i projektligjit për ndryshimin e ligjit 2003/15 për skemën e ndihmës sociale
(Projektligji është miratuar me 68 vota për dhe një votë kundër.)
- Shqyrtimi i dytë i projektligjit për taksën e vendosjes
(Projektligji është miratuar me 69 vota për dhe pa vota kundër.)
- Shqyrtimi i dytë i projektligjit për ndryshimin e ligjit për ekzekutimin e sanksioneve penale
(Projektligji është miratuar me 70 vota për dhe pa vota kundër.)
- Shqyrtimi i dytë i projektligjit për provimin përfundimtar në shkollat fillore dhe të mesme
(Projektligji është miratuar me 69 vota për dhe pa vota kundër.)
- Shqyrtimi i dytë i projektligjit për deklarimin e prejardhjes së pronës të zyrtarëve të lartë publik
(Projektligji është miratuar me 71 vota për dhe pa vota kundër.)
- Shqyrtimi i dytë i projektligjit për ndryshimin e kodit të përkohshëm të procedurës penale
(Projektligji është miratuar me 62 vota për dhe pesë vota kundër.)
- Zëvendësimi i deputetit të AKR-së në komisionin për arsim, shkencë, teknologji, kulturë, rini dhe sport
(Zëvendësimi është miratuar me 56 vota për dhe tri vota kundër.)

Seancën plenare të mbajtur më 16 maj e kryesoi Kryetari i Kuvendit z. Jakup Krasniqi (PDK), dhe anëtar i Kryesisë z. Slobodan Petrović (SLS).

- Tetëdhjetë e dy deputetë ishin të pranishëm në seancën plenare të 16 majit.
- Pikat kryesore të rendit të ditës të seancës plenare të 16 majit:
 - Pyetjet për Qeverinë për përgjigje me gojë
 - Shqyrtimi i parë i projektligjit për ndryshimin e ligjit për pyjet
(Projektligji është refuzuar me dhjetë vota për dhe 41 vota kundër, andaj i është kthyer Qeverisë për ripunim.)
 - Shqyrtimi i parë i projektligjit për kualifikimet kombëtare
(Projektligji është miratuar në parim me 50 vota për dhe shtatë vota kundër.)
 - Shqyrtimi i dytë i projektligjit për procedurën jo kontestimore
(Projektligji është miratuar me 60 vota për dhe pa vota kundër.)
 - Shqyrtimi i dytë i projektligjit për procedurën përmbareuse
(Projektligji është miratuar me 48 vota për dhe tri vota kundër.)
 - Shqyrtimi i dytë i projektligjit për mbështetjen materiale të familjeve me fëmijë me të meta të përhershme
(Projektligji është miratuar me 64 vota për dhe pa vota kundër.)
 - Shqyrtimi i dytë i projektligjit për përdorimin civil të eksplozivëve
(Projektligji është miratuar me 69 vota për dhe pa vota kundër.)
 - Shqyrtimi i rekomandimit të komisionit për buxhet dhe financa për kthimin e projektligjit për parandalimin e pastrimit të parave, sponsoruesit

(Rekomandimi është miratuar me 53 vota për dhe një votë kundër. Shiko më poshtë paragrafin e dytë të pjesa e titulluar “Procesi legjislativ”.)

- Shqyrtimi i propozimit të qeverisë lidhur me emërimin e një anëtari në bordin e autoritetit qëndror bankar
(Emërimi është miratuar me 43 vota për dhe shtatë vota kundër.)
- Shqyrtimi i propozimeve të grupeve parlamentare të PDK-së, LDK-së, dhe AKR-së lidhur me emërimin e anëtarëve të këshillit të agjensionit kundër korrupsionit
(Emërimet janë miratuar me 53 vota për dhe një votë kundër.)

Seancën plenare të mbajtur më 20, 21 dhe 23 maj e kryesoi Kryetari i Kuvendit z. Jakup Krasniqi (PDK) dhe anëtari i Kryesisë z. Džezair Murati (7+/Vakat).

- Nëntëdhjetë e nëntë, njëqind e një dhe nëntëdhjetë e katër deputetë ishin të pranishëm, respektivisht, në seancën plenare të 20, 21 dhe 23 majit.
- Pikat kryesore të rendit të ditës të seancës plenare të mbajtur më 20, 21 dhe 23 maj:
 - Shqyrtimi i parë dhe i dytë i projektligjit për arsimin në komuna (Projektligji është miratuar me 83 vota për dhe tri vota kundër.)
 - Shqyrtimi i parë dhe i dytë i projektligjit për agjensinë kosovare të inteligjencës.)
(Projektligji është miratuar me 92 vota për dhe gjashtë vota kundër.)
 - Shqyrtimi i parë dhe i dytë i projektligjit për agjensinë kosovare të privatizimit
(Projektligji është miratuar me 75 vota për dhe shtatë vota kundër.)
 - Shqyrtimi i parë dhe i dytë i projektligjit për kontrollin e integruar të kufijve shtetërorë
(Projektligji është miratuar me 91 vota për dhe katër vota kundër.)
 - Shqyrtimi i parë dhe i dytë i projektligjit për azilin
(Projektligji është miratuar me 87 vota për dhe gjashtë vota kundër.)
 - Shqyrtimi i parë dhe i dytë i projektligjit për festat zyrtare
(Projektligji është miratuar me 46 vota për dhe 32 vota kundër.¹³)

Seancën plenare të mbajtur më 2 qershor e kryesoi Kryetari i Kuvendit z. Jakup Krasniqi (PDK), dhe anëtari i Kryesisë z. Sabri Hamiti (LDK).

- Tetëdhjetë e shtatë deputetë ishin të pranishëm në seancën plenare të 2 qershorit.
- Pikat kryesore të rendit të ditës të seancës plenare të 2 qershorit:

13 Ligjet e lartpërmendura janë miratuar brenda dy ditësh në pajtim me mocionin procedural të miratuar nga Kuvendi në seancën plenare të 15 shkurtit. Siç është përmendur në raportin paraprak, në Kornizë Kushtetuese kërkohet që të gjitha ligjet e propozuara që kanë implikime buxhetore duhet të kenë të bashkangjitur deklaratën financiare përkatëse. Andaj, mocioni procedural për heqjen e kërkesës për bashkangjiturjen e këtyre deklaratave financiare nuk është i vlefshëm dhe deklaratat financiare janë të detyrueshme. Për më shumë detaje shiko raportet 01/2008 dhe 02/2008.

- Pyetjet për Qeverinë për përgjigje me gojë
- Shqyrtimi i parë i projektligjit për punën
(Projektligji është miratuar me 49 vota për dhe shtatë vota kundër.)
- Shqyrtimi i parë i projektligjit për statistikat zyrtare
(Projektligji është miratuar në parim me 63 vota për dhe pa vota kundër.)
- Shqyrtimi i dytë i projektligjit për procedurën përmbartuese
(Projektligji është miratuar me 68 vota për dhe pa vota kundër.)
- Shqyrtimi i raportit financiar 2007 i buxhetit të konsoliduar të Kosovës
(Projektligji është miratuar me 46 vota për dhe 13 vota kundër.)
- Shqyrtimi i rekomandimit të komisionit për çështje gjyqësore dhe legjislative lidhur me emërimin e Avokatit të Popullit
(Kjo pikë është hequr nga rendi i ditës.)
- Shqyrtimi i propozimit të Qeverisë për deklarimin e hapësirës së trasesë Morinë – Merdar dhe Prishtinë – Hani i Elezit zonë me interes të veçantë publik
(Propozimi i Qeverisë është miratuar me 60 vota për dhe një votë kundër.)
- Shqyrtimi i propozimit për lëshimin e deklaratës kundër pohimeve të Carla Del Ponte lidhur me UÇK-në
(Kjo pikë është hequr nga rendi i ditës.)
- Shqyrtimi i raportit vjetor 2007 i Agjencionit Anti Korrupsion
(Raporti është debatuar dhe miratuar me 83 vota për dhe një votë kundër.)

Seancën plenare të mbajtur më 4 dhe 5 qershor e kryesoi Kryetari i Kuvendit z. Jakup Krasniqi (PDK) dhe anëtar i Kryesisë z. Eqrem Kryeziu (LDK).

- Tetëdhjetë e katër deputetë ishin të pranishëm në seancën plenare të 4 dhe 5 qershorit.
- Pikat kryesore të rendit të ditës të seancës plenare të mbajtur më 4 dhe 5 qershor:
 - Shqyrtimi i parë dhe i dytë i projektligjit për zgjedhjet e përgjithshme
(Projektligji është miratuar me 64 vota për dhe dhjetë vota kundër.)
 - Shqyrtimi i parë dhe i dytë i projektligjit për zgjedhjet lokale
(Projektligji është miratuar me 76 vota për dhe pa vota kundër.)
 - Shqyrtimi i parë dhe i dytë i projektligjit për bankën qendrore
(Projektligji është miratuar me 79 vota për dhe një votë kundër.)
 - Shqyrtimi i parë dhe i dytë i projektligjit për auditorin e përgjithshëm
(Projektligji është miratuar me 81 vota për dhe pa vota kundër.)
 - Shqyrtimi i parë dhe i dytë i projektligjit për hekurudhat
(Projektligji është miratuar me 81 vota për dhe pa vota kundër.)

Seancën e jashtëzakonshme plenare të mbajtur më 11 qershor e kryesoi Kryetari i Kuvendit z. Jakup Krasniqi (PDK).

- Nëntëdhjetë e tetë deputetë ishin të pranishëm në seancën plenare të 11 qershorit.

- Pikat kryesore të rendit të ditës të seancës plenare të mbajtur më 11 qershor:
 - Miratimi i himnit shtetëror të Kosovës
(Himni është miratuar me 72 vota për, 15 vota kundër dhe pesë abstenime.)

Seancën plenare të mbajtur më 12 dhe 13 qershor e kryesoi Kryetari i Kuvendit z. Jakup Krasniqi (PDK), dhe anëtari i Kryesisë z. Xhavit Haliti (PDK).

- Tetëdhjetë e pesë dhe shtatëdhjetë e shtatë deputetë ishin të pranishëm, respektivisht, në seancën plenare të 12 dhe 13 qershorit.
- Pikat kryesore të rendit të ditës të seancës plenare të 12 dhe 13 qershorit:
 - Shqyrtimi i parë dhe i dytë i projektligjit për shpërbërjen e Trupave Mbrojtëse të Kosovës
(Projektligji është miratuar me 56 vota për dhe tri vota kundër.)
 - Shqyrtimi i parë dhe i dytë i projektligjit për shërbimin në forcën e sigurisë së Kosovës
(Projektligji është miratuar me 71 vota për dhe një votë kundër.)
 - Shqyrtimi i parë dhe i dytë i projektligjit për ndryshimin e rregullores së UNMIK-ut 2006/50 lidhur me pronën e paluajtshme përfshirë pronën bujqësore dhe komerciale
(Projektligji është miratuar me 71 vota për dhe një votë kundër.)
 - Shqyrtimi i parë dhe i dytë i projektligjit për ndryshimin e rregullores së UNMIK-ut 2005/20 lidhur me trustin pensional të Kosovës
(Projektligji është miratuar me 71 vota për dhe një votë kundër.)
 - Shqyrtimi i parë dhe i dytë i projektligjit për ndryshimin e rregullores së UNMIK-ut 2005/2 mbi themelimin e komisionit të pavarur për miniera dhe minerale
(Projektligji është miratuar me 66 vota për dhe një votë kundër.)
 - Shqyrtimi i parë dhe i dytë i projektligjit për ndryshimin e rregullores së UNMIK-ut 2004/49 mbi ofruesit e shërbimeve të ujësjellësit, kanalizimit dhe mbeturinave
(Projektligji është miratuar me 70 vota për dhe një votë kundër.)
 - Shqyrtimi i parë dhe i dytë i projektligjit për ndryshimin e rregullores së UNMIK-ut 2003/16 mbi shpalljen e ligjit për telekomunikacionin
(Projektligji është miratuar me 37 vota për dhe 34 vota kundër.)
 - Shqyrtimi i parë dhe i dytë i projektligjit për ndryshimin e rregullores së UNMIK-ut 2004/9 mbi rregullatorin e energjisë
(Projektligji është miratuar me 60 vota për dhe tri vota kundër.)
 - Shqyrtimi i parë dhe i dytë i projektligjit për ndryshimin e rregullores së UNMIK-ut 2008/13 mbi miratimin e buxhetit të konsoliduar të Kosovës dhe shpenzimet e autorizuara për periudhën 1 janar 2008 31 dhjetor 2008
(Projektligji është miratuar me 59 vota për dhe një votë kundër.)
 - Shqyrtimi i parë dhe i dytë i projektligjit për ndërmarrjet publike
(Projektligji është miratuar me 58 vota për dhe katër vota kundër.)

3. Punimet dhe praktikat parlamentare në seancat e Kuvendit

Rendi i ditës

- Në fillim të seancës plenare të 17 prillit, z. Berat Luzha (PDK) *gojarisht* propozoi që në rendin e ditës së seancës plenare në fjalë të përfshihet debati lidhur me pohimet e ish prokurores së tribunalit të Hagës për krime lufte në ish-Jugosllavi Karla Del Ponte lidhur me UÇK-në. Gjatë seancës së njëjtë z. Fatmir Rexhepi (LDK) *gojarisht* propozoi që në rendin e ditës së seancës plenare në fjalë të përfshihet debati lidhur me mbajtjen e zgjedhjeve të përgjithshme dhe lokale të Serbisë në territorin e Kosovës. Kryetari i Kuvendit u përgjigj se propozimet e z. Luzha dhe z. Rexhepi nuk mund të përfshihen në rendin e ditës së seancës në fjalë dhe i udhëzoi ata që propozimet e tyre t'i parashtrojnë me shkrim në zyrën për parashtresa.

Rregulla 23.1-2 parasheh që “Kryesia përgatitë një propozim të rendit të ditës për seancën e radhës të Kuvendit dhe menjëherë të njëjtin e vë në dispozicion për deputetët e Kuvendit. Në fillim të seancës ky propozim rend dite do të konsiderohet i miratuar, përveç nëse një ose më shumë grupe parlamentare apo 6 deputetë i propozojnë me shkrim Kryetarit një amendament në rendin e ditës, i cili hidhet në votim.” Z. Luzha dhe z. Rexhepi nuk i kanë bërë propozimet e tyre në pajtim me rregullën 23. Andaj, vendimi i Kryetarit të Kuvendit për mos t'i hedhur në votim propozimet e lartpërmendura ishte në pajtim me rregullën 23.

Mocioni procedural

- Në seancën plenare më 18 prill, znj. Gjylnaze Sylja (AAK) deklaroi se ajo dëshironte që të propozojë mocion procedural për shtyerjen e debatit për raportin 100 ditor të punës së Qeverisë në pajtim me rregullën 30. Z. Numan Balic (AAK/SDA) poashtu propozoi që të shtyhet debati për raportin e punës së Qeverisë. Për më tepër, z. Ibrahim Gashi (AKR) propozoi mocion procedural për shtyerjen e debatit për raportin 100 ditor të punës së Qeverisë me arsyetimin se deputetët nuk kanë pasur kohë të mjaftueshme për t'u përgatitur për këtë debat. Megjithatë, Kryetari i Kuvendit nuk e hedhi në votim mocionin procedural të propozuar nga deputetët në fjalë dhe vazhdoi me debatin. *Rregulla 30.1 (a) dhe 30.2 parashohin se “Në çdo seancë plenare të Kuvendit deputetit i jepet e drejta të propozojë mocion procedural për të... shtyrë debatin... për mocionin për ta shtyrë debatin, menjëherë mbahet votim pa debat.” Andaj, Kryetari i Kuvendit ishte i obliguar ta hedhë në votimin mocionin procedural të propozuar nga znj. Sylja, z. Balic dhe z. Gashi.*

Procesi i votimit

- Në seancën e jashtëzakonshme plenare të 9 prillit, Kuvendi ka miratuar Kushtetutën me aklamacion. Pas prezantimit të Kushtetutës nga zëvendëskryeministri Hajredin Kuçi (PDK), Kryetari i Kuvendit e hedhi në votim Kushtetutën dhe deputetët u ngritën në këmbë dhe aplauzuan. Kryetari i Kuvendit lajmëroi se Kushtetuta është miratuar me aklamacion me mbështetjen e të gjithë deputetëve të pranishëm. Megjithatë, disa deputetë nuk janë ngritur në këmbë.

Në seancën plenare të 17 prillit, gjatë diskutimit për procesverbalin nga seanca e jashtëzakonshme plenare e 9 prillit, Kryetari i Kuvendit deklaroi se ishte informuar se disa deputet nuk ishin ngritur në këmbë gjatë votimit me aklamacion të Kushtetutës dhe kërkoi nga këta deputet që të deklarohen se a janë për, kundër apo abstenojnë ndaj Kushtetutës, në mënyrë që të përmirësohet procesverbali. Znj. Besa Gaxherri (LDD) bëri vërejtjen se Rregullorja e Punës nuk e njeht votimin me aklamacion dhe shtoi se Kryetari i Kuvendit e ka shkelur Rregulloren e Kuvendit me lejimin e votimit të Kushtetutës me aklamacion. Z. Numan Balic (AAK/SDA) poashtu deklaroi se Kryetari i Kuvendit e ka shkelur Rregulloren e Kuvendit me lejimin e votimit me aklamacion dhe shtoi se nëntë deputetë nuk ishin ngritur në këmbë. Znj. Melihate Tërmerkoll (LDK) komentoi se Kryetari i Kuvendit i ka ofenduar deputetët duke mos kërkuar nga ata që të deklarohen në 9 prill dhe duke kërkuar nga ata që ta bëjnë këtë në seancën e mëvonshme. Kryetari i Kuvendit e përsëriti se ata deputet të cilët nuk janë pajtuar me votimin me aklamacion mund të deklarohen nëse janë kundër apo abstenojnë nga Kushtetuta, në mënyrë që procesverbali të përmirësohet. Pas një diskutimi të mëtutjeshëm, Kryetari i Kuvendit e hedhi në votim miratimin e procesverbalit nga seanca e jashtëzakonshme plenare e 9 prillit, që u miratua me shumicë votash për, tri vota kundër dhe nëntë abstenime.

Rregulla 31.4 parasheh që votimi bëhet në njërën nga mënyrat në vijim: (a) votimi i thjeshtë “për” apo “kundër” me ngritje dore, (b) votimi i fshehtë; ose (c) votimi i regjistruar, që përfshin votimin elektronik ose thirrjen e secilit deputet veç e veç. Në Rregulloren e Punës nuk përmendet votimi me aklamacion. Andaj, Kryetari i Kuvendit, për miratimin e Kushtetutës, është dashur të përdor njërën nga mënyrat e përshkruara në rregullën 31.4, që poashtu do të shmangte paknaqësinë në ndërmjet deputetëve.

- Në seancën e plenare të 4 prillit, pas votimit në parim të projektligjit për sigurinë private, kryesuesi z. Naim Maloku (AAK) deklaroi se ka mospërputhje mes numrit të deputetëve të pranishëm fizikisht në sallë plenare dhe numrit të votave elektronike. Ai deklaroi se 81 deputetë janë të pranishëm fizikisht në sallë ndërsa ishin regjistruar 82 vota elektronike duke shtuar se “si duket dikush ka votuar për një deputet i cili nuk ishte i pranishëm në sallë, gjë që nuk është e lejuar me rregullore të punës.” Megjithatë, ai lajmëroi se projektligji në fjalë është miratuar në parim me 82 vota për dhe pa vota kundër sipas votimit elektronik. *Gjatë legjislaturës së kaluar, në raportet e monitorimit janë përmendur disa raste ku një deputet ka votuar përmes pajisjes së tij/saj dhe përmes pajisjes së deputetit të afërm i cili e kishte lëshuar sallën plenare përkohësisht, por votimi në fjalë është anuluar. Kryesuesi i seancës plenare të 4 prillit, poashtu është dashur që ta anulojë votimin dhe ta përsëris atë meqë duket se një deputat ka votuar edhe në pajisjen e një deputetit tjetër, i cili nuk ishte i pranishëm në sallë plenare atë moment. Kuvendi duhet t'i eliminojë këto mundësi për manipulim dhe pasaktësi – nëse është e nevojshme edhe duke shtuar dispozita të reja në rregulloren e re të punës së Kuvendit të Kosovës – në mënyrë që të ruhet integriteti i procesit të votimit.*

Shpërndarja e projektligjeve

- Projektligji për vulat në institucionet e Kosovës dhe projektligji për sigurinë private u janë shpërndarë deputetëve më 21 mars. Andaj, projektligjet janë shpërndarë, respektivisht, tetë ditë pune para shqyrtimit të parë në seancën plenare më 4 prill. Projektligji për sponsorizimet në kulturë, rini dhe sport, projektligji për ansamblin kombëtar “Shota” dhe ansamblet tjera dhe projektligji për ndërmjetësimin janë shpërndarë më 1 prill. Andaj, projektligjet janë shpërndarë 11 ditë pune para shqyrtimit të tyre të parë në seancën plenare të 17 prillit. Projektligji për ndryshimin e ligjit për pyjet është shpërndarë më 18 prill, derisa projektligji për kualifikimet kombëtare është shpërndarë më 5 maj. Andaj, projektligjet janë shpërndarë, respektivisht, 18 dhe tetë ditë para shqyrtimit të tyre të parë në seancën plenare më 16 maj. Projektligji për punën është shpërndarë më 14 maj, derisa projektligji për statistikën zyrtare është shpërndarë më 16 maj. Andaj, projektligjet janë shpërndarë, respektivisht, 12 dhe dhjetë ditë pune para shqyrtimit të tyre të parë në seancën plenare më 2 qershor.
Rregulla 35.1 parasheh që shqyrtimi i parë i projektligjit duhet të bëhet jo më parë se dhjetë ditë pune dhe as më shumë se tri javë pune nga dita pas shpërndarjes së tij. Shumica e projektligjeve në fjalë janë shqyrtuar për herë të parë në pajtim me rregullën 35.1, derisa tri projektligje janë shqyrtuar për herë të parë tetë ditë pune nga data e shpërndarjes së tyre, që nuk është në pajtim me rregullën e lartpërmendur.

Procesi legjislativ

- Projektligji për kooperativat e bujqve dhe projektligji për përdorimin civil të eksplozivëve janë miratuar, respektivisht, pesë javë dhe afër tre muaj pas miratimit të tyre në parim më 26 shkurt. Projektligji për ndryshimin e kodit të përkohshëm penal është miratuar pesë javë pas shqyrtimit të parë më 27 shkurt. Projektligji për ndryshimin e ligjit 2002/9 për inspektoratin e punës; projektligji për ndryshimin e ligjit 2003/15 për skemën e ndihmës sociale; projektligji për taksën e vendosjes; projektligji për ndryshimin e ligjit për ekzekutimin e sanksioneve penale; dhe projektligji për provimin përfundimtar në shkollat fillore dhe të mesme janë miratuar dy muaj pas miratimit në parim më 28 shkurt. Projektligji për deklarimin e prejardhjes së pronës së zyrtarëve të lartë publik dhe projektligji për ndryshimin e kodit të përkohshme të procedurës penale janë miratuar dy muaj pas shqyrtimit të parë më 29 shkurt. Projektligji për procedurën jokontestimore; projektligji për procedurën përmbarese; dhe projektligji për ndihmën materiale të familjeve me fëmijë me paaftësi të përhershme janë miratuar gati tre muaj pas shqyrtimit të parë më 29 shkurt.
Rregulla 35.6 parasheh se “Në rastet kur një komision është caktuar ta shqyrtojë projektligjin, atëherë ai i raporton rekomandimet e veta në Kuvend, por jo më vonë se dy (2) muaj nga shqyrtimi i parë i projektligjit, përveç rasteve kur është miratuar një kohëzgjatje shtesë nga Kuvendi.” Shumica e projektligjeve të lartpërmendura janë miratuar nga Kuvendi në pajtim me rregullën 35.6, derisa disa projektligje janë miratuar pas më shumë se dy muajsh. Megjithatë, gjatë mandatit të kaluar në raportet e monitorimit është

vërejtur se komisionet kanë pasur vështirësi për t'i shqyrtuar projektligjet dhe për t'i dorëzuar rekomandimet e tyre brenda dy muajsh. Andaj, Kuvendi mund të shqyrtojë mundësinë që ta zgjas këtë afat në tre muaj në mënyrë që t'i mundësohet komisioneve që t'i shqyrtojnë projektligjet në mënyrë të duhur.

- Në seancën plenare të 16 majit, z. Gani Koci (PDK), kryesues i komisionit funksional (për buxhet dhe financa), propozoi që projektligji për parandalimin e pastrimit të parave t'i kthehet sponsoruesit me arsyetimin se ka shumë mangësi, të cilat nuk mund të eliminohen përmes amendamentimit. Kryetari i Kuvendit e hedhi në votim kërkesën e z. Koci, e cila është miratuar me 53 vota për dhe projektligji i është kthyer sponsoruesit.
Sipas rregullës 35.3 e cila parasheh se “propozuesi mund ta tërheqë projektligjin gjatë shqyrtimit të parë deri para fillimit të procedurës së votimit për miratim në parim.” Në mënyrë analoge, komisioni funksional është dashur t'i propozoj Kuvendit që ligji për parandalimin e parave t'i kthehet sponsoruesit në pajtim me rregullën 35.3. Për më tepër, rregulla 35.7 parasheh se “Komisioni funksional - përgjegjës raportues ose kryesor, mund ta shqyrtojë projektligjin në parim edhe para shqyrtimit të parë të projektligjit në seancë plenare.” Sikur komisioni funksional ta kishte shqyrtuar projektligjin në fjalë para shqyrtimit të parë, ashtu siç lejohet me rregullën 35.7, do të kishte pasur mundësinë që ti vërej mangësitë e projektligjit më herët dhe të propozoj kthimin e projektligjit sponsoruesit para shqyrtimit të parë, e jo të bëj një propozim të tillë gati tre muaj pas shqyrtimit të tij të parë, që është mbajtur në seancën plenare më 26 shkurt. Është tejte e rekomandueshme për komisionet e Kuvendit që ta shfrytëzojnë mundësinë e shqyrtimit të projektligjeve para shqyrtimit të tyre të parë, në mënyrë që procesi legjislativ të bëhet më i efektshëm.
- Gjatë pariudhës raportuese, përafërsisht 20% e mbledhjeve të parapara të komisioneve janë anuluar për shkak të mungesës së kuorumit, gjë që ndodh sepse shumë deputetë nuk vijnë ose kanë obligime të tjera. Anulimi i mbledhjeve të komisioneve poashtu shkakton shtyerje në shqyrtimin dhe miratimin e projektligjeve dhe dokumenteve të tjera. Kuvendi mund ta rregulloj këtë çështje në Rregulloren e re të Punës, duke krijuar një mekanizëm që do të siguronte kuorumin në mbledhjet e komisionit.

Pyetjet për Qeverinë

- Në seancën plenare të 4 prillit, tetë nga 12 pyetje morën përgjigje. Në seancën plenare të 17 prillit, njëmbëdhjetë nga 25 pyetje morën përgjigje. Në seancën plenare të 29 prillit, 12 nga 20 pyetje morën përgjigje. Në seancën plenare të 16 majit njëmbëdhjetë nga 30 pyetje morën përgjigje. Në seancën plenare të 2 qershorit, 13 nga 21 pyetje morën përgjigje. Pyetjet parlamentare nuk kanë marrë përgjigje kryesisht për shkak të mungesës së Kryeministrit dhe ministrave, por disa pyetje janë shtyrë për shkak se koha për pyetje parlamentare është harxhuar. Në secilën seancë plenare Kryetari i Kuvendit ka deklaruar se pyetjet të cilat nuk kanë marrë përgjigje brenda dy seancave plenare do të publikohen në buletin e Kuvendit.

Periodhat për pyetjet parlamentare të dy seancave në fjalë janë bërë në pajtim me rregullën 26 mbi “pyetjet për Qeverinë për përgjigje gojore”, e cila parasheh që rendi i ditës i secilës seancë plenare të përfshijë një periudhë deri në 50 minuta për pyetjet e deputetëve për Qeverinë, ku një minutë zgjat pyetja, tre minuta përgjigja e ministrit, një minutë pyetja shtesë, dhe dy minuta për përgjigjen në pyetjen shtesë. Kuvendi duhet të shikojë mundësinë e rregullimit të kohës për pyetje parlamentare në një mënyrë më të efektshme sepse duket se të gjitha pyetjet nuk mund të procedohen brenda periudhës 50 minutëshe. Kuvendi mundet që, ose ta zgjas periudhën e pyetjeve ose ta kufizojë numrin e pyetjeve për deputet në mënyrë që t’u ipet mundësia të gjithë deputetëve që kanë parashtruar pyetje, t’i parashtrojnë ato dhe të marrin përgjigje. Sipas rregullës 26.11, “Nëse pyetja nuk ka marrë përgjigje brenda dy seancave, ajo publikohet në buletin e Kuvendit.” Buletini i fundit i kësaj legjislatore që është publikuar më 19 qershor përmban dhjetë pyetje të cilat nuk ka marrë përgjigje nga Qeveria brenda dy seancave plenare, siç kërkohet me rregullën 26. Megjithatë, Kuvendi duhet që ta ushtroj autoritetin e tij për të siguruar që qeveria t’u përgjigjet pyetjeve të deputetëve, sepse llogaridhënia e qeverisë është standard kyç i demokracisë parlamentare.

4. Qasja

- Gjatë periudhës raportuese, Shtylla e III-të (OSBE) ka pasur qasje në seancat plenare, në mbledhjet e Kryesisë dhe në mbledhjet e komisioneve, në shqyrtim. Shtylla e III-të gjithashtu ka pranuar kopjet e dokumentave të shqyrtuara nga Kuvendi si dhe transkriptin e seancave të kaluara.

5. Transparenca

- Ashtu siç është shpallur nga Kryetari i Kuvendit në seancën plenare të 15 shkurtit, kopjet e votimit elektronik të rexhstruar kanë filluar t’u shpërndahen të gjithë deputetëve të Kuvendit nga seanca e jashtëzakonshme plenare e 17 shkurtit. Rezultatet e votimit elektronik të disa seancave plenare poashtu janë publikuar në ueb faqen e Kuvendit, gjatë periudhës raportuese. Megjithatë, jo të gjitha rezultatet e votimeve elektronike u janë shpërndarë deputetëve apo janë publikuar në ueb faqen e Kuvendit gjatë periudhës raportuese. Kuvendi duhet që në mënyrë të qëndrueshme t’i publikojë rezultatet e votimeve elektronike në mënyrë që të rritet transparenca e Kuvendit, posaçërisht llogaridhënia e deputetëve ndaj votuesve të tyre. Është e rekomandueshme për komisionin për mandate, imunitete dhe Rregullore të Punës, që ta rregullojë në mënyrë të qartë në Rregulloren e re të Punës, çështjen e publikimit të rezultateve të votimeve elektronike. Radio Televizioni i Kosovës ka siguruar transmetimin e drejtpërdrejtë të seancave plenare në fjalë. Publikut dhe monitoruesve institucional iu është mundësuar hyrja në seancat plenare. Kuvendi ka ueb-faqen ([!\[\]\(065aacad479feea1b3f501fa02b79a7a_img.jpg\) Organization for Security and
Co-operation in Europe
Mission in Kosovo](http://www.assembly-</div><div data-bbox=)

kosova.org) që përmban detaje biografike të deputetëve të Kuvendit, informacione për strukturën dhe funksionimin e Kuvendit, procesverbale dhe transkripte nga seancat plenare të Kuvendit dhe mbledhjeve të komisioneve, kopje të ligjeve dhe rezolutave të miratuara nga Kuvendi, si dhe informacione të tjera.

FUND.

Shtylla III (OSBE)

Raporti 04/2008

Mbi monitorimin e Kuvendit të Kosovës

15 qershor 2008 – 30 shtator 2008

Titujt kryesor

- Ministri i punëve të jashtme i përgjigjet mocionit të interpelancës
- Kryesia miraton projektbuxhetin e Kuvendit për vitin 2009
- Kuvendi dështon në publikimin e rezultatit të votimit elektronik
- Kuvendi sërish vendos ta rishpall pozitën e Avokatit të Popullit
- Qeveria përmirëson nivelin e përgjigjeve në pyetjet parlamentare
- Kuvendi i kthen pesë ligje Qeverisë

1. Sfond

Raporti i pesëdhjetetë të i monitorimit është hartuar në përputhje me pikëpamjet referuese të Shtyllës së tretë të UNMIK-ut për themelimin e institucioneve (OSBE) dhe monitorimin e Kuvendit të Kosovës prej datës 26 nëntor 2002 dhe bazohet në Rregulloren e re të punës, të miratuar në fund të seancës plenare më 20 maj 2005 dhe të reviduar në seancën plenare të mbajtur më 1-2 qershor 2006 dhe 18 shtator 2007.

Shtylla e III-të (OSBE) ka monitoruar dhjetë seanca plenare, më 16 qershor; 19 qershor; 30 qershor; 15 korrik; 29 korrik; 30 korrik; 9 shtator; 18 shtator; 19 shtator; dhe 25 shtator, si dhe tetë mbledhje të Kryesisë, më 22 qershor; 2 korrik; 8 korrik; 16 korrik; 22 korrik; 9 shtator; 16 shtator dhe 23 shtator. Shtylla III (OSBE) ka monitoruar 51 nga 70 mbledhje të komisioneve dhe një dëgjim publik.

2. Vështrim

Seancën plenare të Kuvendit të Kosovës të mbajtur më 16 qershor e kryesoi Kryetari i Kuvendit z. Jakup Krasniqi (PDK).

- Njëqind e dy deputetë ishin të pranishëm në seancën plenare më 16 qershor.
- Pikat kryesore të rendit të ditës të seancës së plenare të mbajtur më 16 qershor:
 - Fjala e Kongresmenit të SHBA-ve Eliot Engel

Seancën plenare të mbajtur më 19 qershor e kryesoi Kryetari i Kuvendit z. Jakup Krasniqi (PDK) dhe anëtari i Kryesisë z. Naim Maloku (AAK).

- Shtatëdhjetë e katër deputetë ishin të pranishëm në seancën plenare më 19 qershor.
- Pikat kryesore të rendit të ditës të seancës plenare të mbajtur më 19 qershor:
 - Pyetjet për Qeverinë për përgjigje me gojë
 - Shqyrtimi i parë i projektligjit për armët (Projektligji është miratuar në parim me 75 vota për dhe pa vota kundër.)
 - Shqyrtimi i parë i projektligjit për ndryshimin e ligjit për akreditimin (Kjo pikë është shtyrë për shkak të mospranisë së Ministrit për tregti dhe industri për ta paraqitur projektligjin.)
 - Shqyrtimi i parë i projektligjit për ndryshimin e ligjit për administratën tatimore dhe procedurat (Kjo pikë është shtyrë për shkak të mospranisë së Ministrit për Financa dhe Ekonomi për ta paraqitur projektligjin.)
 - Shqyrtimi i dytë i projektligjit për përfitimet e ish zyrtarëve të lartë (Projektligji është miratuar me 70 vota për dhe pa vota kundër.)

- Shqyrtimi i kërkesës së Ministrisë për financa dhe ekonomi për realokimin e fondeve për investime kapitale, nga projekti “kompleksi i ri Qeveritar” në projektin “Renovimi i ndërtesës së mediave”
(Kërkesa është refuzuar me 19 vota për, 33 vota kundër dhe 15 abstenime.)

Seancën plenare të mbajtur më 30 qershor e kryesoi Kryetari i Kuvendit z. Jakup Krasniqi (PDK) dhe anëtari i Kryesisë z. Sabri Hamiti (LDK).

- Nëntëdhjetë e shtatë deputetë ishin të pranishëm në seancën plenare të 17 prillit.
- Pikat kryesore të rendit të ditës të seancës plenare të mbajtur më 17 prill:
 - Pyetjet për Qeverinë për përgjigje me gojë
 - Shqyrtimi i parë i projektligjit për ndryshimin e ligjit për akreditimin (Projektligji është miratuar në parim me 65 vota për dhe pa vota kundër.)
 - Shqyrtimi i parë i projektligjit për ndryshimin e ligjit për administratën tatimore dhe procedurat (Projektligji është miratuar në parim me 63 vota dhe pa vota kundër.)
 - Shqyrtimi i parë i projektligjit për ndryshimin e ligjit për arkivat (Projektligji është miratuar në parim me 58 vota për dhe pesë vota kundër.)
 - Shqyrtimi i parë i projektligjit për fuqizimin dhe pjesëmarrjen e rinisë (Projektligji është tërhequr nga sponsoruesi.)
 - Shqyrtimi i rekomandimit lidhur me emërimin e anëtarëve të komisionit shqyrtues të prokurimit (Kjo pikë është hequr nga rendi i ditës me kërkesë të grupit parlamentar të LDK-së, mbështetur nga grupet tjera parlamentare, meqë lista e kandidatëve nuk ishte complete.)
 - Shqyrtimi i dytë i projektligjit për procedurën kontestimore (Projektligji është miratuar me 71 vota për dhe pa vota kundër.)
 - Shqyrtimi i dytë i projektligjit për sponsorizimet në kulturë, rini dhe sport (Projektligji i është kthyer sponsoruesit për ripunim të mëtutjeshëm.)
 - Shqyrtimi i rekomandimit të komisionit për ekonomi, tregti, industri, energji, transport dhe komunikacion lidhur me ligjin për miniera dhe minerale (Rekomandimet janë miratuar me 58 vota për dhe gjashtë vota kundër.)
 - Shqyrtimi i rekomandimit të komisionit për ekonomi, tregti, industri, energji, transport dhe komunikacion lidhur me ligjin për kërkimet gjeologjike (Rekomandimet janë miratuar me 61 vota për dhe tetë vota kundër.)

Seancën plenare të mbajtur më 15 korrik e kryesoi Kryetari i Kuvendit z. Jakup Krasniqi (PDK) dhe anëtari i Kryesisë z. Xhavit Haliti (PDK).

- Shtatëdhjetë e pesë deputetë ishin të pranishëm në seancën plenare më 15 korrik.
- Pikat kryesore të rendit të ditës të seancës plenare të mbajtur më 15 korrik:

- Pyetjet për Qeverinë për përgjigje me gojë
- Shqyrtimi i dytë i projektligjit për sigurinë private (Projektligji është hequr nga rendi i ditës.)
- Shqyrtimi i rekomandimit të komisionit për shërbime publike, administratë lokale dhe media lidhur me kërkesën e Qeverisë për tërheqjen e ligjit për statistikat zyrtare (Rekomandimi është miratuar me 58 vota për dhe pa vota kundër.)
- Shqyrtimi i rekomandimit të komisionit për shëndetësi, punë dhe mirëqenie sociale lidhur me kërkesën e Qeverisë për tërheqjen e ligjit të punës (Rekomandimi është miratuar me 65 vota për dhe pa vota kundër.)
- Shqyrtimi i rekomandimit të komisionit për shëndetësi, punë dhe mirëqenie sociale lidhur me kërkesën e Qeverisë për tërheqjen e ligjit për sigurimet shëndetësore nga shpallja (Rekomandimi është miratuar me 65 vota për dhe një votë kundër.)
- Shqyrtimi i rekomandimit të komisionit për legjislacion dhe gjyqësi lidhur me emërimin e anëtarëve të komisionit për provimin e jurisprudencës (Kjo pikë është tërhequr me kërkesë të Ministrit të Drejtësisë.)

Seancën plenare të mbajtur më 29 korrik e kryesoi Kryetari i Kuvendit z. Jakup Krasniqi (PDK) dhe anëtari i Kryesisë z. Nexhat Daci (LDD).

- Nëntëdhjetë e nëntë deputetë ishin të pranishëm në seancën plenare më 29 korrik.
- Pikat kryesore të rendit të ditës të seancës plenare të mbajtur më 29 korrik:
 - Pyetjet për Qeverinë për përgjigje me gojë
 - Shqyrtimi i parë i projektligjit për ndryshimin e ligjit 03/08 për miratimin e buxhetit dhe shpenzimet e autorizuara për periudhën 1 janar deri më 31 dhjetor 2008 (Projektligji është miratuar në parim me 58 vota për dhe 23 vota kundër.)
 - Shqyrtimi i parë i projektligjit për partneritetin publiko-privat dhe koncesionet në ofrimin e infrastrukturës publike dhe shërbimeve dhe procedurës për dhënien e tyre (Projektligji është miratuar në parim me 76 vota për dhe shtatë vota kundër.)
 - Shqyrtimi i dytë i projektligjit për vultat në institucionet e Kosovës (Projektligji është miratuar me 66 vota për dhe pesë vota kundër.)
 - Shqyrtimi i rekomandimit të organit të pavarur përzgjedhës lidhur me emërimin e anëtarëve të organit shqyrtues të prokurimit (Rekomandimi është miratuar me 44 vota për dhe 35 kundër.)
 - Shqyrtimi i raportit vjetor 2007 i zyrës rregullatore të energjisë (Raporti është miratuar me 49 vota për dhe 17 vota kundër.)
 - Shqyrtimi i kërkesës së Qeverisë për tërheqjen e ligjeve të miratuara nga procedura e shpalljes (Kërkesa e Qeverisë është miratuar me 74 vota për dhe pa vota kundër.)

- Shqyrtimi i kërkesës së grupeve parlamentare për t'i kthyer ligjet e pashpallura te komisionet e Kuvendit për rishqyrtim¹⁴.)
(Kërkesa është miratuar me 76 vota për dhe një votë kundër.)

Seancën plenare të mbajtur më 30 korrik e kryesoi Kryetari i Kuvendit z. Jakup Krasniqi (PDK), dhe anëtari i Kryesisë z. Ibrahim Gashi (AKR).

- Tetëdhjetë e dy deputetë ishin të pranishëm në seancën plenare më 16 maj.
- Pikat kryesore të rendit të ditës të seancës plenare të mbajtur më 16 maj:
 - Shqyrtimi i dytë i projektligjit për ndryshimin e ligjit 03/08 për miratimin e buxhetit të Kosovës dhe shpenzimet e autorizuara për periudhën 1 janar deri më 31 dhjetor
(Projektligji është miratuar me 61 vota për dhe 11 vota kundër.)
 - Shqyrtimi i propozimit të Qeverisë për caktimin e datës së mbajtjes së rehstrimit të popullsisë
(Kjo pikë është shtyrë për shkak të mungesës së Ministrisë për shërbime publike.)

Seancën plenare të mbajtur më 9 shtator e kryesoi Kryetari i Kuvendit z. Jakup Krasniqi (PDK).

- Nëntëdhjetë e pesë deputetë ishin të pranishëm në seancën plenare më 9 shtator.
- Pikat kryesore të rendit të ditës të seancës plenare të mbajtur më 9 shtator:
 - Fjala e ish Ambasadorit të SHBA-ve në Kombet e Bashkuara z. Richard Holbrooke

Seancën plenare të mbajtur më 18 shtator e kryesoi Kryetari i Kuvendit z. Jakup Krasniqi (PDK), dhe anëtari i Kryesisë z. Xhavit Haliti (PDK).

- Njëqind e dy deputetë ishin të pranishëm në seancën plenare më 18 shtator.
- Pikat kryesore të rendit të ditës të seancës plenare më 18 shtator:
 - Pyetjet për Qeverinë për përgjigje me gojë
Interpelanca e Ministrisë për punë të jashtme
 - Shqyrtimi i parë i projektligjit për përdorimin, administrimin dhe mirëmbajtjen e ndërtesave në bashkëpronësi
(Projektligji është miratuar në parim me 60 vota për dhe pa vota kundër.)
 - Shqyrtimi i parë i projektligjit për ndryshimin e ligjit për kërkesat teknike të produkteve dhe vlerësimin e konformitetit
(Projektligji është miratuar me 60 vota për dhe pa vota kundër.)
 - Shqyrtimi i parë i projektligjit për Presidentin e Kosovës
(Projektligji është miratuar në parim me 51 vota për dhe pa vota kundër.)

14 Kërkesa e lartëshënuar i referohet 15 ligjeve të cilat janë miratuar në mandatin e kaluar dhe i janë dërguar PSPS-së por nuk janë shpallur para hyrjes në fuqi të kushtetutës së Kosovës.

- Shqyrtimi i dytë i projektligjit për ndërmjetësimin (Projektligji është miratuar me 59 vota për dhe pa vota kundër.)
- Shqyrtimi i propozimit për alokimin e fondeve Ministrisë së Forcës së Sigurisë (Kjo pikë është hequr nga rendi i ditës me kërkesë të komisionit për buxhet.)
- Shqyrtimi i propozimit për formimin e komisionit ad hoc për përzgjedhjen e anëtarëve të Bordit të Pavarur Mbikqyrës (Propozimi është miratuar me 57 vota për dhe pa vota kundër.)

Seancën plenare të mbajtur më 19 shtator e kryesoi Kryetari i Kuvendit z. Jakup Krasniqi (PDK) dhe anëtari i Kryesisë z. Sabri Hamiti (LDK).

- Nëntëdhjetë e shtatë deputetë ishin të pranishëm në seancën plenare më 19 shtator.
- Pikat kryesore të rendit të ditës të seancës plenare të mbajtur më 19 shtator:
 - Pyetjet për Qeverinë për përgjigje me gojë
 - Shqyrtimi i raportit të RTK-së për vitin 2007 (Kjo pikë është hequr nga rendi i ditës me kërkesë të grupit parlamentar të PDK-së.)
 - Shqyrtimi i raportit të KPM-së për vitin 2007 (Kryesuesi i komisionit për shërbime publike, administratë lokale dhe media bëri deklaratë hyrëse pasuar nga përfaqësuesit e grupeve parlamentare dhe disa deputetë tjerë.)
 - Shqyrtimi i raportit mbi shpenzimet nga buxheti i Kosovës gjatë gjysmës së parë të vitit 2008 (Ministri për Ekonomi dhe Financa bëri deklaratë hyrëse pasuar nga kryesuesi i komisionit për buxhet dhe financa, përfaqësuesit e grupeve parlamentare dhe disa deputetë tjerë para se debati të përmbyllej nga Ministri.)

Seancën plenare të mbajtur më 25 shtator e kryesoi Kryetari i Kuvendit z. Jakup Krasniqi (PDK) dhe anëtari i Kryesisë z. Eqrem Kryeziu (LDK).

- Nëntëdhjetë e dy deputetë ishin të pranishëm në seancën plenare më 25 shtator.
- Pikat kryesore të rendit të ditës të seancës plenare të mbajtur më 25 shtator:
 - Pyetjet për Qeverinë për përgjigje me gojë
 - Shqyrtimi i rekomandimit të komisionit për legjislacionin dhe gjyqësi lidhur me emërimin e Avokatit të Popullit (Kuvendi ka vendosur që ta anulojë procesin dhe ta rishpall pozitën e Avokatit të Popullit me 45 vota për dhe 15 vota kundër. Shiko më poshtë pjesën e titulluar “Kuvendi shpall pozitën e Avokatit të Popullit për herë të katërt”.)

- Shqyrtimi i parë i projektligjit për ndarjen e dekoratave nga Presidenti i Kosovës
(Projektligji është refuzuar me 30 vota për dhe 39 vota kundër.)
- Shqyrtimi i dytë i projektligjit për armët
(Projektligji i është kthyer sponzoruesit për ripunim të mëtutjeshëm.)
- Shqyrtimi i propozimit për formimin e komisionit ad hoc për përzgjedhjen e anëtarëve të Këshillit të KPM-së
(Propozimi është miratuar me 49 vota për dhe tetë vota kundër.)

3. Punimet dhe praktikat parlamentare në seancat e Kuvendit

Kryesia miraton projektbuxhetin e Kuvendit 2009

- Kryesia, në mbledhjen e mbajtur më 23 shtator, ka miratuar projektbuxhetin e Kuvendit për vitin 2009, të përgatitur nga Sekretari i Kuvendit, si dhe propozimin e z. Xhavit Haliti (PDK) i cili përfshin disa kategori shpenzuese shtesë. Megjithatë, propozimi i Kryesisë më vonë është kritikuar ashpër në media, nga shoqëria civile dhe nga Kryeministri, andaj, është ri shqyrtuar nga Kryesia. Në mbledhjen e radhës të Kryesisë z. Nexhat Daci (LDD) deklaroi se sipas rregullores së punës, projektbuxheti është dashur të përgatitet nga komisioni për buxhet dhe financa dhe se nuk është mirë që komisioni për buxhet dhe financa është përjashtuar nga procesi. Kryetari i Kuvendit poashtu u pajtua se komisioni për buxhet dhe financa është dashur të përfshihet dhe deklaroi se do të konsultohet me komisionin për buxhet dhe financa lidhur me projektbuxhetin e Kuvendit për vitin 2009.¹⁵
Sipas rregullës 6.7 të Rregullores së punës, Kryesia miraton projektbuxhetin e Kuvendit të përgatitur nga komisionit për buxhet në bashkëpunim me administratën e Kuvendit. Rregullorja e punës i jep komisionit për buxhet dhe financa kompetencën për ta përgatitur projektbuxhetin e Kuvendit. Andaj, Kryesia nuk ka pasur të drejtë ta përjashtojë Komisionin për buxhet dhe financa nga përgatitja e projektbuxhetit të Kuvendit.

Shpërndarja e projektligjeve

- Projektligji për ndryshimin e ligjit për akreditimin është shpërndarë më 26 maj; Projektligji për ndryshimin e ligjit për administratën tatimore dhe procedurat është shpërndarë më 27 maj; dhe projektligji për ndryshimin e ligjit për arkivat është shpërndarë më 11 qershor. Andaj, projektligjet janë shpërndarë, respektivisht, 24, 23 dhe 12 ditë pune para shqyrtimit të parë në seancën plenare më 30 qershor.
Projektligji për ndryshimin e ligjit 03/08 për miratimin e buxhetit të Kosovës dhe shpenzimet e autorizuar për periudhën 1 janar deri më 31 dhjetor 2008 është shpërndarë më 18 korrik, dhe projektligji për partneritetin publiko-privat dhe koncesionet në ofrimin e infrastrukturës publike dhe shërbimeve dhe procedurës për dhënie të tyre është shpërndarë më 10 korrik. Andaj,

15 Diskutimi i projektbuxhetit të Kuvendit për vitin 2009 nga ana e komisionit për buxhet dhe financa do të mbulohet në raportin monitorues të radhës.

projektligjet janë shpërndarë, respektivisht, gjashtë dhe 12 ditë pune para shqyrtimit të tyre të parë në seancën plenare të mbajtur më 29 korrik. Projektligji për përdorimin, administrimin dhe mirëmbajtjen e ndërtesave në bashkëpronësi dhe Projektligji për ndryshimin e ligjit për kërkesat teknike të produkteve dhe vlerësimin e konformitetit janë shpërndarë më 18 korrik; derisa projektligji për Presidentin e Kosovës është shpërndarë më 28 korrik. Andaj, projektligjet janë shpërndarë, respektivisht, 41 dhe 31 ditë para shqyrtimit të tyre të parë në seancën plenare më 18 shtator.

Rregulla 35.1 parasheh që shqyrtimi i parë i projektligjit duhet të bëhet jo më parë se dhjetë ditë pune dhe as më shumë se tri javë pune nga dita pas shpërndarjes së tij. Andaj, vetëm projektligji për ndryshimin e ligjit për arkivat dhe projektligji për partneritetin publiko-privat dhe koncesionet në ofrimin e infrastrukturës publike dhe shërbimeve dhe procedurat për dhënien e tyre janë shqyrtuar për herë të parë në pajtim me rregullën 35.1. Shqyrtimi i parë i gjashtë projektligjeve të lartpërmendura nuk është në pajtim me rregullën e lartpërmendur meqë pesë nga gjashtë projektligjet janë shqyrtuar për herë të parë tri javë pune pas shpërndarjes së tyre dhe një projektligj është shqyrtuar më herët se dhjetë ditë pune nga data e shpërndarjes së tij.

Shqyrtimi i parë i projektligjit për akreditimin dhe projektligji për administratën tatimore dhe procedurat janë radhitur për shqyrtim në pajtim me rregullën 35.1 por nuk është mbajtur ashtu siç ishte planifikuar për shkak të mungesës së ministrave përkatës të cilët kanë sponsoruar projektligjet në fjalë dhe është dashur t'i paraqesin ato para Kuvendit. Kjo gjë thekson nevojën për koordinim më të mirë mes Kuvendit dhe Qeverisë për të mos vonuar miratimin e projektligjeve.

Procesi legjislativ

- Në seancën plenare më 30 qershor, Ministri për kulturë, rini dhe sport ka tërhequr projektligjin për fuqizimin dhe pjesëmarrjen e rinisë nga shqyrtimi i parë për ripunim të mëtuajtshëm. Në seancën e njëjtë, z. Agim Veliu (LDK), kryesues i komisionit për arsim, shkencë, teknologji, kulturë, rini dhe sport ka propozuar që ligji për sponsorizimet në kulturë, rini dhe sporte që ishte radhitur për shqyrtim të dytë, t'i kthehet sponsorisuesit me arsyetimin se shumë dispozita të projektligjit janë të paqarta dhe kërkojnë ripunim të mëtuajtshëm. Kryetari i Kuvendit e hodhi në votim propozimin e z. Veliu i cili u miratua me 66 vota për dhe tri vota kundër. Në seancën plenare më 15 korrik, komisioni për shërbime publike, administratë lokale dhe media dhe komisioni për shëndetësi, punë dhe mirëqenie sociale, pas kërkesës së bërë nga Qeveria, i propozuan Kuvendit tërheqjen e projektligjit për statistikat zyrtare, dhe projektligjit të punës të cilat tashmë ishin miratuar në shqyrtim të parë. Kryetari i Kuvendit i hedhi të dyja propozimet në votim të cilat u miratuan me shumicë votash për. Në seancën plenare më 25 shtator, kryesuesi i komisionit për punë të brendshme dhe siguri z. Rrustem Mustafa (PDK) propozoi që projektligji për armët i radhitur për shqyrtim të dytë, t'i kthehet sponsorisuesit për ripunim të mëtuajtshëm. Kryetari i Kuvendit e hedhi në votim propozimin e z. Mustafa i cili është miratuar me 61 vota për dhe tri vota kundër.

Sipas rregullës 35.3 "Shqyrtimi i parë i projektligjit duhet të bëhet jo më parë se dhjetë ditë pune dhe as më shumë se tri javë pune nga dita e shpërndarjes së tij." Andaj, projektligji për fuqizimin dhe pjesëmarrjen e rinisë është tërhequr nga ana e sponsoruesit në pajtim me rregullën e lartpërmendur. Megjithatë, projektligji për statistikën zyrtare, dhe projektligji për punën janë tërhequr pas shqyrtimit të parë, gjë që nuk është në pajtim me rregullën 35.3. Qeveria është dashur që të kërkojë tërheqjen e këtyre dy ligjeve para miratimit të tyre në parim. Për më tepër, në analogji me rregullën në fjalë, komisioni për arsim, shkencë, kulturë, rini dhe sport, dhe komisioni për punë të brendshme dhe siguri është dashur që t'i propozojnë Kuvendit tërheqjen e projektligjit për sponsorizimet në kulturë, rini dhe sport, dhe projektligjit për armët sponsorizuesit në pajtim me rregullën 35.3. Për më tepër, rregulla 35.7 parashihet që "komisioni funksional ose kryesor, mund ta shqyrtojë projektligjin në parim edhe para shqyrtimit të parë të projektligjit në seancë plenare." Sikur komisionet funksionale të lartpërmendura t'i kishin shqyrtuar projektligjet në fjalë para shqyrtimit të tyre të parë, ashtu siç lejohet me rregullën 35.7, do të kishin pasur mundësinë që t'i vërejnë më herët mangësitë e projektligjeve dhe të propozojnë kthimin e tyre sponsoruesve gjatë shqyrtimit të tyre të parë, në vend se t'i bëjnë këto propozime shumë më vonë. Është tepër e rekomandueshme për komisionet e Kuvendit që ta shfrytëzojnë mundësinë e shqyrtimit të projektligjeve para shqyrtimit të tyre të parë në mënyrë që procesi legjislativ të bëhet më i efektshëm.

- Gjatë periudhës raportuese, përafërsisht 10 % e mbledhjeve të caktuara të komisioneve janë anuluar për shkak të mungesës së kuorumit, gjë që ndodh për shkak se disa deputetë nuk paraqiten në mbledhjet e komisioneve. Anulimi i këtyre mbledhjeve poashtu shkakton vonesë në shqyrtimin dhe miratimin e projektligjeve dhe dokumenteve tjera. Gjatë periudhës raportuese në fjalë, ka pasur më pak anulime të mbledhjeve për shkak të mungesës së kuorumit se sa gjatë periudhës raportuese paraprake ku përafërsisht 20 % të mbledhjeve janë anuluar, gjë që paraqet përmirësim. Megjithatë, Kuvendi mund të konsideroj krijimin e një mekanizmi për të siguruar kuorum në mbledhjet e komisioneve.

Formimi i grupit të ri parlamentar

- Më 11 shtator, deputetët e PDAK-së, deputetët e SDA-së dhe z. Driton Tali (ish deputet i AKR-së) i kanë dorëzuar me shkrim Kryesisë, vendimin e tyre për formimin e një grupi parlamentar të quajtur "Për Integritim"¹⁶. Në mbledhjen e Kryesisë të mbajtur më 17 shtator, sekretari i Kuvendit e ka informuar Kryesinë se ky grup nuk i ka gjashtë deputetë, siç kërkohet me rregullore, sepse një deputet i PDAK-së, z. Sabit Rrahmani, më 13 shtator kishte arritur kufirin gjyashëmujor të abstenimit nga punimet e Kuvendit pa dhënë arsytet për mungesën e tij gjë që mund të pasojë me humbjen e statusit të tij si deputet i Kuvendit. Për më tepër, sekretari bëri vërejtjen se dy deputetët e SDA-së tashmë janë pjesë e grupit parlamentar të AAK-së dhe se sipas rregullores ata

¹⁶ PDAK-ja përfaqëson komunitetin ashkali me tri ulëse në Kuvend, derisa SDA-ja, që përfaqëson komunitetin boshnjak, ka dy ulëse.

nuk mund t'i përkasin dy grupeve parlamentare. Anëtarët e Kryesisë deklaruan se nuk kanë për qëllim ta pengojnë formimin e grupit të ri parlamentar, por ky grup duhet t'i përmbush kushtet ligjore. Andaj, Kryetari i Kuvendit ka vendosur që të konsultohet me komisionin për mandate, imunitete dhe rregullore të punës lidhur me rastin e z. Rrahmani,¹⁷ dhe Kryesia ka vendosur që të kërkoj nga deputetët e SDA-së që ta qartësojnë anëtarësimin e tyre në grupin parlamentar të AAK-së dhe t'i informojnë ata se nuk mund të jenë anëtarë të dy grupeve parlamentare në të njëjtën kohë.

Sipas rregullores së punës (rregulla 14.3), "Nëse deputeti i Kuvendit në periudhën gjashtëmujore (6) nuk merr pjesë në asnjë seancë të Kuvendit ose të Komisionit ku është anëtar dhe nuk mund të dëshmojë arsye bindëse për kryetarin e Kuvendit, atëherë kryetari i Kuvendit i propozon Kuvendit për deputetin në fjalë pushimin e funksionit të tij. Për këtë çështje kërkohet mendimi i Komisionit për Mandate dhe Imunitet."

Sipas rregullës 11.1 (kapitulli IV i rregullores së punës), gjashtë ose më tepër deputetë mund të formojnë grup parlamentar në funksion të një qëllimi politik të përbashkët ku ky grup i a komunikon Kryesisë emrin e shefit të tij dhe të anëtarëve të tjerë. Për më tepër, sipas rregullës 11.4, një deputet nuk mund t'i përkasë më tepër se një grupi parlamentar. Andaj, grupi i ri parlamentar "Për Integrim" mund të mos funksionojë si grup deri në zgjidhjen e çështjes së statusit të z. Rrahmani nga ana e Kuvendit dhe deri atëherë kur deputetët e SDA-së ta kenë qartësuar se në cilin grup parlamentar dëshirojnë të marrin pjesë.

Kuvendi shpall pozitën e Avokatit të Popullit për herë të katërt

- Në fillim të seancës plenare të mbajtur më 25 shtator, Kryetari i Kuvendit propozoi që Kuvendi ta anulojë procesin në zhvillim e sipër për emërimin e Avokatit të Popullit dhe ta rishpall pozitën në fjalë. Grupet parlamentar të PDK-së, LDK-së, AKR-së, 7+, dhe SLS-së, e mbështetën propozimin e Kryetarit derisa grupet parlamentare të LDD-së dhe AAK-së e kundërshtuan këtë propozim dhe kërkuan shpjegime shtesë nga Kryetari. Kryetari i Kuvendit u përgjigj se ai e bëri këtë propozim për "të mbrojtur kredibilitetin e Kuvendit". Ai më pas e hedhi në votim propozimin e lartpërmendur i cili është miratuar me 45 vota për dhe 15 vota kundër. Në pajtim me vendimin e Kuvendit, Kryesia ka ngarkuar administratën për ta rishpallur pozitën e Avokatit të Popullit të Kosovës për herë të katërt. Të gjithë anëtarët e Kryesisë u pajtuan se pozita duhet rishpallur dhe plotësuar sa më parë të jetë e mundur.¹⁸

Interpelanca

- Në seancën plenare të mbajtur më 18 shtator, Ministri për punë të jashtme Skënder Hyseni i është përgjigjur mocionit të interpelancës të parashtruar nga

¹⁷ Shqyrtimi i rastit të z. Rrahmani nga ana e komisionit për mandate, imunitete dhe rregullore të punës do të mbulohet në raportin monitorues të radhës.

¹⁸ Pozita e Avokatit të Popullit është shpallur më 9 tetor dhe është publikuar në pesë gjuhë (në gjuhën Shqipe, angleze, serbe, boshnjake dhe turke) në mediat lokale të shkruara.

grupi parlamentar i AKR-së. AKR-ja ka kërkuar nga Ministri që “të raportojë për defektet në procesin e njohjes së pavarësisë së Kosovës, në konsolidimin e Ministrisë dhe në shtrirjen e shërbimit diplomatik të jashtëm të Kosovës.” Në emër të AKR-së, z. Ibrahim Gashi bëri deklaratën hyrëse. AKR-ja si edhe LDD-ja dhe AAK-ja e kritikuan ministrin për mungesë të programit dhe strategjisë për politikë të jashtme, nepotizëm, lobing të pamjaftueshëm për njohje të mëtutjeshme të pavarësisë dhe mungesë të përvojës diplomatike të të ngarkuarve me punë të emëruar në dhjetë zyrat e para diplomatike të Kosovës. Disa deputetë nga opozita kërkuar edhe dorëheqjen e ministrit. Ministri u përgjegj se ligji për ministrinë e jashtme ka hyrë në fuqi më 16 qershor dhe se ai ka pasur kohë të shkurtër për ngritjen e kapaciteteve të plota të ministrisë. Ai shtoi se ka pasur vështirësi në përzgjedhjen e të ngarkuarve me punë për shkak të përvojës së shkurtër të Kosovës në diplomaci dhe punë të jashtme. Ai më tej tha se puna e ministrisë nuk është vetëm lobimi për pavarësi por edhe detyra të tjera poashtu dhe se ai ka provuar t'i kontaktojë shumë nga homologët e tij nga shumë vende të cilat ende nuk e kanë njohur pavarësinë e Kosovës, gjë që ka qenë e vështirë sepse shumë ministra kanë hezituuar të takohen me të. Disa deputetë nga grupe të ndryshme parlamentare bënë deklaratë para se debati të përmbyllet nga z. Ibrahim Gashi (AKR) si sponsorues i mocionit.

Debati i interpelancës është mbajtur në pajtim me rregullën 25.7, sipas së cilës grupi parlamentar që ka propozuar interpelancën ka të drejtën ta hap debatin me një deklaratë dhjetë (10) minutëshe dhe ta mbyll atë me një deklaratë pesë (5) minutëshe, dhe se ndarja e kohës për grupet tjera parlamentare reflekton përfaqësimin e tyre në Kuvend.

Pyetjet për Qeverinë

- Në seancën plenare të 19 qershorit, dy nga 12 pyetje morën përgjigje. Në seancën plenare të 30 qershorit, katër nga 16 pyetje morën përgjigje. Në seancën plenare të 15 korrikut, 22 nga 23 pyetje morën përgjigje. Në seancën plenare të 29 korrikut 12 nga 15 pyetje morën përgjigje. Në seancën plenare të 18 shtatorit, 12 pyetje janë procesuar prej të cilave vetëm një ka marrë përgjigje ndërsa 28 pyetjet e mbetura janë bartur për seancën plenare të radhës më 19 shtator, sepse koha e ndarë për pyetje ka kaluar. Në seancën plenare të 19 shtatorit 14 pyetje janë procesuar prej të cilave dy nuk kanë marrë përgjigje, derisa 14 pyetjet e mbetura janë shtyrë sërish për seancën plenare të radhës, sepse koha për pyetje parlamentare kishte kaluar. Në seancën plenare të 25 shtatorit, 11 nga 12 pyetjet e procesuara kanë marrë përgjigje derisa nëntë pyetjet e mbetura janë shtyrë përsëri për seancën plenare të radhës sepse koha për pyetje parlamentare kishte kaluar. *Periudhat për pyetjet parlamentare të dy seancave në fjalë janë bërë në pajtim me rregullën 26 mbi “pyetjet për Qeverinë për përgjigje gojore”, e cila parasheh që rendi i ditës i secilës seancë plenare të përfshijë një periudhë deri në 50 minuta për pyetjet e deputetëve për Qeverinë, ku një minutë zgjat pyetja, tre minuta përgjigjja e ministrit, një minutë pyetja shtesë, dhe dy minuta për përgjigjen në pyetjen shtesë.*

Gjatë periudhës raportuese, niveli i përgjigjeve të Qeverisë në pyetjet parlamentar ka shënuar përmirësim në krahasim me periudhat raportuese paraprahe.¹⁹ Në anën tjetër, deputetët kanë vazhduar të parashtrijnë numër të madh të pyetjeve gjë që ka rezultuar me shtyerje të shumë pyetjeve për shkak se koha për pyetjet parlamentare ka përfunduar. Kuvendi duhet të shikojë mundësinë e rregullimit të kohës për pyetje parlamentare në një mënyrë më të efektshme sepse është vërejtur se jo të gjitha pyetjet nuk mund të procedohen brenda periudhës 50 minutëshe. Kuvendi duhet që, ose ta zgjas periudhën e pyetjeve ose ta kufizojë numrin e pyetjeve për deputet në mënyrë që t'u ipet mundësia të gjithë deputetëve që kanë parashtruar pyetje, t'i parashtrijnë ato dhe të marrin përgjigje.

Sipas rregullës 26.11, "Nëse pyetja nuk ka marrë përgjigje brenda dy seancave, ajo publikohet në buletinën e Kuvendit." Dy buletinët e Kuvendit të publikuar gjatë periudhës raportuese, më 19 qershor dhe 20 shtator përmbajnë njëmbëdhjetë pyetje të cilat nuk ka marrë përgjigje nga Qeveria, ashtu siç kërkohet me rregullën 26. Megjithatë, Kuvendi mund të përpiket më shumë dhe ta ushtroj autoritetin e tij për të siguruar llogaridhënien nga Qeveria që është standard kyç i demokracisë parlamentare.

4. Qasja

- Gjatë periudhës raportuese, Shtylla e III-të (OSBE) ka pasur qasje në seancat plenare, në mbledhjet e Kryesisë dhe në mbledhjet e komisioneve, në shqyrtim. Shtylla e III-të gjithashtu ka pranuar kopjet e dokumentave të shqyrtuara nga Kuvendi si dhe transkriptin e seancave të kaluara.

5. Transparenca

- Gjatë periudhës raportuese Kuvendi nuk ka publikuar në web faqen e vet asnjë nga rezultatet elektronike të vendimeve të marra në seanca plenare. Në periudhën raportuese paraprahe, Kuvendi ka publikuar disa rezultate të votimit elektronik, por ka dështuar ta bëjë këtë më vonë. Kuvendi duhet që t'i publikojë rezultatet e votimit elektronik në mënyrë të vazhdueshme në mënyrë që ta rris transparencën e Kuvendit, posaçërisht përgjegjësinë e deputetëve para votuesve të tyre.²⁰ Radio Televizioni i Kosovës ka siguruar transmetimin e drejtpërdrejtë të seancave plenare në fjalë. Publikut dhe monitoruesve institucional iu është mundësuar hyrja në seancat plenare. Kuvendi ka ueb-

¹⁹ Për më shumë detaje, shiko raportin 02/2008 dhe 03/2008 të shtyllës së III-të (OSBE) mbi monitorimin e Kuvendit të Kosovës.

²⁰ Në seancën plenare të mbajtur më 15 shkurt 2008, Kryetari i Kuvendit ka lajmëruar se Kuvendi do t'i publikojë në web faqen e tij rezultatet e votimit elektronik të vendimeve të marra në seanca plenare. Pas këtij lajmërimi të Kryetarit, Kuvendi ka filluar publikimin e rezultateve të votimit elektronik nga seanca e jashtëzakonshme plenare të mbajtur më 17 shkurt. Rezultatet e votimeve elektronike nga disa seanca plenare janë publikuar në web faqen e Kuvendit. Megjithatë, rezultatet e fundit elektronike të publikuara në web faqe janë ato të seancës plenare të mbajtur më 2 qershor.

faqen (www.assembly-kosova.org) që përmban detaje biografike të deputetëve të Kuvendit, informacione për strukturën dhe funksionimin e Kuvendit, procesverbale dhe transkripte nga seancat plenare të Kuvendit dhe mbledhjeve të komisioneve, kopje të ligjeve dhe rezolutave të miratuara nga Kuvendi, si dhe informacione të tjera.

FUND.

Shtylla III (OSBE)

Raporti 05/2008

Mbi monitorimin e Kuvendit të Kosovës

1 tetor 2008 – 30 nëntor 2008

Titujt kryesor

- Kryesia miraton Rezolutën në mbështetje të deklaratës së OKB-së për synimet zhvillimore të mileniumit
- Kuvendi miraton mocionin për shqyrtimin e ligjeve të pashpallura, por përjashton Komisionin për të drejtat dhe interesat e komuniteteve nga procedura
- Themelohet paneli rekrutues për përzgjedhjen e Avokatit të Popullit
- Kuvendi bën përpjekje për përmirësimin e funksionimit të periudhës për pyetjet parlamentare
- Kuvendi vazhdon të dështojë në publikimin e rezultatit elektronik të votimit

1. Sfond

Raporti i pesëdhjetenëntë i monitorimit është hartuar në përputhje me pikëpamjet referuese të Shtyllës së tretë të UNMIK-ut për themelimin e institucioneve (OSBE) dhe monitorimin e Kuvendit të Kosovës prej datës 26 nëntor 2002 dhe bazohet në Rregulloren e re të punës, të miratuar në fund të seancës plenare më 20 maj 2005 dhe të reviduar në seancën plenare të mbajtur më 1-2 qershor 2006 dhe 18 shtator 2007.

Shtylla e III-të (OSBE) ka monitoruar shtatë seanca plenare, më 3 dhe 10 tetor; më 6 dhe 7 nëntor; më 7 nëntor; 10 nëntor; 20 nëntor dhe 25 nëntor, si dhe shtatë mbledhje të Kryesisë, më 3 tetor; 14 tetor; 28 tetor; 4 nëntor; 11 nëntor; 18 nëntor dhe 24 nëntor. Shtylla III (OSBE) ka monitoruar 41 nga 57 mbledhje të komisioneve dhe një dëgjim publik.

2. Vështrim

Seancën plenare të Kuvendit të Kosovës të mbajtur më 3 dhe 10 tetor e kryesoi Kryetari i Kuvendit z. Jakup Krasniqi (PDK) dhe anëtari i Kryesisë z. Ibrahim Gashi (AKR).

- Nëntëdhjetë e gjashtë deputetë ishin të pranishëm respektivisht në seancën plenare më 3 dhe 10 tetor.
- Pikat kryesore të rendit të ditës të seancës së plenare të mbajtur më 3 dhe 10 tetor:
 - Pyetjet për Qeverinë për përgjigje me gojë
 - Shqyrtimi i mocionit procedural për miratimin e ligjeve të pashpallura (mocioni procedural është miratuar me 51 vota për dhe nëntë vota kundër)
 - Shqyrtimi i rekomandimit për amendamentimin e ligjit për letërnjoftimin (Rekomandimi është miratuar me 72 vota për dhe pa vota kundër.)
 - Shqyrtimi i rekomandimit për amendamentimin e ligjit për kooperativat bujqësore (Rekomandimi është miratuar me 72 vota për dhe pa vota kundër.)
 - Shqyrtimi i rekomandimit të Komisionit për bujqësi, pylltari, zhvillim rural, ambient dhe planifikim hapësinor lidhur situatën në parkun kombëtar "Malet e Sharrit" dhe fshati turistik në bjeshkët e Prevallës (Z. Lulzim Zeneli, kryesues i komisionit, bëri deklaratë pasuar nga përfaqësuesit e grupeve parlamentare, ministri për ambient dhe planifikim hapësinor dhe disa deputetë tjerë.)

Seancën solemne plenare të mbajtur më 17 tetor e kryesoi Kryetari i Kuvendit z. Jakup Krasniqi (PDK) dhe anëtari i Kryesisë z. Naim Maloku (AAK).

- Njëqind e një deputetë ishin të pranishëm në seancën plenare më 17 tetor.

- Pikat kryesore të rendit të ditës të seancës plenare të mbajtur më 17 tetor:
 - Miratimi i Rezolutës në mbështetje të deklaratës së OKB-së për synimet zhvillimore të mileniumit (Rezoluta është miratuar me 99 vota për dhe dy vota kundër.)

Seancën plenare të mbajtur më 17 tetor e kryesoi Kryetari i Kuvendit z. Jakup Krasniqi (PDK) dhe anëtari i Kryesisë z. Eqrem Kryeziu (LDK).

- Tetëdhjetë e dy deputetë ishin të pranishëm në seancën plenare më 17 tetor.
- Pikat kryesore të rendit të ditës të seancës plenare të mbajtur më 17 tetor:
 - Pyetjet për Qeverinë për përgjigje me gojë
 - Shqyrtimi i parë i projektligjit për masat anti-damping (Projektligji është miratuar në parim me 68 vota për dhe pa vota kundër.)
 - Shqyrtimi i parë i projektligjit për bujqësi dhe zhvillim rural (Projektligji është shtyrë për shkak të mospranisë së ministrit për bujqësi për ta bërë paraqitjen e ligjit.)
 - Shqyrtimi i dytë i projektligjit për amandamentimin e ligjit për ndërmarrjet e vogla dhe të mesme (Projektligji është miratuar në parim me 63 vota për dhe dy vota kundër.)
 - Shqyrtimi i dytë i projektligjit për noterinë (Projektligji është miratuar me 59 vota për dhe pa vota kundër.)
 - Miratimi i rekomandimeve të komisionit për bujqësi, pylltari, zhvillim rural, ambient dhe planifikim hapësinor (Rekomandimet janë miratuar me 59 vota për dhe pa vota kundër.)
 - Shqyrtimi i raportit të komisionit për buxhet dhe financa lidhur me monitorimin e zbatimit të ligjit për revizionin e brendshëm (Raporti është shtyrë me kërkesë të kryesuesit të komisionit.)
Zëvendësimi i deputetëve nëpër komisione nga radhët e grupeve parlamentare të LDK-së dhe AKR-së

Seancën plenare të mbajtur më 6 dhe 7 nëntor e kryesoi Kryetari i Kuvendit z. Jakup Krasniqi (PDK) dhe anëtari i Kryesisë z. Sabri Hamiti (LDK).

- Tetëdhjetë e katër deputetë ishin të pranishëm respektivisht, në seancën plenare më 6 e 7 nëntor.
- Pikat kryesore të rendit të ditës të seancës plenare të mbajtur më 6 e 7 nëntor:
 - Pyetjet për Qeverinë për përgjigje me gojë
 - Shqyrtimi i parë i projektligjit për bujqësi dhe zhvillim rural (Projektligji është miratuar në parim me 75 vota për dhe pa vota kundër.)
 - Shqyrtimi i parë i projektligjit për faljen (Projektligji është miratuar në parim me 58 vota për dhe dy vota kundër.)
 - Shqyrtimi i parë i projektligjit për themelimin e departamentit të mjekësisë ligjore (Projektligji është refuzuar me 24 vota për dhe 30 vota kundër.)

- Shqyrtimi i parë i projektligjit për lizingun financiar (Projektligji është miratuar në parim me 53 vota për dhe tri vota kundër.)
- Shqyrtimi i rekomandimit për amendamentimin e Kodit Penal të Kosovës (Rekomandimi është miratuar me 58 vota për dhe pa vota kundër.)
- Shqyrtimi i rekomandimit për amendamentimin e Kodit të Procedurës Penale të Kosovës (Rekomandimi është miratuar me 58 vota për dhe një votë kundër.)
- Shqyrtimi i rekomandimit për amendamentimin e ligjit për provimin përfundimtar dhe të maturës (Rekomandimi është miratuar me 64 vota për dhe pa vota kundër.)
- Shqyrtimi i rekomandimit për amendamentimin e ligjit për ndërprerjen e shtatzënisë (Rekomandimi është miratuar me 47 vota për dhe pesë vota kundër.)
- Shqyrtimi i dytë i projektligjit për ansamblin e këngëve dhe valleve “Shota” dhe ansambleve tjera (Projektligji është miratuar me 59 vota për dhe dy vota kundër.)
- Shqyrtimi i dytë i projektligjit për kualifikimet kombëtare (Projektligji është miratuar me 76 vota për dhe pa vota kundër.)
- Shqyrtimi i dytë i projektligjit për amendamentimin e ligjit për arkivat dhe materialin arkivor (Projektligji është miratuar me 60 vota për dhe gjashtë vota kundër.)
- Shqyrtimi i dytë i projektligjit për produktet për mbrojtjen e bimëve (Projektligji është miratuar me 70 vota për dhe pa vota kundër.)
- Shqyrtimi i rekomandimit të komisionit për punë të brendshme dhe siguri për kthimin e projektligjit për kompanitë private të sigurisë sponzoruesit për ripunim të mëtutjeshëm (Rekomandimi është miratuar me 71 vota për dhe pa vota kundër.)
- Shqyrtimi i rekomandimit të komisionit për ekonomi, tregti, industri, energji, transport dhe komunikacion lidhur me emërimin e anëtarëve të Komisionit të Konkurrencës (Rekomandimi është miratuar me 55 vota për dhe pesë vota kundër.)
- Shqyrtimi i raportit të komisionit për buxhet dhe financa lidhur me monitorimin e zbatimit të ligjit për revizionin e brendshëm (Kjo pikë është shtyrë për shkak të mungesës së ministrit për ekonomi dhe financa.)
- Zëvendësimi i deputetëve të grupit parlamentar SLS në komisione

Seancën plenare të mbajtur më 7 nëntor e kryesoi Kryetari i Kuvendit z. Jakup Krasniqi (PDK) dhe anëtari i Kryesisë z. Džezair Murati (7+/Vakat).

- Shtatëdhjetë e gjashtë deputetë ishin të pranishëm në seancën plenare më 7 nëntor.
- Pikat kryesore të rendit të ditës të seancës plenare të mbajtur më 7 nëntor:
 - Shqyrtimi i parë i projektligjit për amendamentimin e ligjit për ministrinë e forcës së sigurisë së Kosovës

- (Projektligji është miratuar në parim me 69 vota për dhe një votë kundër.)
Shqyrtimi i parë i projektligjit për amandamentimin e ligjit për forcën e sigurisë së Kosovës
- (Projektligji është miratuar në parim me 72 vota për dhe dy vota kundër.)
Shqyrtimi i parë i projektligjit për amandamentimin e ligjit për planifikimin hapësinor
- (Projektligji është miratuar në parim me 59 vota për dhe pesë vota kundër.)
Shqyrtimi i parë i Projektkodit doganor dhe akcizës në Kosovë
(Projektkodi është miratuar në parim me 38 vota për dhe gjashtë vota kundër.)

Seancën plenare të mbajtur më 10 nëntor e kryesoi Kryetari i Kuvendit z. Jakup Krasniqi (PDK), dhe anëtar i Kryesisë z. Eqrem Kryeziu (LDK).

- Tetëdhjetë e nëntë deputetë ishin të pranishëm në seancën plenare më 10 nëntor.
- Pikat kryesore të rendit të ditës të seancës plenare të mbajtur më 10 nëntor:
 - Shqyrtimi i dytë i projektligjit për amandamentimin e ligjit për ministrinë e forcës së sigurisë së Kosovës
(Projektligji është miratuar me 79 vota për dhe dy vota kundër.)
 - Shqyrtimi i dytë i projektligjit për amandamentimin e ligjit për forcën e sigurisë së Kosovës
(Projektligji është miratuar me 82 vota për dhe një votë kundër.)
 - Shqyrtimi i dytë i projektligjit për amandamentimin e ligjit për planifikimin hapësinor
(Projektligji është miratuar me 69 vota për dhe katër vota kundër.)
 - Shqyrtimi i dytë i Projektkodit doganor dhe akcizës në Kosovë
(Projektkodi është miratuar me 63 vota për dhe 12 vota kundër.)

Seancën plenare të mbajtur më 20 nëntor e kryesoi Kryetari i Kuvendit z. Jakup Krasniqi (PDK) dhe anëtar i Kryesisë z. Xhavit Haliti (PDK).

- Tetëdhjetë e një deputetë ishin të pranishëm në seancën plenare më 20 nëntor.
- Pikat kryesore të rendit të ditës të seancës plenare të mbajtur më 20 nëntor:
 - Pyetjet për Qeverinë për përgjigje me gojë
 - Shqyrtimi i parë i projektligjit për mbrojtjen nga rrezatimi jonizues jo jonizues dhe sigurinë nukleare
(Projektligji është miratuar në parim me 63 vota për dhe tri vota kundër.)
 - Shqyrtimi i rekomandimit për amandamentimin e ligjit për ngrohjen qendrore
(Rekomandimi është miratuar me 64 vota për dhe pa vota kundër.)
 - Shqyrtimi i rekomandimit për amandamentimin e ligjit për procedurën jo kontestimore

- (Rekomandimi është miratuar me 63 vota për dhe pa vota kundër.)
- Shqyrtimi i rekomandimit për amandamentimin e ligjit për provimin e jurisprudencës
(Rekomandimi është miratuar me 68 vota për dhe pa vota kundër.)
- Shqyrtimi i dytë i projektligjit për inspektoratin bujqësor
(Projektligji është miratuar me 74 vota për dhe pa vota kundër.)
- Shqyrtimi i dytë i projektligjit për amandamentimin e ligjit për akreditim
(Projektligji është miratuar me 69 vota për dhe pa vota kundër.)
- Shqyrtimi i raportit të komisionit për buxhet dhe financa lidhur me monitorimin e zbatimit të ligjit për revizionin e brendshëm
(Raporti me rekomandime është miratuar me 63 vota për dhe pa vota kundër.)
- Shqyrtimi i raportit për ambientin 2006 – 2007
(Raporti është miratuar me 42 vota për dhe 16 vota kundër.)
- Zëvendësimi i deputetëve në komisione nga radhët e grupit parlamentar të PDK-së

Seancën plenare të mbajtur më 25 nëntor e kryesoi Kryetari i Kuvendit z. Jakup Krasniqi (PDK), dhe anëtari i Kryesisë z. Ibrahim Gashi (AKR).

- Nëntëdhjetë deputetë ishin të pranishëm në seancën plenare më 25 nëntor.
- Pikat kryesore të rendit të ditës të seancës plenare më 25 nëntor:
 - Shqyrtimi i parë i projektligjit për buxhetin e Kosovës 2009 dhe shpenzimet e autorizuara për periudhën 1 janar 2009 – 31 dhjetor 2009
(Projektligji është miratuar në parim me 62 vota për dhe katër vota kundër.)

3. Punimet dhe praktikat parlamentare në seancat e Kuvendit

Mocioni procedural për miratimin e ligjeve të pashpallura

- Kuvendi i Kosovës në seancën plenare të mbajtur më 3 tetor, ka miratuar një mocion procedural për shmangie nga rregullorja e punës në mënyrë që me procedurë të posaçme të amandamentohen 17 ligje të pashpallura nga ana e PSSP-së.²¹ Sipas mocionit secili nga 17 ligjet e pashpallura do të shqyrtohet nga komisioni përkatës i cili obligohet t'i paraqes amandamentet e tij në Kuvend për shqyrtim. Për më tepër, mocioni parasheh që komisioni për buxhet dhe financa t'i shqyrtojë amandamentet e propozuara për implikime eventuale financiare. Shumica e shefave të grupeve parlamentare e kanë mbështetur mocionin procedural pa asnjë vërejtje. Z. Sadik Idrizi (7+/Vakat) dhe z. Mahir Yagcilar (7+/KDTP) propozuan që edhe komisioni për të drejtat dhe interesat

21 Në korrik 2008, Qeveria i ka dorëzuar Kuvendit kërkesën për tërheqjen e ligjeve të pashpallura nga PSSP-ja dhe të njëjtat t'i amandamentojë më pas. Kuvendi ka mbështetur dhe miratuar kërkesën e Qeverisë më 30 korrik dhe më vonë ka hartuar mocionin procedural për amandamentimin e ligjeve me procedurë të posaçme. Mocioni është miratuar në Kryesi më 29 shtator, dhe është përfshirë në rendin e ditës së seancës plenare të mbajtur më 3 tetor. Për më shumë detaje shiko raportin e OSBE-së 04/2008 mbi monitorimin e Kuvendit.

e komuniteteve të përfshihet në proces për të parë nëse amendamentet e propozuara i çënojnë të drejtat dhe interesat e komuniteteve. Shefi i grupit parlamentar SLS u pajtua me mocionin e propozuar pa asnjë vërejtje. Kryetari i Kuvendit u përgjigj se shefat e grupeve parlamentare nuk kanë bërë asnjë koment në mbledhjen e fundit të Kryesisë, kur ishte paraqitur dhe debatuar mocioni, prandaj ai vazhdoi duke hedhur në votim mocionin por pa përfshirë propozimin e lartëpërmendur. Mocioni është miratuar me 51 vota për, nëntë vota kundër dhe dy abstenime.

Sipas rregullës 61, Kuvendi është i autorizuar që t'i shmanget Rregullores së Punës, megjithatë meqë ka vendosur që ta përfshijë në proces komisionin për buxhet dhe financa, është dashur që poashtu ta përfshij edhe komisioni për të drejtat dhe interesat e komuniteteve, i cili është komision kryesor poashtu, për ta dhënë mendimin e tij lidhur me amendamentet e propozuar, nga perspektiva e të drejtave të komuniteteve.

Shpërndarja e projektligjeve

- Projektligji për masat anti dumping është shpërndarë më 23 shtator. Andaj, projektligji është shpërndarë 15 ditë pune para shqyrtimit të tij të parë më 17 tetor. Projektligji për bujqësinë dhe zhvillimin rural është shpërndarë më 6 tetor, projektligji për faljen është shpërndarë më 9 tetor; dhe projektligji për lizingun financiar është shpërndarë më 17 tetor. Andaj, projektligjet janë shpërndarë respektivisht, 22, 19 dhe 13 ditë pune para shqyrtimit të parë në seancën plenare më 6 nëntor. Projektligji për mbrojtjen nga rrezatimi jonizues, jo jonizues dhe siguria nukleare është shpërndarë më 22 tetor. Andaj, projektligji është shpërndarë 20 ditë pune para shqyrtimit të tij të parë në seancën plenare të mbajtur më 20 nëntor. Projektligji për buxhetin e Kosovës 2009 dhe shpenzimet e autorizuara për periudhën 1 janar 2009 – 31 dhjetor 2009 është shpërndarë më 7 nëntor. Andaj, projektligji është shpërndarë 11 ditë pune para shqyrtimit të tij të parë në seancën plenare më 25 nëntor.
Rregulla 35.1 parasheh që shqyrtimi i parë i projektligjit duhet të bëhet jo më parë se dhjetë ditë pune dhe as më shumë se tri javë pune nga dita pas shpërndarjes së tij. Andaj, projektligji për masat anti-dumping, projektligji për lizingun financiar dhe projektligji për buxhetin e Kosovës dhe shpenzimet e autorizuara për periudhën 1 janar 2009 – 31 dhjetor 2009 janë shqyrtuar për herë të parë në pajtim me rregullën 35.1. Shqyrtimi i parë i tri projektligjeve të lartëpërmendura nuk është bërë në pajtim me rregullën e lartëpërmendur meqë janë shqyrtuar për herë të parë tri javë pune pas shpërndarjes së tyre.

Procesi legjislativ

- Në seancën plenare më 6 nëntor, z. Rrustem Mustafa (PDK), kryesues i komisionit për punë të brendshme dhe siguri ka propozuar që projektligji për sigurinë private t'i kthehet sponsoruesit për ripunim të mëtutjeshëm. Kryetari i Kuvendit e hodhi në votim propozimin e z. Mustafa i cili u miratua me 71 vota për dhe pa vota kundër.

Sipas rregullës 35.3 “Shqyrtimi i parë i projektligjit duhet të bëhet jo më parë se dhjetë ditë pune dhe as më shumë se tri javë pune nga dita e shpërndarjes së tij.” Në mënyrë analoge, komisioni për punë të brendshme dhe siguri është dashur t’i propozoj Kuvendit kthimin e projektligjit për kompanitë private të sigurisë sponsoruesit në pajtim me rregullën 35.3. Për më tepër, rregulla 35.7 parasheh që “komisioni funksional ose kryesor, mund ta shqyrtojë projektligjin në parim edhe para shqyrtimit të parë të projektligjit në seancë plenare.” Sikur komisionet funksionale të lartëpërmendura t’i kishin shqyrtuar projektligjet në fjalë para shqyrtimit të tyre të parë, ashtu siç lejohet me rregullën 35.7, do të kishin pasur mundësinë që t’i vërejnë më herët mangësitë e projektligjeve dhe të propozojnë kthimin e tyre sponsoruesve gjatë shqyrtimit të tyre të parë, në vend se ta bëjnë këtë propozim gjashtë muaj më vonë. Është e rekomandueshme për komisionet e Kuvendit që ta shfrytëzojnë mundësinë e shqyrtimit të projektligjeve para shqyrtimit të tyre të parë në mënyrë që procesi legjislativ të bëhet më i efektshëm.

- Kryesia, në mbledhjen e mbajtur më 18 nëntor ka shqyrtuar kërkesën e gjashtë deputetëve për ta përfshirë për lexim të parë në seancën plenare të radhës, projektligjin për të drejtat e ish të burgosurve politikë, i cili është sponsoruar prej tyre. Anëtarët e Kryesisë vendosën që mos ta radhisin projektligjin për shqyrtim në seancë plenare meqë i mungonte deklarata financiare mbi zbatueshmërinë e tij dhe i udhëzoi sponsoruesit e projektligjit që ta sigurojnë deklaratën financiare nga ministria për ekonomi dhe financa.

Rregulla 33.2 (d) parasheh që me rastin e paraqitjes së projektligjit për shqyrtim në Kuvend, projektligji duhet të përmbajë deklaratën mbi ndikimin buxhetor për vitin e parë dhe vitet në vijim të zbatueshmërisë së tij. Andaj, vendimi i Kryesisë për të kërkuar deklaratën financiare mbi zbatueshmërinë e projektligjit në fjalë është në pajtim me rregullën më lartë. Deputetët të cilët kanë sponsoruar projektligjin duhet ta sigurojnë deklaratën financiare ashtuqë projektligji të mund të përfshihet për shqyrtim në Kuvend.

- Gjatë seancës plenare më 15 shkurt 2008, Kuvendi ka miratuar mocionin procedural për t’u shmangur nga rregullorja e punës në mënyrë që t’i shqyrtoj dhe miratoj në procedurë të shkurtuar projektligjet e parapara në “Propozimin gjithëpërfshirës pë statusin e Kosovës” të të dërguarit të posaçëm të OKB-së (këtu e tutje propozimi i Ahtisaari-t).²² Sipas mocionit procedural, deklaratat financiare të ligjeve do t’i dorëzoi Qeveria në Kuvend brenda 60 ditësh por jo më vonë se 180 ditë pas miratimit të ligjeve. Megjithatë, duket se Qeveria ende nuk i ka dorëzuar deklaratat financiare të 25 ligjeve që dalin nga propozimi i Ahtisaari-t, të cilat janë miratuar në Kuvend para 180 ditësh, ashtu siç kërkohet në mocionin procedural.

22 Për më shumë detaje shiko raportin e OSBE-së 01/2008 mbi monitorimin e Kuvendit të Kosovës, përkatësisht pjesën e titulluar “Mocioni Procedural”.

Rekomandimi lidhur me statusin e deputetit të z. Sabit Rrahmani

- Kryesia, në mbledhjen e mbajtur më 18 nëntor, pas marrjes së mendimit nga komisioni për mandate imunitete dhe rregullore të punës, ka vendosur që ta përfshijë rekomandimin lidhur me statusin e z. Sabit Rrahmani (PDAK/Ashkali) në rendin e ditës së seancës plenare të ardhshme të caktuar për datën 4 dhjetor.²³

Sipas rregullores së punës (rregulla 14.3), "Nëse deputeti i Kuvendit në periudhën gjashtëmujore (6) nuk merr pjesë në asnjë seancë të Kuvendit ose të Komisionit ku është anëtar dhe nuk mund të dëshmojë arsye bindëse për kryetarin e Kuvendit, atëherë kryetari i Kuvendit i propozon Kuvendit për deputetin në fjalë pushimin e funksionit të tij. Për këtë çështje kërkohet mendimi i Komisionit për Mandate dhe Imunitet."

Më 13 shtator, z. Sabit Rrahmani (PDAK) ka përmbushur afatin gjashtë mujor të mosparaqitjes në punimet e Kuvendit pa dhënë arsyetim, që paraqet një nga shkaqet për humbjen e statusit të deputetit. Andaj, në pajtim me Rregulloren, Kryetari i Kuvendit ka rekomanduar që statusi i deputetit i z. Rrahmani të përfundojë. Rekomandimi është mbështetur nga komisioni për mandate, imunitete dhe Rregullore të Punës.

Kuvendi sërish shpall pozitën e Avokatit të Popullit

- Në mbledhjen e mbajtur më 18 nëntor, anëtarët e Kryesisë kanë debatuar nëse me përzgjedhjen e Avokatit të Popullit duhet të merret vetëm komisioni për legjislacion dhe gjyqësi apo të angazhohet edhe komisioni për të drejtat e njeriut, barazi gjinore, dhe peticione publike. Z. Daut Beqiri shef i departamentit ligjor shpjegoi se në legjislaturën e kaluar ishte caktuar komisioni për legjislacion, gjyqësi dhe kornizë kushtetuese i cili përfshinte nënkomisionin për të drejtat e njeriut, barazi gjinore dhe peticione publike. Andaj, ai debatoi se është logjike që të autorizohen të dy komisionet për t'u marrë me procesin e përzgjedhjes meqë në legjislaturën e tanishme ato funksionojnë si komisione më vete. Andaj, Kryesia vendosi që t'i autorizojë të dy komisionet që ta formojnë një panel të përbashkët rekrutues për t'i përzgjedhur tre kandidatë për t'u marrë në shqyrtim nga Kuvendi. Kryesia, në vendimin e saj parasheh që komisioni për të drejtat e njeriut, barazi gjinore dhe peticione publike të përfaqësohet me katër anëtarë ndërsa komisioni për legjislacion dhe gjyqësi me tre anëtarë në panelin rekrutues. Më 24 nëntor, pas marrjes së vendimit të Kryesisë, komisioni për të drejtat e njeriut, barazi gjinore dhe peticione publike dhe komisioni për legjislacion dhe gjyqësi i kanë caktuar anëtarët e tyre në panelin rekrutues.²⁴

²³ Vendimi i Kuvendit lidhur me rekomandimin për statusin e z. Sabit Rrahmani do të mbulohet në raportin monitorues të radhës.

²⁴ Sipas rregullores së Kuvendit për emërimin e Avokatit të Popullit, secili grup parlamentar duhet të përfaqësohet në panelin rekrutues me një deputet. Andaj, të dy komisionet i kanë caktuar anëtarët e tyre në pajtim me rregulloren. Komisioni për të drejtat e njeriut, barazi gjinore dhe peticione publike ka emëruar znj. Nerxhivane Dauti (PDK), z. Ismet Beqiri (LDK), z. Ibrahim Makolli (AKR), dhe Spresa Murati (7+), derisa komisioni për legjislacion dhe gjyqësi ka emëruar z. Adem Salihaj (LDD), z. Bajram Kosumi (AAK) dhe z. Branislav Grbic (SLS).

Kjo është përpjekja e katërt e Kuvendit të Kosovës për ta emëruar Avokatin e Popullit dhe përpjekja e dytë gjatë mandatit të tanishëm të Kuvendit. Procesi i mëparshëm për emërimin e Avokatit të Popullit është anuluar me vendim të Kuvendit në seancën plenare më 25 shtator 2008.²⁵ Gjatë mandatit të kaluar, Kuvendi i Kosovës, ngjashëm, ka tentuar dy herë ta emërojë Avokatin e Popullit, por të dyja këto tentime kanë dështuar.

Pyetjet për Qeverinë

- Në seancën plenare të 3 tetorit, 11 nga 12 pyetje morën përgjigje, derisa shumë pyetje tjera u shtyen për seancën e radhës sepse koha për pyetje parlamentare kishte kaluar. Në seancën plenare të 17 tetorit Kryetari i Kuvendit propozoi që të procesohet nga një pyetje për deputet gjatë kohës për pyetje parlamentare për shkak të numrit të madh të pyetjeve të parashtruara dhe për t'i dhënë mundësinë çdo deputeti i cili ka parashtruar pyetje, të marrin përgjigje. Kryetari i Kuvendit më tutje propozoi që kjo të bëhet praktikë për seancat plenare të ardhshme poashtu dhe e hodhi në votim propozimin e tij, i cili u miratua me shumicë votash për. Andaj, në seancën plenare të 17 tetorit 11 nga 20 pyetje morën përgjigje gjatë kohës për pyetje parlamentare derisa 23 pyetjet e mbetura janë shtyrë për seancën plenare të radhës, sepse koha për pyetje parlamentare kishte përfunduar. Në seancën plenare të 6 nëntorit kryesuesi i seancës lajmëroi se për shkak të numrit të madh të pyetjeve Kryesia propozon që koha për pyetje parlamentare të zgjatet nga 50 në 60 minuta dhe se koha për pyetje parlamentare të mbahet poashtu edhe gjatë vazhimit të seancës më 7 nëntor. Ai më pas e hodhi në votim propozimin e Kryesisë i cili është miratuar me shumicë votash për. Andaj, më 6 nëntor dhjetë nga 11 pyetje morën përgjigje. Megjithatë, më 7 nëntor koha për pyetjet parlamentare është hequr nga rendi i ditës dhe është shtyrë për seancën plenare të radhës për shkak të mosparnisë së Qeverisë. Në seancën plenare më 20 nëntor 11 nga 15 pyetje morën përgjigje, derisa shumë pyetje të tjera u shtyen për seancën plenare të radhës sepse koha shtesë për pyetjet parlamentare kishte kaluar. *Periodhat për pyetjet parlamentare të seancave më 3 dhe 17 tetor janë bërë në pajtim me rregullën 26 mbi “pyetjet për Qeverinë për përgjigje gojore”, e cila parasheh që rendi i ditës i secilës seancë plenare të përfshijë një periudhë deri në 50 minuta për pyetjet e deputetëve për Qeverinë, ku një minutë zgjat pyetja, tre minuta përgjigja e ministrit, një minutë pyetja shtesë, dhe dy minuta për përgjigjen në pyetjen shtesë.* *Vendimet e Kuvendit për ta zgjatur periudhën për pyetjet parlamentare dhe të krijoj praktikën e procesimit nga një pyetje për deputet, paraqet një hap para në tentimin për të rregulluar kohën për pyetje parlamentare në mënyrë më të efektshme. Është vërejtur se jo të gjitha pyetjet mund të procedohen brenda periudhës 50 minutëshe për shkak të numrit të madh të pyetjeve të parashtruara. OSBE-ja, në raportet e saj të mëhershme ka rekomanduar që Kuvendi, ose duhet ta zgjas periudhën e pyetjeve ose ta kufizojë numrin e pyetjeve për deputet në mënyrë që t'u ipet mundësia të gjithë deputetëve që*

25 Për më shumë detaje shiko raportin e OSBE-së 04/2008 mbi monitorimin e Kuvendit të Kosovës, përkatësisht, pjesën e titulluar “Kuvendi shpall pozitën e Avokatit të Popullit për herë të katërt”.

kanë parashtruar pyetje, t'i parashtrojnë ato dhe të marrin përgjigje. Sipas rregullës 26.11, "Nëse pyetja nuk ka marrë përgjigje brenda dy seancave, ajo publikohet në buletin e Kuvendit." Sidoqoftë, Kuvendi ende nuk i ka publikuar buletin për muajt tetor dhe nëntor, andaj pyetjet që nuk kanë marrë përgjigje gjatë këtyre muajve nuk janë publikuar siç kërkohet në rregullën 26. Heqja e kohës për pyetjet parlamentare nga rendi i ditës i seancës plenare më 7 nëntor për shkak të mospranisë së Qeverisë tregon se Kuvendi duhet të bëjë më shumë përpjekje dhe ta përdorë autoritetin e tij për të siguruar përgjegjshmërinë e Qeverisë, që është standard kyç demokratik parlamentar.

4. Qasja

- Gjatë periudhës raportuese, Shtylla e III-të (OSBE) ka pasur qasje në seancat plenare, në mbledhjet e Kryesisë dhe në mbledhjet e komisioneve, në shqyrtim. Shtylla e III-të gjithashtu ka pranuar kopjet e dokumentave të shqyrtuara nga Kuvendi si dhe transkriptin e seancave të kaluara.

5. Transparenca

- Gjatë periudhës raportuese Kuvendi nuk ka publikuar në web faqen e vet asnjë nga rezultatet elektronike të vendimeve të marra në seanca plenare. Kuvendi ka publikuar më herët disa rezultate të votimit elektronik, por ka dështuar ta bëjë këtë më vonë. Kuvendi duhet që t'i publikojë rezultatet e votimit elektronik në mënyrë të vazhdueshme në mënyrë që ta rris transparencën e Kuvendit, posaçërisht përgjegjësinë e deputetëve para votuesve të tyre.²⁶ Radio Televizioni i Kosovës ka siguruar transmetimin e drejtpërdrejtë të seancave plenare në fjalë. Publikut dhe monitoruesve institucional iu është mundësuar hyrja në seancat plenare. Kuvendi ka ueb-faqen (www.assembly-kosova.org) që përmban detaje biografike të deputetëve të Kuvendit, informacione për strukturën dhe funksionimin e Kuvendit, procesverbale dhe transkripte nga seancat plenare të Kuvendit dhe mbledhjeve të komisioneve, kopje të ligjeve dhe rezolutave të miratuara nga Kuvendi, si dhe informacione të tjera.

FUND.

²⁶ Në seancën plenare të mbajtur më 15 shkurt 2008, Kryetari i Kuvendit ka lajmëruar se Kuvendi do t'i publikojë në web faqen e tij rezultatet e votimit elektronik të vendimeve të marra në seanca plenare. Pas këtij lajmërimi të Kryetarit, Kuvendi ka filluar publikimin e rezultateve të votimit elektronik nga seanca e jashtëzakonshme plenare të mbajtur më 17 shkurt. Rezultatet e votimeve elektronike nga disa seanca plenare janë publikuar në web faqen e Kuvendit. Megjithatë, rezultatet e fundit elektronike të publikuara në web faqe janë ato të seancës plenare të mbajtur më 2 qershor.



Organization for Security and
Co-operation in Europe
Mission in Kosovo

Shtylla III (OSBE)

Raporti 06/2008

Mbi monitorimin e Kuvendit të Kosovës

1 dhjetor 2008 – 31 dhjetor 2008

Titujt kryesor

- Kuvendi miraton në parim Rregulloren e re të Punës
- Kuvendi vendos ta përfundoj mandatin e Sabit Rrahmanit
- Kuvendi miraton buxhetin e Kosovës për vitin 2009
- Kuvendi vazhdon të dështojë në publikimin e rezultatit elektronik të votimit

1. Sfond

Raporti i gjashtëdhjetë i monitorimit është hartuar në përputhje me pikëpamjet referuese të Shtyllës së tretë të UNMIK-ut për themelimin e institucioneve (OSBE) dhe monitorimin e Kuvendit të Kosovës prej datës 26 nëntor 2002 dhe bazohet në Rregulloren e re të punës, të miratuar në fund të seancës plenare më 20 maj 2005 dhe të reviduar në seancën plenare të mbajtur më 1-2 qershor 2006 dhe 18 shtator 2007.

Misioni i OSBE-së në Kosovë ka monitoruar gjashtë seanca plenare, më 4 dhjetor, më 11-12 dhjetor, më 18 dhjetor, dhe më 19 dhjetor, si dhe tri mbledhje të Kryesisë, më 2 dhjetor, më 12 dhjetor, më 15 dhjetor, më 16 dhjetor, dhe më 23 dhjetor. Misioni i OSBE-së në Kosovë ka monitoruar 11 nga 23 mbledhje të komisioneve ndërsa nuk është mbajtur asnjë dëgjim publik gjatë periudhës raportuese.

2. Vështrim

Seancën plenare të Kuvendit të Kosovës të mbajtur më 4 dhjetor e kryesoi Kryetari i Kuvendit z. Jakup Krasniqi (PDK) dhe anëtari i Kryesisë z. Džezair Murati (7+/Vakat).

- Tetëdhjetë e katër deputetë ishin të pranishëm në seancën plenare më 4 dhjetor.
- Pikat kryesore të rendit të ditës të seancës së plenare të mbajtur më 4 dhjetor:
 - Pyetjet për Qeverinë për përgjigje me gojë
 - Interpelanca e Ministrit të shëndetësisë
 - Shqyrtimi i rekomandimit për amendamentimin e ligjit për tubimet publike (Rekomandimi është miratuar me 61 vota për dhe pa vota kundër.)
 - Shqyrtimi i dytë i projektligjit për Taksën administrative dhe procedurat (Projektligji është miratuar me 60 vota për dhe pa vota kundër.)
 - Shqyrtimi i rekomandimit të Komisionit për Komisionit për mandate, imunitete dhe rregullore të punës lidhur me mandatin e z. Sabit Rrahmani (PDAK) (Rekomandimi është miratuar me 46 vota për dhe dhjetë vota kundër. Shiko më poshtë pjesën e titulluar “Kuvendi vendos t’i përfundoj mandatin e deputetit z. Sabit Rrahmani”.)

Seancën plenare të mbajtur më 11 dhe 12 dhjetor e kryesoi Kryetari i Kuvendit z. Jakup Krasniqi (PDK) dhe anëtari i Kryesisë z. Naim Maloku (AAK).

- Shtatëdhjetë e tetë deputetë ishin të pranishëm në seancën plenare më 11 dhe 12 dhjetor.
- Pikat kryesore të rendit të ditës të seancës plenare të mbajtur më 11 dhe 12 dhjetor:

- Pyetjet për Qeverinë për përgjigje me gojë
- Interpelanca e Kryeministrit
- Shqyrtimi i parë i projektligjit për tatimin mbi vlerën e shtuar (Projektligji është miratuar në parim me 56 vota për dhe 30 vota kundër.)
- Shqyrtimi i parë i projektligjit për tatimin në të ardhurat e korporatave (Projektligji është miratuar në parim me 64 vota për dhe tri vota kundër.)
- Shqyrtimi i parë i projektligjit për tatimin në të ardhurat personale (Projektligji është miratuar në parim me 59 vota për dhe katër vota kundër.)
- Shqyrtimi i parë i projektligjit për taksën e akcizës (Projektligji është miratuar në parim me 59 vota për dhe pa vota kundër.)
- Shqyrtimi i dytë i projektligjit për faljen (Projektligji është miratuar me 57 vota për dhe pa vota kundër.)
- Shqyrtimi i rekomandimit për ndryshimin e ligjit për rrugët (Rekomandimi është miratuar me 48 vota për dhe një votë kundër.)
- Shqyrtimi i planit të veprimit të Kuvendit (Plani i veprimit është miratuar me 65 vota për dhe dy vota kundër.)
- Shqyrtimi i parë i projektregullores së punës së Kuvendit të Kosovës (Projektregullorja e punës është miratuar në parim me 62 vota për dhe pa vota kundër.)
- Shqyrtimi i rekomandimit të komisionit për ekonomi, tregti, industri, energji, transport dhe komunikacion në mbështetje të vendimit të Qeverisë për privatizimin e distribucionit të Korporatës Energjitike të Kosovës (Rekomandimi i komisionit është miratuar me 47 vota për dhe dhjetë vota kundër.)
- Shqyrtimi i rekomandimit të komisionit për ekonomi, tregti, energji, transport dhe komunikacion lidhur me emërimin e anëtarëve të bordit të Zyrës së Rregullatorit të Energjisë (Rekomandimi i komisionit është miratuar me 61 vota për dhe nëntë vota kundër.)
- Shqyrtimi i rekomandimit të komisionit *ad hoc* lidhur me emërimin e katër anëtarëve të këshillit të Komisionit të Pavarur për Media (Rekomandimi i komisionit është miratuar me 49 vota për dhe 25 vota kundër.)
- Shqyrtimi i rekomandimit të komisionit *ad hoc* lidhur me emërimin e katër anëtarëve të Bordit të Pavarur Mbikqyrës (Rekomandimi i komisionit është miratuar me votim të fshehtë.)

Seancën plenare të mbajtur më 15 dhjetor e kryesoi Kryetari i Kuvendit z. Jakup Krasniqi (PDK) dhe anëtari i Kryesisë z. Ibrahim Gashi (AKR).

- Nëntëdhjetë deputetë ishin të pranishëm në seancën plenare më 15 dhjetor.
- Pikat kryesore të rendit të ditës të seancës plenare të mbajtur më 15 dhjetor:
 - Shqyrtimi i parë i projektligjit për të huajt (Projektligji është miratuar në parim me 56 vota dhe katër vota kundër.)

- Shqyrtimi i parë i projektligjit për ndryshimin e ligjit për shëndetësinë (Projektligji është miratuar në parim me 52 vota për dhe 17 vota kundër.)
- Shqyrtimi i parë i projektligjit për Gjykatën Kushtetuese të Kosovës (Projektligji është miratuar në parim me 77 vota për dhe katër vota kundër.)
- Shqyrtimi i parë i projektligjit për përbërjen e përkohshme të Këshillit Gjyqësor të Kosovës (Projektligji është miratuar në parim me 75 vota për dhe pesë vota kundër.)
- Shqyrtimi i parë i projektligjit për Shërbimin e Jashtëm të Kosovës (Projektligji është miratuar në parim me 78 vota për dhe tri vota kundër.)
- Shqyrtimi i parë i projektligjit për shërbimin diplomatik dhe konsullor të Kosovës (Projektligji është miratuar në parim me 82 vota për dhe dy vota kundër.)

Seancën plenare të mbajtur më 16 dhjetor e kryesoi Kryetari i Kuvendit z. Jakup Krasniqi (PDK) dhe anëtari i Kryesisë z. Džezair Murati (7+/Vakat).

- Njëqind deputetë ishin të pranishëm në seancën plenare më 16 dhjetor.
- Pikat kryesore të rendit të ditës të seancës plenare të mbajtur më 16 dhjetor:
 - Shqyrtimi i dytë i projektligjit për të huajt (Projektligji është miratuar me 87 vota dhe dy vota kundër.)
 - Shqyrtimi i dytë i projektligjit për ndryshimin e ligjit për shëndetësinë (Projektligji është miratuar me 43 vota për dhe 21 vota kundër.)
 - Shqyrtimi i dytë i projektligjit për Gjykatën Kushtetuese të Kosovës (Projektligji është miratuar me 85 vota për dhe katër vota kundër.)
 - Shqyrtimi i dytë i projektligjit për përbërjen e përkohshme të Këshillit Gjyqësor të Kosovës (Projektligji është miratuar me 76 vota për dhe katër vota kundër.)
 - Shqyrtimi i dytë i projektligjit për Shërbimin e Jashtëm të Kosovës (Projektligji është miratuar me 85 vota për dhe tri vota kundër.)
 - Shqyrtimi i dytë i projektligjit për shërbimin diplomatik dhe konsullor të Kosovës (Projektligji është miratuar me 86 vota për dhe tri vota kundër.)

Seancën plenare të mbajtur më 18 dhjetor e kryesoi Kryetari i Kuvendit z. Jakup Krasniqi (PDK), dhe anëtari i Kryesisë z. Eqrem Kryeziu (LDK).

- Gjashtëdhjetë e një deputetë ishin të pranishëm në seancën plenare më 18 dhjetor.
- Pikat kryesore të rendit të ditës të seancës plenare të mbajtur më 18 dhjetor:
 - Pyetjet për Qeverinë për përgjigje me gojë
 - Shqyrtimi i dytë i projektligjit për Rehabilitimin profesional dhe punësimin e personave me aftësi të kufizuara (Projektligji është miratuar me 75 vota për dhe pa votë kundër.)

- Shqyrtimi i dytë i projektligjit për Presidentin e Kosovës (Projektligji është tërhequr me kërkesë të grupit parlamentar të PDK-së.)
- Shqyrtimi i dytë i projektligjit për tatimin mbi vlerën e shtuar (Projektligji është miratuar me 46 vota për dhe 23 vota kundër.)
- Shqyrtimi i dytë i projektligjit për tatimin mbi të ardhurat e korporatave (Projektligji është miratuar me 57 vota për dhe gjashtë vota kundër.)
- Shqyrtimi i dytë i projektligjit për tatimin në të ardhurat personale (Projektligji është miratuar me 41 vota për dhe 18 vota kundër.)
- Shqyrtimi i dytë i projektligjit për akcizat (Projektligji është miratuar me 54 vota për dhe 13 vota kundër.)
- Shqyrtimi i rekomandimit për ndryshimin e ligjit për taksën e akomodimit (Rekomandimi është miratuar me 71 vota për dhe një votë kundër.)
- Shqyrtimi i propozimit të Qeverisë lidhur me emërimin e anëtarëve të bordit të pavarur për shqyrtimin e ankesave tatimore (Propozimi është miratuar me 46 vota për dhe 20 vota kundër.)

Seancën plenare të mbajtur më 19 dhjetor e kryesoi Kryetari i Kuvendit z. Jakup Krasniqi (PDK) dhe anëtari i Kryesisë z. Ibrahim Gashi (AKR).

- Tetëdhjetë e tre deputetë ishin të pranishëm në seancën plenare më 19 dhjetor.
- Pikat kryesore të rendit të ditës të seancës plenare të mbajtur më 19 dhjetor:
 - Shqyrtimi i dytë i projektligjit për buxhetin e Kosovës 2009 dhe shpenzimet e autorizuara për periudhën 1 janar 2009 – 31 dhjetor 2009 (Projektligji është miratuar me 74 vota për dhe 21 vota kundër.)

3. Punimet dhe praktikat parlamentare në seancat e Kuvendit

Rendi i ditës

- Në fillim të seancës plenare më 4 dhjetor, z. Gani Geci (LDD) deklaroi se dëshiron të propozoj një ndryshim në rendin e ditës së seancës plenare në fjalë, por Kryetari i Kuvendit nuk e lejoi ta bëjë këtë duke debatuar se ai nuk e kishte dorëzuar propozimin e tij me shkrim ashtu siç kërkohet në Rregulloren e Punës. Z. Geci megjithatë vazhdoi duke kërkuar fjalën dhe duke thënë i kishte dy çështje urgjente për diskutim, por Kryetari i Kuvendit kundërshtoi duke thënë se i takonte atij për ta vlerësuar urgjencën e çështjeve dhe nuk i lejoi z. Geci të flas. Por, z. Geci me këmbëngulje vazhdoi duke kërkuar fjalën, e që përfundimisht i u dha. Z. Geci propozoi dy çështje, sipas tij urgjente, për diskutim në seancën plenare në fjalë – raportin me rekomandime lidhur me situatën e sigurisë në Kosovë, hartuar nga komisioni për punë të brendshme dhe siguri, dhe paraburgosjen e tre qytetarëve gjermanë nga Policia e Kosovës. Kryetari i Kuvendit nuk i komentoi propozimet e z. Geci dhe nuk i hodhi ato në votim.

Në fillim të seancës plenare më 18 dhjetor, znj. Donika Kada-Bujupi (AAK), znj. Gjylnaze Sylja (AAK), z. Gani Geci (LDD) dhe znj. Rita Hjazera (AKR) propozuan çështje urgjente për diskutim në seancën plenare në fjalë. Kryetari i Kuvendit u përgjigj se propozimet e tyre nuk janë urgjente dhe nuk i hodhi ato në votim. Ai më pas i këshilloi deputetët në fjalë se mund t'i parashtronjë propozimet e tyre me shkrim në pajtim me rregulloren e punës.

Rregulla 29.1.parasheh që “Në çdo seancë plenare, deputeti në marrëveshje me kryetarin e Kuvendit, mund të propozojë që Kuvendi të shqyrtojë menjëherë një çështje të ngutshme. Nëse kryetari i Kuvendit konsideron se çështja menjëherë meriton t'i kushtohet vëmendja e Kuvendit, deputetit në fjalë i mundëson të japë propozime në Kuvend që pastaj do ta vënë në votim” . Andaj, vendimi i Kryetarit të Kuvendit për të mos i votuar propozimet e lartpërmendura është në pajtim me rregullën 29.1 meqë Kryetari ka kompetencën për të vlerësuar nëse çështja e propozuar “meriton t'i kushtohet vëmendja e menjëhershme e Kuvendit.” Çdo deputet që dëshiron të propozoj një çështje të ngutshme për diskutim, duhet të konsultohet me Kryetarin e Kuvendit para se ta bëjë këtë.

Sipas rregullës 6.5, Kryesia “siguron që çfarëdo mocioni përmbajtësor që mbështetet nga gjashtë ose më shumë deputetë të Kuvendit, të futet në rendin e ditës të seancës plenare të Kuvendit brenda tri javësh pune, nga dita kur është marrë kjo shkallë e mbështetjes, për të cilën çështje vendos Kuvendi.” Andaj, propozimet e lartpërmendura mund t'i propozohen formalisht Kryesisë, e cila në pajtim me rregullën 6.5, duhet t'i radhis ato në rendin e ditës së seancës plenare brenda tri javësh pune, me kushtin që mocionet të jenë mbështetur nga së paku gjashtë deputetë.

Shpërndarja e projektligjeve

- Projektligji për tatimin mbi vlerën e shtuar, projektligji për tatimin në të ardhurat personale, projektligji për tatimin në të hyrat e korporatave, dhe projektligji për akcizat janë shpërndarë më 21 nëntor. Andaj, projektligjet janë shpërndarë 14 ditë pune para shqyrtimit të tyre të parë në seancën plenare më 11 dhjetor. *Rregulla 35.1 parasheh që shqyrtimi i parë i projektligjit duhet të bëhet jo më parë se dhjetë ditë pune dhe as më shumë se tri javë pune nga dita pas shpërndarjes së tij. Andaj, katër projektligjet e lartpërmendura janë shqyrtuar për herë të parë në pajtim me rregullën 35.1, gjë që paraqet përmirësim në krahasim me periudhat paraprake raportuese.*

Procesi legjislativ

- Projektligji për ndryshimin e ligjit për taksën administrative dhe procedurat është miratuar pesë muaj pas miratimit të tij në parim më 30 qershor. Projektligji për faljen është miratuar një muaj pas miratimit në parim më 6 nëntor. Projektligji për rehabilitimin profesional dhe punësimin e personave me aftësi të kufizuara është miratuar nëntë muaj pas miratimit në parim më 28 shkurt. Projektligji për Presidentin e Kosovës është miratuar tre muaj pas miratimit në parim më 18 shtator. Projektligji për tatimin mbi vlerën e shtuar,

projektpër tatimin në të ardhurat personale, projektligji për tatimin në të ardhurat e korporatave, dhe projektligji për taksën e akcizës, janë miratuar një javë pas miratimit të tyre në parim më 11 dhjetor. Projektligji për buxhetin e Kosovës 2009 dhe shpenzimet e autorizuara për periudhën 1 janar – 31 dhjetor 2009 është miratuar tri javë pas miratimit në parim më 25 nëntor.

Sipas rregullës 35.6 “Në rastet kur një komision është caktuar ta shqyrtojë projektligjin, atëherë ai i raporton rekomandimet e veta në Kuvend, por jo më vonë se dy (2) muaj nga shqyrtimi i parë i projektligjit, përveç rasteve kur është miratuar një kohëzgjatje shtesë nga Kuvendi” Gjashhtë ligjet e lartpërmendura janë miratuar nga Kuvendi brenda afatit të paraparë në rregullën 35.6, derisa tri projektligjet tjera janë miratuar mjaftë gjatë pas afatit të paraparë; komisionet përgjegjëse funksionale nuk kanë kërkuar nga Kuvendi zgjatjen e afatit, gjë që nuk është në pajtim me rregullën 35.6. Nëse Kuvendi dëshiron që ta rris efektivitetin e procesit legjislativ, komisionet duhet që t'i shqyrtojnë dhe miratojnë projektligjet brenda kohës së paraparë me rregullën e lartëshënuar.

- Kryesia, në mbledhjen e mbajtur më 12 dhjetor, ka diskutuar lidhur me letrën e dërguar nga komisioni për legjislacion dhe gjyqësi, në të cilën komisioni ka kërkuar shpjegim lidhur me mos procedimin e ligjit për të drejtat dhe përgjegjësitë e deputetit për miratim në seancë plenare. Kryesia ka vendosur të kërkoj nga Ministria për ekonomi dhe financa deklaratën financiare të ligjit në fjalë, para procedimit të ligjit në seancë plenare për miratim, sepse ligji nuk e kishte të bashkangjitur deklaratën financiare.²⁷

Rregulla 33.2 parasheh që kur projektligji paraqitet në Kuvend, duhet të përfshijë deklaratën mbi implikimet financiare për vitin e parë dhe vitet në vijim të zbatimit të tij. Andaj, vendimi i Kryesisë për të kërkuar deklaratën financiare të ligjit në fjalë është në pajtim me rregullën më lartë.

Kuvendi miraton në parim Rregulloren e Punës

- Në seancën plenare të mbajtur më 11 dhjetor, z. Kolë Berisha (LDK) kryetar i Komisionit për mandate, imunitet dhe rregullore të punës, e paraqiti projekt rregulloren e re të punës të përgatitur nga Komisioni. Përfaqësuesit e të gjitha grupeve parlamentare e mbështetën projekt rregulloren e re të punës me vetëm disa komente të vogla. Pas diskutimit, Kryetari i Kuvendit deklaroi se të gjitha grupet parlamentare dhe deputetë individual kanë të drejtën të propozojnë amandamente në projekt rregulloren e punës dhe e hedhi në votim projekt rregulloren e cila është miratuar në parim me 62 vota për dhe pa vota kundër.

Rregulla 3.4 parasheh që “Kuvendi në seancën konstituive ose në mbledhjen tjetër të radhës, do ta formojë një komision ad hoc për Rregulloren e punës të Kuvendit i cili përgatit projekt rregulloren së punës dhe ia paraqet Kuvendit

²⁷ Ligji për të drejtat dhe përgjegjësitë e deputetëve të Kuvendit është miratuar në shqyrtim të dytë nga legjislatura e kaluar në nëntor 2007, por nuk është shpallur nga PSSP-ja për shkak të implikimeve të tepërta financiare. Pas kërkesës së bërë nga Qeveria në seancën plenare të mbajtur më 29 korrik 2008, Kuvendi ka miratuar një mocion për kthimin e 17 ligjeve të pashpallura nga PSSP-ja në Kuvend për rishqyrtim dhe miratim, në mesin e të cilave ligje është edhe ligji për të drejtat dhe përgjegjësitë e deputetëve të Kuvendit.

për shqyrtim dhe miratim. Në mandatin aktual, për dallim nga ai paraprak, Kuvendi ka vendosur që në vend të komisionit ad hoc të themelohet komisioni të përhershëm për rregulloren e punës. Me propozim të komisionit për rregullore të punës Kuvendi poashtu ka vendosur që ta ndryshojë procedurën e miratimit të projektregullores nga një shqyrtim – siç ishte në mandatin e kaluar - në dy shqyrtime, në mënyrë që në procesin e shqyrtimit të përfshihen edhe grupet parlamentare dhe deputetët individual. Pritet që komisioni ta përfundojë projektin e rregullores së re të punës deri më 15 mars 2009 ashtu siç është ngarkuar nga Kryesia.

Kuvendi vendos t'i përfundojë mandatin e deputetit z. Sabit Rrahmani

- Gjatë seancës plenare më 4 dhjetor Kryetari i Kuvendit lajmëroi se z. Sabit Rrahmani (PDAK/Ashkali) nuk ka marrë pjesë në punimet e Kuvendit për më shumë se gjashtë muaj dhe në pajtim me rregulloren e punës ai i ka rekomanduar komisionit për mandate imunitete dhe rregullore të punës që t'i përfundojë mandatin e deputetit z. Rrahmani. Komisioni e ka shqyrtuar dhe mbështetur rekomandimin e Kryetarit të Kuvendit. Në deklaratën e tij, kryesuesi i komisionit z. Ahmet Isufi (AAK) lajmëroi se kishte edhe një kërkesë tjetër për heqjen e imunitetit të z. Rrahmani, të bërë nga Gjyqi i qarkut të Prishtinës, për shkak të akuzave për vepra penale ndaj z. Rrahmani. Në anën tjetër z. Hetem Arifi (PDAK) deklaroi se z. Rrahmani e ka pasur të pamundur të marrë pjesë në punimet e Kuvendit sepse i ishte nënshtruar një operimi në zemër, dhe kërkoi nga Kuvendi që mos t'ia përfundojë mandatin z. Rrahmani. Megjithatë, Kryetari i Kuvendit e hedhi në votim përfundimin e mandatis të z. Rrahmani që kaloi me 46 vota për, dhjetë kundër dhe katër abstenime.

Sipas rregullores së punës (rregulla 14.3), "Nëse deputeti i Kuvendit në periudhën gjashtëmuajore (6) nuk merr pjesë në asnjë seancë të Kuvendit ose të Komisionit ku është anëtar dhe nuk mund të dëshmojë arsye bindëse për kryetarin e Kuvendit, atëherë kryetari i Kuvendit i propozon Kuvendit për deputetin në fjalë pushimin e funksionit të tij. Për këtë çështje kërkohet mendimi i Komisionit për Mandate dhe Imunitet." Më 13 shtator 2008, z. Sabit Rrahmani (PDAK) ka përmbushur afatin gjashtë mujor të mosparaqitjes në punimet e Kuvendit pa dhënë arsyetim, që paraqet një nga shkaqet për humbjen e statusit të deputetit. Andaj, në pajtim me Rregulloren, Kryetari i Kuvendit ka rekomanduar që statusi i deputetit i z. Rrahmani të përfundojë, gjë që është mbështetur nga komisioni për mandate, imunitete dhe Rregullore të Punës. Kjo është hera e parë që Kuvendi i Kosovës vendos që t'ia përfundojë mandatin njërit prej deputetëve të tij.

Interpelanca

- Gjatë seancës plenare më 4 dhjetor z. Alush Gashi, Ministër për shëndetësi, i është përgjigjur mocionit për interpelancë të parashtruar nga grupi parlamentar i LDD-së lidhur me gjendjen në sistemin shëndetësor në Kosovë. Në emër të grupit parlamentar të LDD-së, znj. Qamile Morina bëri deklaratën hyrëse dhjetë minutëshe, derisa koha e mbetur u është shpërndarë të gjitha grupeve parlamentare proporcionalisht. Në fund të debatit të interpelancës, shefi i

grupit parlamentar të LDD-së, z. Lulzim Zeneli bëri deklaratë pesë minutëshe dhe propozoi një mocion për t'u votuar nga Kuvendi. Në këtë mocion, ai propozoi që të formohet një komision hetimor për të shikuar dështimet në sistemin shëndetësor dhe në Ministrinë e shëndetësisë si dhe shkarkimin e ministrit për shëndetësi si personi "përgjegjës për situatën e rëndë në sistemin shëndetësor". Kryesuesi i seancës u përgjigj se mocioni ishte përfshirë në kërkesën fillestare për interpelancë, dhe nuk e hedhi në votim.

Debati i interpelancës është mbajtur në pajtim me rregullën 25.7, sipas së cilës grupi parlamentar që ka propozuar debatin për interpelancë ka të drejtë ta fillojë debatin me një kohë që nuk i kalon dhjetë (10) minuta. I njëjti grup parlamentar ka të drejtë ta mbyll debatin me një kohë që nuk i kakon pesë (5) minuta dhe koha e ndarë për grupet parlamentare duhet ta reflektojë përfaqësimin e tyre në Kuvend. Sa i përket mocionit të z. Zeneli, rregulla 25.9 parasheh se "Grupi parlamentar që ka kërkuar interpelancën mund të kërkojë që të votohet një mocion në fund të debatit për interpelancë, me kusht që mocioni të ketë qenë i përfshirë në kërkesën fillestare për interpelancë". Andaj, moshedhja në votim e mocionit të z. Zeneli nga ana e Kryesuesit të seancës nuk paraqet shkelje të rregullores, meqë mocioni nuk ishte përfshirë në kërkesën fillestare të LDD-së për interpelancë.

Pyetjet për Qeverinë

- Në seancën plenare më 4 dhjetor, katër prej 23 pyetjeve morën përgjigje. Gjatë kohës për pyetjet parlamentare në seancën plenare të mbajtur më 4 dhjetor, z. Zafir Berisha (PDK) dhe z. Arsim Rexhepi (LDK) deklaruan se dëshirojnë t'i tërheqin pyetjet e tyre meqë ato kanë humbur kuptimin.²⁸ Kryetari i Kuvendit lajmëroi se pyetjet të cilat nuk kanë marrë përgjigje gjatë dy seancave plenare do të publikohen në buletin e Kuvendit. Në seancën plenare të mbajtur më 11 dhjetor, dhjetë prej 15 pyetjeve morën përgjigje.

Koha për pyetjet parlamentare gjatë periudhës raportuese është bërë në pajtim me rregullën 26 mbi "pyetjet për Qeverinë për përgjigje gojore", e cila parasheh që rendi i ditës i secilës seancë plenare të përfshijë një periudhë deri në 50 minuta për pyetjet e deputetëve për Qeverinë, ku një minutë zgjat pyetja, tre minuta përgjigja e ministrit, një minutë pyetja shtesë, dhe dy minuta për përgjigjen në pyetjen shtesë.

Megjithëkëtë, në raportet paraprake është vërejtur se jo të gjitha pyetjet parlamentare mund të procedoheshin gjatë kohës prej 50 minutash për shkak të numrit të madh të pyetjeve të parashtruara nga deputetët. Tërheqja e pyetjeve nga ana e dy deputetëve të cilët kanë pritur me muaj për t'i parashtruar pyetjet e tyre, poashtu tregon se koha për pyetjet parlamentare duhet të rregullohet në mënyrë më të efektshme. OSBE-ja ka rekomanduar Kuvendit që ta zgja.ës kohën për pyetje parlamentare ose ta kufizojë numrin e pyetjeve për deputet në mënyrë që t'u ipet rasti të gjithë deputetëve të cilët kanë parashtruar pyetje, që t'i lexojnë ato në kohën e paraparë dhe të marrin përgjigje.

28 Z. Berisha bëri vërejtjen se pyetjen e tij për Ministrin për arsim, shkencë dhe teknologji e kishte parashtruar para dy muajsh, derisa z. Rexhepi deklaroi se ai i kishte parashtruar pyetjen e tij Ministrit për kulturë, rini dhe sporte tre muaj më parë.

4. Qasja

- Gjatë periudhës raportuese, Misioni i OSBE-së në Kosovë ka pasur qasje në seancat plenare, në mbledhjet e Kryesisë dhe në mbledhjet e komisioneve, në shqyrtim. Misioni i OSBE-së në Kosovë gjithashtu ka pranuar kopjet e dokumentave të shqyrtuara nga Kuvendi si dhe transkriptin e seancave të kaluara.

5. Transparenca

- Gjatë periudhës raportuese Kuvendi nuk ka publikuar në web faqen e vet asnjë nga rezultatet elektronike të vendimeve të marra në seanca plenare. Kuvendi ka publikuar më herët disa rezultate të votimit elektronik, por ka dështuar ta bëjë këtë më vonë. Kuvendi duhet që t'i publikojë rezultatet e votimit elektronik në mënyrë të vazhdueshme në mënyrë që ta rris transparencën e Kuvendit, posaçërisht përgjegjësinë e deputetëve para votuesve të tyre.²⁹

Radio Televizioni i Kosovës ka siguruar transmetimin e drejtpërdrejtë të seancave plenare në fjalë. Publikut dhe monitoruesve institucional iu është mundësuar hyrja në seancat plenare. Kuvendi ka ueb-faqen (www.assembly-kosova.org) që përmban detaje biografike të deputetëve të Kuvendit, informacione për strukturën dhe funksionimin e Kuvendit, procesverbale dhe transkripte nga seancat plenare të Kuvendit dhe mbledhjeve të komisioneve, kopje të ligjeve dhe rezolutave të miratuara nga Kuvendi, si dhe informacione të tjera.

FUND.

²⁹ Në seancën plenare të mbajtur më 15 shkurt 2008, Kryetari i Kuvendit ka lajmëruar se Kuvendi do t'i publikoj në web faqen e tij rezultatet e votimit elektronik të vendimeve të marra në seanca plenare. Pas këtij lajmërimi të Kryetarit, Kuvendi ka filluar publikimin e rezultateve të votimit elektronik nga seanca e jashtëzakonshme plenare të mbajtur më 17 shkurt 2008. Rezultatet e votimeve elektronike nga disa seanca plenare janë publikuar në web faqen e Kuvendit. Megjithatë, rezultatet e fundit elektronike të publikuara në web faqe janë ato të seancës plenare të mbajtur më 2 qershor 2008.

